

MATERIAL MËSIMOR

Në mbështetje të mësuesve të drejtimit mësimor

BUJQËSI

Niveli IV i KSHK

NR. 14

Ky material mësimor i referohet:

- **Lëndës profesionale:** “Drejtimi, ligjshmëria dhe ekonomia në bujqësi”, kl.13 (L-17-523-20)

E përgatitën:

**Lindita Dhima
Zoje Kryekurti**

Tiranë, 2020

Tema 1: Aspekte kryesore të drejtimit të fermave bujqësore

Fermë është njësi ekonomike bazë në bujqësi dhe në veprimtaritë ekonomike që lidhen të. Ferma është një sipërfaqe toke apo veprimtari që kryesisht i kushtohet prodhimit dhe menaxhimit të ushqimit ose prodhimit blegtoral. Për të realizuar procesin e prodhimit fermerët kanë nevojë për burime prodhuese si tokë, ujë, mjete dhe makineri. Burimet prodhuese, të njohura si faktorë prodhimi grupohen në katër kategori kryesore.

- burime natyrore
- burime njerëzore
- kapitali
- drejtimi ose sipërmarrja

Bazuar në klasifikimin e faktorëve të prodhimit bujqësor dhe marrëdhëniet midis tyre arrihet në përfundim se *ferma bujqësore është “uniteti objektiv” i ndërtuar nga një tërësi faktorësh prodhues që gjenden në një vend dhe në një kohë të caktuar dhe “uniteti subjektiv” i dëshirës sipërmarrëse për arritjen e objektivave të përcaktuara.*

Klasifikimi i fermave bujqësore

Në procesin e studimit të fermës, si një nga format e organizimit të biznesit në bujqësi, ka rëndësi klasifikimi i tyre bazuar në disa kritere kryesore që janë:

- sipas madhësisë,
 - sipas drejtimit të prodhimit,
 - sipas raporteve që krijohen midis fermës, pronës dhe krahut të punës,
 - sipas pronësisë mbi tokën.
- **Sipas madhësisë** fermat bujqësore klasifikohen në: *ferma të vogla*, ku puna e krahut përballohet nga familja e fermerit dhe *ferma të mëdha*, ku puna e krahut nuk përballohet plotësisht nga familja e fermerit, por është i nevojshëm përdorimi i punës me qira.
- **Sipas drejtimit të prodhimit** fermat bujqësore klasifikohen në ferma me drejtim prodhimi:
- të bimëve të arave,
 - të perimeve,
 - kulturave drufrutore,
 - foragjer - zooteknik,
 - zooteknik pa tokë (komplekset blegtorale)
- **Sipas raporteve që krijohen midis fermës, pronës dhe krahut të punës** fermat bujqësore klasifikohen në:

Ferma familjare (3/4 e nevojave për punë mbulohen nga fermeri dhe anëtarët e tjerë të familjes).

- Ferma kapitaliste (3/4 e nevojave për punë mbulohen nga puna me qira).
 - Ferma kapitaliste - familjare ku mbizotëron puna e familjes ose familjare - kapitaliste ku mbizotëron puna me qira.
- **Sipas pronësisë mbi tokën** fermat bujqësore klasifikohen në:
- ferma familjare të organizuara në tokën pronë e fermerit,
 - ferma familjare të organizuara në tokën e marrë me qira,
 - ferma familjare të organizuara në tokën e fermerit dhe tokën e marrë me qira,
 - ferma kapitaliste të organizuara në tokën pronë e kapitalistit,
 - ferma kapitaliste të organizuara në tokën e marrë me qira, ferma kapitaliste të organizuara në tokën e kapitalistit dhe tokën e marrë me qira.

Modelet e zhvillimit të fermave bujqësore.

Zhvillimi i fermave bujqësore ka ecur paralelisht me fazat e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik të

vendit ku njësia kryesore e prodhimit në bujqësi është ferma familjare. Në këtë proces zhvillimi, fermat kanë kaluar nëpër tri faza zhvillimi:

- **Fermt e vetëmbajtjes** janë faza fillestare e zhvillimit të bujqësisë.
- **Fermt e kombinuara** janë një fazë më e zhvilluar se fermat e vetëmbajtjes.
- **Fermt familjare tregtare ose fermt e specializuara** janë faza më e përparuar e zhvillimit të bujqësisë. Ato janë rezultat i drejtëpërdrejtë i rritjes së standardit të jetesës, rritjes së progresit biologjik e agroteknik dhe zgjerimit të tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Ato varen nga dy inpute kryesore **kapitali dhe teknologjia**.

Objektivat e biznesit janë deklarata të rezultateve specifike që një fermer kërkon të arrijë. Organizimi dhe koordinimi i veprimtarive të një biznesi duhet të jenë të tillë që të mundësojnë përbushjen e objektivave të përcaktuara. Çdo fermer duhet të caktojë objektivat e biznesit. Kur vendosin objektivat e biznesit duhet të sigurohen se ata janë të mbështetur në kriteret **Specifike, Matshëm, Arritshëm, Real, Të përcaktuar në kohë**.

Objektivat janë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Por mund të jenë gjithashtu edhe: *konkurruese, të pavarura, plotësuese.*

Dy janë hapat më të rëndësishëm kur caktohen objektivat **identifikimi i objektivave më të rëndësishëm; caktimi i prioritetit ose i radhës së realizimit të tyre.**

Maksimizimi i fitimit konsiderohet si objektiv për të gjithë pronarët e bizneseve, veçanërisht në ekonomi. Procesi i caktimit të prioritetit ose radhës së realizimit të objektivave është mjaft i rëndësishëm. Çdo objektiv mund të renditet i pari në listën e objektivave në varësi të kohës dhe të rrethanave që paraqiten. Prioriteti mund të ndryshojë me ndryshimin e moshës, gjendjes financiare, gjendjes familjare dhe faktorëve të tjerë. Është e rëndësishme të theksojmë se fitimi luan një rol të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë në realizimin e disa objektivave të tjerë.

Kuptimi mbi drejtimin e fermës bujqësore

Fitimi ose humbja e një femeri nga operacionet e biznesit të tij gjatë një viti, është rezultat i veprimit të faktorëve të ndryshëm jashtë kontrollit të fermerit dhe nën kontrollin e fermerit.

- **Faktorët jashtë kontrollit të fermerit** ndikojnë në ndryshueshmërinë e fitimit nga një vit në tjetrin.
 - Faktorë që lidhen me motin (temperatura, reshjet, era etj.), të cilët shkaktojnë ndryshime në fitim sepse ndikojnë në rendimentin për hektar ose produktivitetin për krerë gjatë periudhës së kultivimit, vjeljes dhe tregtimit të prodhimit;
 - Faktorë që shkaktojnë ndryshime të rëndësishme në nivelet e **çmimeve** kombëtare dhe ndërkombëtare.
- **Faktorët nën kontrollin e fermerit** bëjnë që një fermer të ketë kosto më të ulët dhe fitim më të lartë se një tjetër, në të njëjtat kushte dhe në të njëjtin vit janë faktorët **fizikë** dhe faktorët **ekonomikë**.
 - **Faktorët fizikë** përfshijnë: zgjedhjen e varieteteve të bimëve dhe racave të kafshëve, kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, metodat e mbjelljes, metodat e kultivimit, metodat e plehërimit dhe korrjes, numrin e ujitjeve, kontrollin e gërryerjeve, qarkullimin e kulturave bujqësore dhe shumë faktorë të tjerë të ngjashëm me ta. Problemet që lidhen me faktorët fizikë varen nga agronomët, zooteknikët etj.
 - **Faktorët ekonomikë** përfshijnë ndryshimet e mëdha në nivelin e drejtimit dhe në vendimet e marra për drejtimin e biznesit, të cilat lidhen me: llojin e bimëve që do të mbillen, llojin e bagëtisë dhe numrin e krerëve që do të mbarështohen, kohën më të përshtatshme të blerjes së një traktori, metodës më të mirë të financimit të biznesit etj.

Procesi i marrjes së vendimeve është një proces i vazhdueshëm, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme që ndodhin në ekonomi në tërësi dhe në një biznes individual në veçanti. Ndryshimet

thelbësore me të cilat ballafaqohet drejtuesi i fermës janë *ndryshimi në çmime; ndryshimet e motit dhe sëmundjeve; përdorimi i metodave të reja në prodhim ose ndryshimet teknologjike; ndryshimet në njerëzit dhe institucionet me të cilat fermeri ka lidhje.*

Parimet kryesore të drejtimit të fermave janë:

- Njohja e tendencës së çmimeve.
- Zgjedhja e aktiviteteve bujqësore
- Caktimi i strukturës së aktiviteteve bujqësore
- Metodatat drejtuese për rritjen e efektivitetit të prodhimit
- Blerja e faktorëve dhe pajisjeve
- Tregtimi i produkteve bujqësore
- Financimi i biznesit bujqësor
- Menaxhimi i kapitalit dhe i të ardhurave
- Prodhimi për konsum familjar

Llojet e problemeve të drejtimit

Ekzistojnë tre lloje problemesh që duhet të zgjidhë një drejtues ferme:

- Sa të prodhojë
- Si të prodhojë
- Çfarë të prodhojë

Drejtuesi duhet të zgjedhë midis shumë alternativave kombinimin që do të maksimizojë fitimin.

Çdo problem prodhimi me të cilin ballafaqohet një drejtues lidhet me një nga pyetjet e mësipërme.

Zgjidhja e problemeve të mësipërme drejtuese realizohet duke përdorur metoda të ndryshme.

- **Metoda tradicionale.** Drejtuesi i fermës mund të marrë vendime duke u mbështetur në traditën e mëparshme, si p.sh.: ata mund të kultivojnë të njëjtat kultura, në të njëjtën sasi, me të njëjtat metoda për disa vite me radhë.
- **Metoda teknike** Shpesh herë zgjidhjet e problemeve, që trajtuam më sipër, mund të gjenden nëpërmjet shkencave bujqësore dhe shkencave të teknologjisë. Problemi se “çfarë të prodhojmë” mund të zgjidhet duke marrë parasysh pjellorinë e tokës, vegjetacionin dhe kushtet klimatike rajonale.
- **Metoda ekonomike** Ndhima e ekonomistëve në procesin e marrjes së vendimeve është në *llogaritjen e koston.* Fjala kosto këtu trajtohet në kuptimin më të gjerë, duke përfshirë jo vetëm shpenzimet në para, por edhe në kohën e lirë, prodhimin dhe përdorimin e farës ose të diçkaje tjetër, që zotërohet nga fermeri dhe përdoret në fermë.

Procesi i vendimarrjes kalon në disa hapa të rëndësishëm:

- Identifikimi dhe përcaktimi i problemit.
- Mbledhja e të dhënave dhe informacionit;
- Identifikimi dhe analiza e disa alternativave.
- Marrja e vendimit.
- Zbatimi i vendimit.
- Mbikëqyrja dhe vlerësimi i rezultateve.
- Pranimi i përgjegjësisë.

Klasifikimi i vendimeve dhe ambienti i marrjes së tyre

Vendimet e marra nga drejtuesit e fermave mund të klasifikohen në disa mënyra.

- Vendimet organizative
- Vendime operative

- Vendimet strategjike
- Vendime taktike

Marrja e vendimeve

Prodhimi bujqësor shoqërohet nga risku dhe nga pasiguria. Ekzistojnë disa burime të riskut dhe të pasigurisë të cilët mund të klasifikohen në disa mënyra. Një klasifikim i përgjithshëm i burimeve të riskut është si më poshtë:

- risku i prodhimit
- risku i tregut
- risku financiar

Marrja e vendimeve në kushtet e rrishtit dhe pasigurisë nuk është e pamundur por është e vështirë. Drejtimi i fermës me risk dhe pasiguri është një tjetër detyrë e drejtuesit të fermës bujqësore. Risku është një faktor, që duhet të marrë parasysh pothuajse në çdo vendim të drejtuesit të fermës. Funkcionet kryesore të drejtimit të fermave janë planifikimi, zbatimi, kontrolli. Realizimi i funksioneve të drejtimit të fermës lidhet ngushtë me njohjen në mënyrë analitike të fushave të veprimtimit të tij.

Funksionet kryesore të drejtimit të fermave janë: planifikimi, zbatimi dhe kontrolli.

- Planifikimi - është funksioni më i rëndësishëm i drejtimit, sepse përcakton rrugën më të përshtatshme për realizimin e objektivave të fermerit.
- Zbatimi - pasi përfundon planifikimi zgjidhet alternativa më e mirë dhe përcaktohet mënyra e realizimit të saj.
- Kontrolli - analiza dhe vlerësimi i planit në mënyrë progresive gjatë kohës.

Fushat e drejtimit janë: prodhimi, marketingu dhe financa.

Prodhimi është fusha kryesore e drejtimit të fermës. Planet duhen hartuar dhe zbatuar në përputhje me sistemin e prodhimit që do të përdoret për çdo aktivitet bujqësor apo blegtoral. Këtu përfshihet zgjedhja e kombinimit dhe koha e përdorimit të inputeve për çdo aktivitet.

Marketingu. Marrja e vendimeve të drejta për drejtimin e fermës kërkon shumë informacion për çmimet dhe koston e produkteve. Ky fakt e bën të domosdoshëm studimin e marketingut si fushë e dytë e drejtimit të fermës. Rritja e fitimeve kërkon nga fermeri, jo vetëm prodhimin me efektivitet të produkteve bujqësore dhe blegtorale, por edhe të blejë inpute dhe të shesë produktet me një çmim që iu siguron fitim.

Financa. Në fermat familjare, me përjashtim të punës së fermerëve dhe familjes, të gjitha inputet e tjera trajtohen si shpenzime në para. Prandaj fusha e financës dhe fusha e drejtimit financiar është gjithashtu një fushë e rëndësishme për drejtimin e fermës. Në përgjithësi, financa përfshin vendimet që do të merren për përdorimin e fondeve të ndryshme.

Tema 2: Karrierat e punësimeve në fermat bujqësore.

Profesioni, në kuptimin e tij më të rëndomtë përfaqëson një tërësi njohurish, shkathtësish dhe shprehish që duhen për të kryer një tip të caktuar pune. Mirëpo, në thelb, profesioni është një kategori më e ndërlikuar dhe shihet jo thjesht si aftësi potenciale për të zbatuar disa funksione të caktuara në kushtet e ndarjes së punës, por edhe si mënyrë e shprehjes së thelbit të njeriut. Kjo lidhet me faktin se veprimtaria profesionale në kushtet e sotme është sfera kryesore e veprimtarisë jetësore të njeriut dhe zë pjesën më të madhe të kohës aktive të të rriturit. Nëpërmjet veprimtarisë profesionale njeriu synon të plotësojë tri kërkesa kryesore: të sigurojë ekonomikisht ekzistencën; të kryejë një punë që t'i pëlqejë dhe të futet në lidhje dhe marrëdhënie shoqërore sipas interesave të tij. Ushtrimi me sukses

i një veprimtarie profesionale, për shumicën e profesioneve kërkon një përgatitje të posaçme paraprake, domethënë kërkon kualifikim profesional, i cili fitohet nëpërmjet arsimit dhe formimit profesional. Veprimtaria profesionale e njerëzve është e kualifikuar, në qoftë se: përfshin operacione intelektuale; bazohet në njohuri shkencore të përfituara nëpërmjet të nxënës; shërben për qëllime shoqërore të përcaktuara qartë dhe realizohet me një shkallë të lartë përgjegjësie dhe pavarësie. *Profesioni* përbën një kompleks kompetencash (njohuri, shkathtësi, shprehje, qëndrimesh dhe vlerash) të njeriut, që shërben si parakusht për të kryer punë të kualifikuar në një veprimtari prodhimi material apo jo material. Fitohet nëpërmjet të mësuarit sistematik në një institucion arsimit apo formimi ose veprimtarisë në punë, përsoset nëpërmjet rritjes së kualifikimit dhe përvojës së punës. Kategoria ‘profesion’, është paraprirë historikisht nga kategoria ‘punë’. Një **punë** është një pozicion i paguar me funksione, detyra dhe përgjegjësi specifike në një organizatë apo industri të caktuar. (Shembull, pozicioni i Fotografistit në një revistë). Në kontekstin e Listës Kombëtare të Profesioneve “Punët” grupohen në profesione. Pra, një **profesion** është një tërësi punësh me karakteristika të ngjashme të cilat kërkojnë aftësi të ngjashme. (Shembull profesioni- Fotografisti). Sipas shkallës së njohjes, profesionet ndahen në: tradicionale, ku hyjnë profesionet që ekzistojnë prej kohësh në një vend (për shembull profesione që lidhen me punimet artizanale); të reja, kur kemi të bëjmë me profesione të cilat nuk kanë ekzistuar më parë në vend, por kanë qenë të njohura në vende të tjera; dhe absolutisht të reja, profesione të cilat nuk kanë qenë njohur më parë (për shembull, profesione të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit). Të lidhura ngushtë me konceptin ‘profesion’ janë edhe konceptet ‘fushë profesionale dhe ‘familje profesionale’. **Familje profesionale** - Tërësi profesionale të një niveli, për ushtrimin e të cilave kërkohen kompetenca të ngjashme. P.sh., profesionet e punës në makinat metalprerëse (tornitor, frezator etj.). **Fushë profesionale** - Klasifikim i gjerë i profesioneve të veçanta, që lidhen ngushtë me njëri-tjetrin, të cilat kanë të bëjnë me të njëjtin produkt, proces ose shërbim (p.sh., shëndetësia, ndërtimi etj.). Për secilën prej këtyre fushave ekzistojnë profesione me nivele kompetence nga më të ulëtat deri te më të lartat (për shembull, murator, teknik ndërtimi, inxhinier ndërtimi). Struktura e fushës profesionale dhe e familjes së profesioneve është dinamike. Grupimi i profesioneve sipas fushave dhe familjeve të profesioneve është shumë i rëndësishëm për përcaktimin drejt të strukturës dhe përmbajtjes së kualifikimeve që duhet të ofrohen në arsim dhe formim profesional. Një *klasifikim profesionale* është një instrument i cili duhet të sigurojë dhe të prezantojë informacion rreth strukturës aktuale të profesioneve/punëve të një vendi apo rajoni.

Lista Kombëtare e Profesioneve përdoret në mbledhjen dhe përpunimin e statistikave në fusha të tilla si studimet e tregut të punës, planifikimet arsimore, planifikimi i burimeve njerëzore, mbrojtjen e shëndetit në punë dhe analiza të sigurimeve, analiza të pagave etj. për të lehtësuar përdorim ndërkombëtar dhe krahasimin e informacioneve statistikore. Përdoruesit e këtij instrumenti të rëndësishëm për kapjen e informacionit në tregun e punës duhet të bëjnë dallimin ndërmjet termave “profesion” dhe “punë” gjatë përdorimit të saj. Një “profesion” është një koncept teorik i cili përfshin tipe specifike të aftësive dhe përgjegjësive të përbashkëta që zotërojnë personat që punojnë në një profesion të caktuar. Nga ana tjetër, një “punë” përkufizohet si një pozicion i caktuar në një njësi prodhimi/shërbimi të caktuar. Një profesion është një koleksion i punëve të cilat kanë ngjashmëri ndërmjet tyre. Punët brenda një profesioni të caktuar karakterizohen nga një homogjenitet apo ngjashmëri aftësish të kërkuara. Duke identifikuar ngjashmëritë themelore në shprehjet profesionale brenda një profesioni të caktuar, përdoruesit janë në gjendje të gjykojnë lidhur me konceptet e mobilitetit profesional, transferueshmërisë së kompetencave dhe zhvillimit të karrierës në tregun e sotëm të punës.

Referuar Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), në grupin e madh të “Punonjës të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit” janë grupuar 3 nëngrupe të mëdha, 9 nëngrupe të vogla, 22 grupet njësi dhe 191 punët (për më shumë informacion referoju: <http://listakombetareprofesioneve.al>). Punonjësit e

kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit kultivojnë dhe mbledhin prodhimet e fushave ose pemëve, mbjellin dhe shkurtojnë shkurret, mbledhin frutat e bimëve të egra, rrisin, kujdesen ose i gjuajnë kafshët, prodhojnë një shumëllojshmëri produktesh bujqësore dhe shtazore, kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet, rrisin ose zënë peshk dhe kultivojnë ose mbledhin lloje kafshësh të tjera të botës nënujore me qëllim që të sigurojnë ushqim, strehim dhe të ardhura për vete dhe anëtarët e tjerë të familjes. Fuksionet kryesore të këtij grupi të madh janë:

- Kryejnë punimin e tokës.
- Bëjnë mbjelljen e bimëve dhe pemëve.
- Bëjnë spërkatjen, plehërimin dhe korrijen e fushave.
- Kujdesen për rritjen e pemëve dhe bimëve.
- Kryejnë prerjen e shkurreve.
- Rritin dhe mbledhin perime dhe produkte të tjera të kopshtarisë.
- Kryejnë mbjelljen dhe mbledhjen e bimëve të egra.
- Kujdesen për rritjen, shumimin, kujdesin ose gjuajtjen e kafshëve për përdorimin e mishit, qumështit, leshit, lëkurës, prodhimin e mëndafshit, prodhime nga bletaria apo prodhime tjera.
- Kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet.
- Kultivojnë, rritin apo zënë peshkun dhe produkte të tjera ujore.
- Ruajnë dhe kryejnë përpunimin elementar të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.
- Shesin produkte të ndryshme bujqësore dhe blegtorale blerësve të tyre, organizatave të marketingut ose në treg.
- Mbikëqyrin të tjerët.

Ndarja në nëngrupe kryesore:

- Punonjës të kualifikuar të bujqësisë për treg.
- Punonjës të pyjeve, peshkimit, gjahtarë dhe vendosës kurthesh për treg dhe
- Prodhues të produkteve bujqësore, blegtorale, të peshkimit për nevoja familjare, reflekton dallimet në organizimin e punës, kontrollin e cilësisë, përdorimin e prodhimeve reklamuese, përdorimin e farërave të cilësisë së lartë, përdorimin e teknikave tradicionale apo moderne, ujitjen, marrëveshjet për kredi, si dhe shkallën dhe llojin e rregullave për marketingun dhe produktet.

Punëtorët që merren me bujqësi dhe peshkim për nevoja familjare mund të shesin një pjesë të produkteve të tyre në mënyrë që të blejnë artikujt e nevojshëm për jetesën e tyre, për të paguar taksa, tatimet, etj Punonjësit që merren me bujqësi dhe peshkim në pozicione drejtuese klasifikohen në njërin nga grupet, si në vijim:

- Drejtues ekzekutivë (manaxherë)
- Drejtues në bujqësi, gjueti, pyje dhe peshkim
- Agronomë dhe këshillues për ferma dhe pyje
- Teknikë në bujqësi dhe pyje
- Teknikë peshkimi

Punëtorët që punojnë kryesisht me makineri në bujqësi dhe pylltari, klasifikohen në grupe të vogla, të tilla si:

- Punëtorë të makinave të ndryshme bujqësore dhe
- Punëtorë me detyra të thjeshta dhe rutinë, siç janë ndihmësit dhe punëtorët e krahut, që kryesisht janë të detyruar të përdorin vegla dore me disa përpjekje fizike, të cilat kërkojnë pak ose aspak përvojë të mëparshme në të kuptuarit e punës dhe një iniciativë apo gjykim të kufizuar.

Shumica e profesioneve në këtë grup kryesor kërkojnë shkathhtësi në lartësinë e nivelit të dytë të shkathhtësive sipas niveleve të LKP.

Në nëngrupin e madh "Punonjës të kualifikuar të bujqësisë për treg" futen të gjithë punonjësit e kualifikuar të bujqësisë të orientuar drejt tregut, të cilët planifikojnë, organizojnë dhe kryejnë operacione bujqësore për të kultivuar dhe korrur të mbjellat, vjelë pemët, presin shkurret, mbledhin dhe mbjellin fruta të egra. Ata rrisin, kujdesen apo gjuajnë kafshët dhe shpendët, prodhojnë një shumëllojshmëri të produkteve bujqësore dhe shtazore për shitje, si dhe kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet, shesin apo shpërndajnë, tek blerësit me shumicë e pakicë, kryejnë marketing të produkteve të tyre për treg. Ata mund të punësohen në kompani prodhimesh e shërbimesh të produkteve bujqësore dhe blegtorale apo të vetëpunësohen. Punonjësit e kualifikuar të bujqësisë për treg kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- Përgatitin tokën për mbjellje.
- Bëjnë shtimin e kulturave të gjelbërimit me fara, në mënyrë vegjetative, me zhardhok (qepujkë), etj.
- Kryejnë mbjelljen e farave dhe kalemave, sipas llojit, kushteve dhe kërkesave të tyre (temperatura e tokës etj.).
- Kultivojnë perime, bimë të arave, lule dhe bimë dekorative.
- Kryejnë shërbimet e nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e kulturave të gjelbërimit dhe bimëve dekorative (vaditjen, prashitjen, heqjen e barërave të këqija dhe gjetheve të thara, plehërimin, krasitjen, spërkatjen me pesticide, etj.).
- Krijojnë kushtet e përshtatshme në sera (hijezim, ajrim, ngrohje, lagështirë sipas llojit të kulturave të gjelbërimit dhe bimëve dekorative;
- Kryejnë shartime në kultura të caktuara të gjelbërimit në periudhën e përshtatshme;
- Kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet;
- Rritin dhe kujdesen për kafshët, shpendët, bletët, krimbat e mëndafshit, etj.
- Prodhojnë një shumëllojshmëri të produkteve bujqësore dhe shtazore për shitje;
- Shesin, shpërndajnë apo bëjnë marketing për produktet e veta;
- Ruajnë llojshmërinë e florës dhe faunës sonë;
- Ruajnë dhe mirëmbajnë veglat e punës;
- Realizojnë detyra të tjera të ngjashme;
- Mbikëqyrin punëtorët e tjerë;
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kultivues i kulturave bujqësore dhe kopshtarë për treg, futen:

- kultivuesit e kulturave bujqësore dhe kopshtarë për treg, që planifikojnë, organizojnë dhe kryejnë punët që lidhen me rritjen dhe korrjen e kulturave bujqësore.

Ata/ato realizojnë të gjitha proceset e punës së nevojshme për një zhvillim normal të kulturave që nga procesi i mbjelljes deri në mbledhjen, vjeljen e prodhimit duke njohur mirë fazat dhe biologjinë e zhvillimit të tyre dhe përdorimin e mjeteve apo makinerive bujqësore. Këta kultivues mund të punësohen në kompani, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore apo të vetëpunësohen. Kultivuesit e kulturave bujqësore dhe kopshtarë për treg kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- Monitorojnë aktivitetet dhe kushtet, përcaktojnë llojet dhe sasinë e kulturave që do të mbillen dhe planifikojnë koordinimin e prodhimit mbi këtë bazë;
- Përgatitin tokën me punim me dorë ose me makinë dhe shpërndajnë plehrat sipas nevojës;
- Bëjnë zgjedhjen e farërave dhe fidanëve për mbjellje;
- Merren me mirërritjen e kulturave duke kultivuar tokën nëpërmjet transplantimit, krasitjes apo rrallimit të bimëve dhe duke rregulluar pajisjet operationale;

- Kontrollonjë për bimët parazite, insektet ose sëmundjet duke përdorur herbicide dhe pesticide;
- Mbledhin prodhimin duke larguar sëmundjet ose kulturat e dëmshme;
- Inspektojnë, pastrojnë, klasifikojnë, paketojnë, magazinojnë dhe ngarkojnë prodhimin për të dalë në treg;
- Magazinojnë dhe kryejnë procesimin e një sasive të prodhimtarisë;
- Promovojnë dhe marketojnë prodhimet, organizojnë shitjen, blerjen dhe transportimin e prodhimit dhe të mjeteve ndihmëse dhe merren me mirëmbajtjen dhe vlerësimin e të dhënave të transaksioneve dhe aktiviteteve të fermës;
- Respektojnë rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit në punë.

Në nëngrupin “Punonjës të kualifikuar të bujqësisë për treg” punonjësit klasifikohen në:

- **Manaxherë dhe mbikëqyrës të prodhimeve bujqësore**, të cilët planifikojnë, organizojnë dhe kryejnë punët që lidhen me rritjen dhe korrjen e kulturave bujqësore si drithëra, oriz, panxhar, duhan ose patate, lakra apo perime të tjera për shitje apo për shpërndarje në mënyrë të rregullt tek tregtarët me shumicë apo drejtpërdrejtë në treg.
- **Kultivues të perimeve dhe bimëve të arave**, të cilët kryejnë veprime të nevojshme për kultivimin dhe korrjen e drithërave të llojeve të ndryshme si; gruri, misri, thekra dhe drithëra të tjera apo kultivimin e perimeve, të bimëve mjekësore dhe bimë tjera të arave si; orizi, panxhari, kallam sheqeri, duhani, patatet, lakrat, karotat, etj. për shitje apo përdorime vetjake. Ai mund të punësohet në kompani, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore apo të vetëpunësohet.
- **Kultivues të pemëve dhe shkurreve**, të cilët kryejnë veprime të nevojshme për kultivimin e pemëve dhe shkurreve pasi ka bërë më parë studimin, vlerësimin dhe përcaktimin e kushteve tokësore dhe ekonomike të domosdoshme për ngritjen e një pemëtore, vreshti, ullishte apo pylli. Ai realizon të gjitha proceset e punës së nevojshme për një zhvillim normal të kulturave që nga procesi i mbjelljes deri në mbledhjen e prodhimit duke njohur mirë biologjinë e zhvillimit të tyre dhe përdorimin e mjeteve apo makinerive bujqësore. Ai mund të punësohet në kompani komplekse bujqësore, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore apo të vetëpunësohet.
- **Kopshtarë, kultivues të kopshtarisë dhe fidanëve**, të cilët kryejnë veprime të nevojshme për mbjelljen, kultivimin, shtimin, trajtimin dhe mirëmbajtjen e fidanëve të luleve, pemëve apo bimëve të tjera dekorative të prodhimeve të kopshtarisë e të fidanishteve, për shitje apo përdorime vetjake. Ai mund të punësohet në kompani, në parqe, lulishte, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore apo të vetëpunësohet.
- **Kultivues të varieteteve të përziara**, të cilët merren me planifikimin, organizimin dhe kryerjen e punimeve bujqësore për të kultivuar dhe korrur prodhimet, vjelë pemët, pastrojnë shkurret, mbledhin dhe mbjellin frute të egra. Ata rrisin, kujdesen apo gjuajnë kafshët dhe shpendët, prodhojnë një shumëllojshmëri të produkteve bujqësore dhe shtazore për shitje, kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet, shesin, shpërndajnë apo kryejnë marketing të produkteve të tyre për treg. Ata mund të punësohen në kompani shërbimesh bujqësore, prodhimi të produkteve bujqësore dhe blegtorale apo të vetëpunësohen.
- **Punonjës të fermave bujqësore dhe blegtorale**, të cilët kryejnë veprime të nevojshme për kultivimin e kulturave bujqësore (të drithërave, të perimeve, të bimëve mjekësore apo bimë të tjera), kultivimin e pemëve apo shkurreve, kultivimin e prodhimeve të kopshtarisë, të produkteve nga fidanishtet etj., për shitje. Ata merren me mbarëshkrimin e blegtorisë dhe përpunimin e produkteve blegtorale. Ata mund të kryejnë funksione drejtuese dhe mbikëqyrëse në ferma bujqësore dhe blegtorale. Ata mund të punësohen në kompani, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore e blegtorale apo të vetëpunësohen.

Në nëngrupin e madh "Prodhues të produkteve bujqësore, blegtorale, të peshkimit për nevoja familjare" futen të gjithë prodhuesit e produkteve bujqësore, blegtorale, të peshkimit për nevoja familjare dhe planifikojnë, organizojnë dhe kryejnë operacione bujqësore për të kultivuar produkte bujqësore, produkte blegtorale, varietete të përziara, produkte të peshkimit për nevoja familjare. Ata mbjellin, kultivojnë, korrin apo vjelin varietete të kulturave bujqësore. Kujdesen për rritjen, mbarështimin, shumimin e gjësë së gjallë; si kafshët shtëpiake, një thundrakët, delet, derrat, dhitë, kuajt, qentë, macet, shpendët, etj. që do të përdoren për punë, për mish, qumësht, lesh, lëkurë dhe produkte të tjera, për përdorime vetjake. Ata kultivojnë gjallesa ujore në rezervate të përshtatshme apo peshkojnë në bregdet, lumenj dhe liqene. Ata prodhojnë një shumëllojshmëri të produkteve bujqësore dhe blegtorale për nevoja familjare. Ata mund të punësohen në kompani prodhimesh dhe shërbimesh bujqësore, blegtorale apo të vetëpunësohen.

Funksionet kryesore janë:

- Përgatitin tokën për mbjellje dhe kryejnë mbjelljen e farave dhe kalemave në parcela fushe apo sera sipas llojit, kushteve dhe kërkesave të tyre;
- Kryejnë shërbimet e nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e kulturave bujqësore (vadtjen, prashitjen, heqjen e barërave të këqija dhe gjetheve të thara, plehërimin krasitjen, spërkatjen me pesticide;
- Krijojnë kushtet e përshtatshme në sera (hijezim, ajrim, ngrohje, lagështirë) sipas llojit të bimëve;
- Kryejnë vjelje apo korrijen e prodhimit bujqësor (fruta, perime etj.) për nevoja familjare;
- Mbledhin bimët mjekësore, fruta të egra etj;
- Kryejnë magazinimin dhe ruajtjen e tyre në kushtet e duhura;
- Bëjnë konservime të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Prodhonjë një shumëllojshmëri të produkteve bujqësore dhe shtazore për nevoja familjare;
- Kujdesen për rritjen, mbarështimin, shumimin e kafshëve, shpendëve, bletëve etj;
- Kujdesen për ushqimin dhe ujin e gjësë së gjallë sipas kategorive dhe gjendjes fiziologjike të tyre;
- Kryejnë mjeljen e gjësë së gjallë (lopë, dele, dhi me dorë apo me mjete të mekanizuara;
- Kujdesen për rritjen e të vegjëlve të tyre;
- Japin ndihmën e parë me mjekime paraprake në raste të disa sëmundjeve të veçanta;
- Kryejnë pastrimin dhe dezinfektimin e ambientit dhe vendqëndrimin të gjësë së gjallë;
- Kryejnë therjen e kafshëve apo shpendëve për mish apo lëkurë;
- Kryejnë peshkim në bregdet, lumenj dhe liqene;
- Kultivojnë gjallesa ujore në rezervate të përshtatshme për rritjen e tyre;
- Gjuajnë kafshë të egra për nevoja familjare;
- Blejnë, ruajnë dhe mirëmbajnë makineritë dhe pajisjet e punës;
- Realizojnë detyra të tjera të ngjashme;
- Ruajnë llojshmërinë e florës dhe faunës;
- Ruajnë dhe mirëmbajnë veglat e punës;
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Këtu futen:

- ***Prodhues të produkteve bujqësore për nevoja familjare*** që kryejnë veprime të nevojshme për kultivimin dhe korrijen e drithërave, për kultivimin e perimeve, të bimëve mjekësore dhe bimë tjera, të prodhimeve të kopshtarisë, të produkteve nga fidanishtet, për kultivimin e pemëve, shkurreve dhe bimëve të tjera për përdorime vetjak. Ata mund të punësohen në kompani, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore apo të vetëpunësohet.
- ***Prodhues të produkteve blegtorale për nevoja familjare*** që kryejnë veprime të nevojshme për mbarështimin e kafshëve për përdorim familjar duke u kujdesur për sigurimin e ushqimit

dhe furnizimin me ujë për mirërritjen e tyre. Ata monitorojnë dhe kujdesen për kafshët me synimin për të zbuluar ndonjë sëmundje të mundshme dhe për të parë gjendjen e tyre fizike. Kryejnë mbjelljen, therjen, qethjen e kafshëve dhe përpunimin e produkteve blegtorale për nevoja familjare. Ata mund të punësohen në kompani, ferma të ndryshme të prodhimeve blegtorale apo të vetëpunësohen.

- ***Kultivues të varieteteve të përziara për nevoja familjare*** që kryejnë veprime të nevojshme për kultivimin e prodhimeve bujqësore (drithëra, pemëve, shkurret apo bimë të tjera), si dhe për mbarështimin e blegtorisë dhe prodhimin e produkteve blegtorale për siguruar ushqim, strehim dhe një minimum të ardhurash, në të holla, për vete dhe familjet e tyre. Ata ruajnë, në kushte të përshtatshme, produktet e prodhuara për përdorim të mëvonshëm apo kryejnë disa përpunime të prodhimeve bujqësore apo blegtorale. Ata mund të punësohen në kompani, ferma të ndryshme të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale apo të vetëpunësohen.
- ***Prodhues të produkteve të peshkimit për nevoja familjare*** që merren me kapjen apo mbledhjen e peshkut dhe gjallesave të tjera ujore në lumenj dhe liqene ose në ujërat bregdetare duke përdorur rrjeta, grepa dhe pajisje të tjera të thjeshta për këtë lloj peshkimi. Ata gjithashtu merren me seleksionimin, ruajtjen në kushtet teknike të duhura, shitjen e produkteve të mbledhura, për nevoja familjare. Ata mund të kultivojnë peshq, guaca, midhje dhe forma të tjera të gjallesave ujore në sasi minimale. Ata mund të punësohen në kompani të shërbimeve të ndryshme të peshkimit apo të vetëpunësohen

Në nëngrupin e madh “Punonjës të kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit” futen të gjithë punonjësit e kualifikuar të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit që kultivojnë dhe mbledhin prodhimet e fushave ose pemëve, mbjellin dhe shkurtojnë shkurret, mbledhin frutat e bimëve të egra, rrisin, kujdesen ose i gjuajnë kafshët, prodhojnë një shumëllojshmëri produktesh bujqësore dhe shtazore, kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet, rrisin ose zënë peshk dhe kultivojnë ose mbledhin lloje kafshësh të tjera të botës nënujore me qëllim që të sigurojnë ushqim, strehim dhe të ardhura për vete dhe anëtarët e tjerë të familjes. Shumica e profesioneve në këtë grup kryesor kërkojnë shkathtësi në lartësinë e nivelin e dytë të shkathtësive sipas niveleve të LKP.

Funksionet kryesore janë:

- Kryejnë punimin e tokës;
- Bëjnë mbjelljen e bimëve dhe pemëve;
- Bëjnë spërkatjen, plehërimin dhe korrjen e fushave;
- Kujdesen për rritjen e pemëve dhe bimëve;
- Kryejnë prerjen e shkurreve;
- Rritin dhe mbledhin perime dhe produkte të tjera të kopshtarisë;
- Kryejnë mbjelljen dhe mbledhjen e bimëve të egra;
- Kujdesen për rritjen, shumimin, kujdesin ose gjuajtjen e kafshëve për përdorimin e mishit, qumështit, leshit, lëkurës, prodhimin e mëndafshit, prodhime nga bletaria apo prodhime tjera;
- Kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet;
- Kultivojnë, rritin apo zënë peshkun dhe produkte të tjera ujore;
- Ruajnë dhe kryejnë përpunimin elementar të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale;
- Shesin produkte të ndryshme bujqësore dhe blegtorale blerësve të tyre, organizatave të marketingut ose në treg;
- Mbikëqyrin të tjerët.

Këtu futen:

- ***Punonjës të kualifikuar të bujqësisë për treg*** që planifikojnë, organizojnë dhe kryejnë operacione bujqësore për të kultivuar dhe korrur të mbjellat, vjelë pemët, presin shkurret, mbledhin dhe mbjellin fruta të egra. Ata rrisin, kujdesen apo gjuajnë kafshët dhe shpendët,

prodhojnë një shumëllojshmëri të produkteve bujqësore dhe shtazore për shitje, si dhe kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet, shesin apo shpërndajnë, në baza të rregullta tek blerësit me shumicë e pakicë, kryejnë marketing të produkteve të tyre për treg. Ata mund të punësohen në kompani prodhimesh e shërbimesh të produkteve bujqësore dhe blegtorale apo të vetëpunësohen.

- ***Punonjës të pyjeve, peshkimit, gjahtarë dhe vendosësh kurthesh për treg*** që kujdesen për pyjet natyrore dhe plantacionet, kultivojnë, mbjellin dhe pastrojnë nga shkurret, kultivojnë, ruajnë dhe shfrytëzojnë pyjet, mbledhin frutat e bimëve të egra, gjuajnë kafshët, zënë peshk në det, lumenj dhe liqene, kultivojnë dhe rrisin peshk dhe gjallesa të tjera të botës ujore. Ata mund të punësohen në kompani prodhimesh dhe shërbimesh bujqësore a pyjore apo të vetëpunësohen.
- ***Prodhues të produkteve bujqësore, blegtorale, të peshkimit për nevoja familjare*** që planifikojnë, organizojnë dhe kryejnë operacione bujqësore për të kultivuar produkte bujqësore, produkte blegtorale, varietete të përziera, produkte të peshkimit për nevoja familjare. Ata mbjellin, kultivojnë, korrin apo vjelin varietete të kulturave bujqësore. Kujdesen për rritjen, mbarështimin, shumimin e gjësë së gjallë; si kafshët shtëpiake, një thundrakët, delet, derrat, dhitë, kuajt, qentë, macet, shpendët, etj. që do të përdoren për punë, për mish, qumësht, lesh, lëkurë dhe produkte të tjera, për përdorime vetjake. Ata kultivojnë gjallesa ujore në rezervate të përshtatshme apo peshkojnë në bregdet, lumenj dhe liqene. Ata prodhojnë një shumëllojshmëri të produkteve bujqësore dhe blegtorale për nevoja familjare. Ata mund të punësohen në kompani prodhimesh dhe shërbimesh bujqësore, blegtorale apo të vetëpunësohen.

Tema 3: Parimet ekonomike të drejtimit të fermave bujqësore

Marrëdhëniet prodhuese në bujqësi.

Ekonomistët dhe drejtuesit janë të interesuar të dinë se çfarë ndryshimesh do të ketë nga një ndryshim i një ose më shumë faktorëve që janë nën kontrollin e tij. ***Marxhinalizimi*** tregon ndryshimet në rritje ose rënie që ndodhin në kufijtë e sasive ose vlerave. Për të llogaritur një ndryshim marxhinal është e nevojshme të gjejmë diferencën ndërmet vlerës së re dhe vlerës fillestare. Vlera e re del nga ndryshimi i faktorit të kontrollueshëm. Lidhjet midis sasisë së një faktori të ndryshueshëm të përdorur dhe prodhimit mund të marrim tri forma të përgjithshme:

- *konstant*
- *në rritje*
- *në rënie*

Dy treguesit kryesorë të prodhimit janë:

- ***Prodhimi fizik mesatar që*** tregon sasinë mesatare të prodhimit për çdo njësi faktori të ndryshueshëm, në çdo nivel të përdorimit të tij.
- ***Prodhimi fizik marxhinal që*** llogaritet duke vënë në raport ndryshimin e prodhimit fizik total me ndryshimin e sasisë së faktorit të përdorur:

Raportet dhe cilësia e faktorëve të përdorur për të prodhuar produkte bujqësore quhet teknologji e prodhimit bujqësor.

Konceptet dhe marrëdhëniet e kostove në bujqësi

- **Kostot fikse totale** janë ato elementë të kostos që lidhen me përdorimin e burimeve

prodhuese ose pasurive të pandryshueshme të fermës.

Kostot fikse janë:

- *Kostoja fikse totale (CFT)*
- *Kostoja fikse mesatare (CFM)*

Përderisa kostoja fikse është një vlerë që nuk ndryshon, pavarësisht nga sasia e prodhimit, kostoja fikse mesatare do të jetë vazhdimisht në rënie kur prodhimi është në rritje.

- **Kostot variabël** që përbëhen nga ato elemente të kostos që, fermeri i ka nën kontroll deri në një çast të dhënë kohe. Dy llojet e kostove variabël janë:
 - *Kostoja variabël totale (CVT)*
 - *Kostoja variabël mesatare*
- **Kostoja totale (CT)** e prodhimit është shuma e kostos variabël totale dhe kostos së fikse totale.
- **Kostoja totale mesatare (CTM)** mund të llogaritet me dy mënyra: si shumë e kostos variable mesatare dhe kostos fikse mesatare duke pjesëtuar koston totale me prodhimin fizik gjithsej.

Analiza margjinale dhe ligji i fitimit

Ligji i fitimeve në rënie është ligji natyror bazë dhe paraqitet në tri forma:

- **Prodhimi fizik marxhinal në rënie** përcakton se kur rriten një ose më shumë faktorë të ndryshueshëm të përdorur në prodhimin e një produkti dhe të tjerët mbeten konstantë, prodhimi fizik marxhinal, për çdo njësi shtesë të faktorit ose të faktorëve të ndryshueshëm, pasi ka arritur një nivel të caktuar, fillon të bjerë.
 - *Prodhimet fizike marxhinale në rënie* ekzistojnë sepse *shtesa e një faktori të ndryshueshëm, realizohet në kombinim me një ose më shumë faktorë të pandryshueshëm.*
 - *Prodhimet fizike marxhinale në rënie* ekzistojnë sepse *prodhimi bujqësor mbështetet në proceset biologjike të bimëve dhe kafshëve.*
- **Fitimet ekonomike në rënie** tregojnë se kur një ose më shumë faktorë të ndryshueshëm, të përdorur në prodhimin e një produkti rriten, kur faktorët e tjerë mbeten të pandryshueshëm, pasi arrihet një pikë e caktuar, fitimet ekonomike për çdo njësi shtesë të faktorit ose faktorëve të ndryshueshëm, *synojnë të bien menjëherë ose pas një faze fillestare të rritjes së tyre.*

Zgjedhja e nivelit të prodhimit që rrit fitimin.

Për të përcaktuar nivelin e prodhimit që maksimizon fitimin bazohemi në dy koncepte ekonomike:

- **E ardhura marxhinale** përcaktohet si ndryshim në të ardhura ose shtesë e të ardhurave të marra nga shitja e një njësie më shumë prodhimi.
- **Kostoja marxhinale** përcaktohet si ndryshim në koston gjithsej ose shtesën e kostos nga prodhimi i një sasive tjetër prodhimi.

Niveli i prodhimit që maksimizon fitimin arrihet në pikën ku e ardhura marxhinale është e barabartë me koston margjinale. Type equation here.

Zgjedhja e kombinimit të faktorëve prodhues

Procedura që ndiqet për llogaritjen e kombinimit me kosto minimale, nëpërmjet parimit të raportit margjinal të zëvendësimit, është si më poshtë:

- *Llogarisim raportin margjinal të zëvendësimit*

$$R_{Mz} = \frac{\text{Sasia e pakësuar e faktorit të parë}}{\text{Sasia e shtuar e faktorit të dytë}}$$

– *Llogarisim raportin e çmimit*

$$R_{\zeta} = \frac{\text{Çmimi i faktorit në rritje}}{\text{Çmimi i faktorit në rënie}}$$

Gjejmë kombinimin e faktorëve me kosto minimale duke vazhduar zëvendësimin e një faktori me një tjetër deri në momentin kur raporti i çmimit është më i vogël ose i barabartë me raportin marginal të zëvendësimit: $R_{\zeta} \leq R_{MZ}$.

Kur faktorët zëvendësohen me **raporte konstante**, kombinimi me kosto minimale, gjendet duke përdorur **të gjithë sasinë e faktorit që kushton më pak**, në sasinë e faktorëve të përdorur.

Zgjedhja e kombinimit të aktiviteteve që rrit fitimin

Zgjedhja e kombinimeve që rrisin fitimin bëhet nga një numër i madh aktiviteteve prodhimi, si: perime, grurë, fasule, pambuk, viça për mish, derra, shpendë etj. Lista e aktiviteteve në të cilat do të zgjidhet kombinimi, mund të pakësohet si rezultat i ndikimit të një sërë faktorësh të kufizuar, si: klima, toka, periudha e vegjetacionit etj. Në të gjitha rastet supozohet që një ose më shumë faktorë janë të kufizuar, të cilët vendosin kufirin e sipërm mbi sasinë që mund të prodhohet nga një aktivitet i vetëm ose nga një kombinim. Hapi i parë në përcaktimin e kombinimit të aktiviteteve që rrisin fitimin është përcaktimi i lidhjeve fizike midis tyre. Ekzistojnë tri lloje aktiviteteve:

- **Aktivite konkurruese** - një sasi e kufizuar e faktorit tokë, kapital, punë dhe e faktorëve të tjerë, bën që prodhimi nga një aktivitet mund të rritet vetëm nga pakësimi i prodhimit të një aktiviteti tjetër. Këto aktivitete **quhen konkurruese** sepse ato *konkurrojnë për përdorimin e një sasi të njëjtë faktori të kufizuar dhe në të njëjtën kohë*.
- **Aktivite suplementare**. Dy aktivitete janë suplementare nëse prodhimi i njërit mund të rritet pa ndikuar në nivelin e prodhimit tjetër. Por rritja e një prodhimi pa ndikuar në tjetrin ka një kufi. Ky kufi tregon që më pas këto dy prodhime bëhen konkures në lidhje me një faktor të kufizuar.
- **Aktivite plotësuese**. Dy aktivitete janë plotësuese nëse rritja e prodhimit të një aktiviteti ndikon në rritjen e aktivitetit tjetër në të njëjtën kohë.

Rregullat e prodhimit marrin parasysh periudhën për të cilën do të merren vendimet, nëse do të jetë periudhë afatshkurtër apo periudhë afatgjatë.

Në periudhën afatshkurtër ka tre rregulla për marrjen e vendimeve të prodhimit:

- Çmimi i pritur i shitjes është më i madh se minimumi i koston gjithsej mesatare.
- Çmimi i pritur i shitjes është më i vogël se minimumi i koston gjithsej mesatare.
- Çmimi i pritur i shitjes është më i vogël se minimumi i koston së ndryshueshme mesatare.

Në periudhën afatgjatë për marrjen e vendimeve të prodhimit janë këto mundësi:

- Çmimi i shitjes është më i madh se kostoja gjithsej mesatare.
- Çmimi i shitjes është më i vogël se kostoja gjithsej.

Tema 4: Teknikat e buxhetimit dhe të planifikimit bujqësor

Buxheti i një aktiviteti është një organizim i të ardhurave, kostove dhe fitimit për një aktivitet të vetëm. Buxhetet e aktiviteteve përdoren për dy qëllime kryesore:

- Identifikimin e aktiviteteve më fitimprurëse.
- Për të shërbyer si burim të dhënash për llojet e tjerë të buxhetit.

Shumica e buxheteve përmbajnë seksionin e të ardhurave dhe atë të kostove. Ky i fundit ka lidhje me kostot dhe është i ndarë në dy grupe: *kostot variable* dhe *kostot fikse*.

Fitimi i planifikuar për çdo njësi, gjendet si diferencë midis të ardhurave totale dhe kostove totale. Çdo fermer është i interesuar për fitimin e planifikuar për çdo njësi, ndaj është e rëndësishme interpretimi korrekt. Shumica e buxheteve janë buxhete ekonomike. Kjo do të thotë që, krahas shpenzimeve monetare dhe amortizimit, përfshihen dhe shpenzime jomonetare ose kostot oportune. Kostot tipike oportune janë kostot për punën e fermerit dhe familjes, kostot për kapitalin e përdorur për shpenzime variabël, për makineritë dhe investimin për tokën. Fitimi ose shpërblimi i paraqitur në një buxhet aktiviteti është një fitim ekonomik i parashikuar

Veçoritë e buxhetit të aktiviteteve blegtorale. Disa veçori kryesore të buxhetit të aktiviteteve blegtorale janë:

- Njësia e llogaritjes së buxhetit
- Periudha e hartimit të buxhetit
- Produkte shumëfishe
- Zëvendësimi i kopesë themelore
- Ushqimi dhe kullotat
- Ndërtesat dhe pajisjet blegtorale
- Traktorë dhe pajisje

Interpretimi dhe analiza e buxhetit të aktiviteteve

Një buxhet ekonomik do të thotë që kostoja oportune e punës, e kapitalit, e tokës dhe e drejtimit janë përfshirë si shpenzime në buxhet. Të dhënat e një buxheti të aktiviteteve mund të përdoren për të bërë disa lloje analizash që përfshijnë llogaritjen e:

- *Kostos së prodhimit* që përdoret për të përshkruar koston mesatare të prodhimit për një njësi produkti.
- *Analizës kufi*. Të dhënat e një buxheti të aktiviteteve mund të përdoren për të bërë disa lloje analizash.

Buxheti i pjesshëm i fermës bujqësore. *Buxheti i pjesshëm siguron një metodë të thjeshtë dhe të qëndrueshme për të llogaritur ndryshimin e pritshëm të fitimit nga një ndryshim i propozuar në biznesin bujqësor.* Vendimet më të rëndësishme ku mund të përdoret buxheti i pjesshëm janë, shtimi i një sipërmarrjeje të re; blerja e një traktori, përdorimi i një plehu ose herbicidi të ri, zgjedhja e kohë së shitjes së drithit, etj. Mbi bazën e këtyre vendimeve propozohen ndryshime ose veprime alternative për një pjesë të biznesit të fermës, që mund të marrin formën e tri lidhjeve të mëposhtme: faktor-prodhim, fakto faktor, prodhim-prodhim. Buxheti i pjesshëm është i përshtatshëm kur disa shpenzime dhe të ardhura duhet të mbahen konstante. Ka forma të ndryshme të buxhetit të pjesshëm, por të gjithë janë të përbërë nga katër elemente të ardhurat shtesë, kostot e reduktuara, kostot shtesë, të ardhurat e reduktuara. Hartimi i një plani të përgjithshëm të fermës kalon në disa hapa:

- Formulimi i qëllimeve dhe objektivave
- Inventarizimi i burimeve prodhuese
- Inventarizimi i tokës
- Inventarizimi i ndërtesave
- Inventarizimi i punës
- Inventarizimi i makinerive
- Inventarizimi i kapitalit qarkullues
- Inventarizimi i drejtimit

- Burime të tjera
- Përcaktimi i aktiviteteve dhe i koeficienteve teknike
- Përcaktimi i fitimeve bruto ose të ardhurat mbi kostot variable
- Zgjedhja e strukturës së aktiviteteve
- Përgatitja e buxhetit total ose e buxhetit të përgjithshëm të fermës

Buxheti total i fermës mund të përdoret për qëllimet e mëposhtme:

- Të përcaktojë të ardhurat e pritshme, shpenzimet dhe fitimin për një plan të dhënë;
- Të përcaktojë hyrjen dhe daljen e parave si dhe likuiditetin për një plan të dhënë;
- Të krahasojë efektet e planeve alternative mbi dobishmërinë dhe likuiditetin;
- Të përcaktojë efektet e zgjerimit ose rritjes së planit aktual;
- Të përcaktojë nevojat dhe përdorshmërinë e burimeve të tilla si të kapitalit, punës, kafshëve në rritje ose ujit për ujtitje;
- Të komunikojë planin huadhënësit, pronarit, partnerit ose aksionarëve.

Buxheti total i fermës përbëhet nga:

Plani i prodhimit bujqësor që përmbledh kulturat bujqësore që parashikohen të kultivohen, prodhimin dhe destinacionin e përdorimit të tij.

Plani i prodhimit blegtoral që përbëhet nga plani i numrit të krerëve dhe plani i prodhimit.

Plani i numrit të krerëve që përcakton llojin dhe numrin e kafshëve.

Plani i prodhimit që përmbledh llojin e produkteve blegtorale dhe destinacionin e tyre.

Plani i bazës ushqimore që përdoret për të gjykuar mbi sasinë e ushqimeve që kërkohen për kafshët si dhe çfarë sasive ushqimesh do të prodhohen apo dhe blihen.

Plani i shpenzimeve përdoret për të gjykuar mbi shpenzimet vjetore.

Buxheti i të ardhurës neto të fermës tregon dobishmërinë e parashikuar për një plan të propozuar.

Karakteristikat, struktura dhe ndërtimi i një buxheti të hyrjeve dhe daljeve të parasë

Struktura e një buxheti të hyrjeve dhe daljeve të parasë përbëhet nga 2 pjesë:

- **burimet** e mundshme të sigurimit të parave dhe
- **drejtimit** e mundshme të përdorimit të parave.

Ekzistojnë 5 **burime** të mundshme të sigurimit të parave në biznesin e fermës:

- gjendja e parave në fillim të periudhës;
- të ardhurat në para nga shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- paratë e marra nga shitja e mjeteve afatgjata
- paratë e marra jashtë biznesit.
- marrja e kredive.

Drejtimit më kryesor të përdorimit ose të daljes së parave janë:

- *Shpenzimet operative bujqësore* ku përfshihen shpenzimet normale dhe të zakonshme për sigurimin e të ardhurave.
- *Blerja e mjeteve afatgjata* përfshin sasinë e parave që përdoret për blerjen e një pasurie të re kapitale.
- *Shpenzime jashtë fermës dhe shpenzime të tjera* ku përfshihen paratë që përdoren për jetesë, taksat mbi të ardhurat dhe siguracionet që nuk kanë lidhje me fermën.
- *Pagesat e detyrimeve* mund të përfshihen këtu në qoftë se nuk janë përfshirë në shpenzimet operative të fermës. *Diferenca midis parave të siguruar gjatë një periudhe kohe me*

nevojat për para gjatë të njëjtës periudhë kohe tregon për gjendjen e parave që do të jenë të lira në fund të periudhës.

Përdorimet e buxhetit të hyrjeve dhe daljeve të parasë

Disa nga përdorimet më të rëndësishme të përdorimit të buxhetit të hyrjeve dhe daljeve të parasë janë:

- Projektimi i kohës dhe i sasisë së kredisë së nevojshme, si dhe i kohës dhe i sasisë së kredisë së shlyer.
- Sugjerimi i mënyrës dhe rrugës për të realizuar blerjet e faktorëve të prodhimit dhe për të bërë pagesat e kredive, duke minimizuar kostot e kredive.
- Ofrimi i këshillave financiare dhe përcaktimin e pikave më të dobëta dhe më të fuqishme të biznesit duke u bazuar në buxhetin e hyrjeve dhe daljeve të parasë nga banka ose kredidhënës të tjerë.
- Planifikimi i taksave, duke treguar si ndikojnë taksat për kohën e blerjes, shitjes dhe zgjerimit të kapitalit.
- Këshillimi i rrugëve për përmirësimin e situatës në momente jobalancimi të kreditit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Përdorimi si një pjesë e sistemit të analizës dhe kontrollit të lëvizjes së parave gjatë vitit,

Praktikat e marketingut dhe planifikimi i tij

Problemet e marketingut bujqësor janë karakteristike për një bujqësi të specializuar ku dominojnë fermat familjare tregtare (komerciale). Për fermat e vetëmbajtjes problemet e marketingut nuk përbëjnë ndonjë problem pasi ato prodhojnë dhe shesin shumë pak. Praktikrat e marketingut janë shumë të rëndësishme dhe ndikojnë në fitimet e fermë. Ato ndikojnë edhe për fermat që prodhojnë vetëm dy ose tri produkte në sasi të mëdha dhe që blejnë shumicën e elementëve që përdoren në prodhim dhe për jetesën e familjes. Praktikrat e marketingut ndryshojnë nga një rajon në tjetrën dhe nga një fermë në tjetrën. Këto ndryshime nuk janë të rastësishme, por ato mbështeten në disa faktorë kryesor që ndikojnë në marketingun bujqësor, siç janë:

- *Largësia midis qendrave të prodhimit dhe qendrave të konsumit* - produktet bujqësore mund të shiten vetëm te konsumatorët, të cilët i dëshirojnë dhe që kanë fuqi blerëse për t'i blerë ato. Distanca nga tregu është një faktor i rëndësishëm që ndikon në kostot e marketingut dhe në llojin e produktit që do të prodhohet.
- *Karakterit sezonal i shumicës së produkteve bujqësore krahasuar me kërkesën e vazhdueshme nga konsumatorët.* Prodhimi bujqësor karakterizohet nga ligje biologjike, ndaj dhe ai nuk mund të konsiderohet si një model i prodhimit uniform.
- *Standarde dhe cilësi të ndryshme të kërkuar nga konsumatorët* kërkojnë standard dhe cilësi të ndryshme për çdo produkt bujqësor. Cilësia e një produkti të përdorur për konservim ose ruajtje frigoriferike ndryshon nga cilësia e të njëjtit produkt të shitur për konsum të freskët.
- *Shërbimet e shumta që kërkojnë konsumatorët, lidhur me produktin, kohën, vendin, etj.* Sa më shumë rritet kompleksiteti i shoqërisë, aq më shumë rritet shkalla dhe gjerësia e këtyre shërbimeve.

Tema 5: Drejtimi i fermës në kushtet e rriskut dhe pasigurisë

Llojet e riskut në bujqësi dhe qëndrimet e fermerëve ndaj tij.

Fermerët që kultivojnë kultura bujqësore duhet të marrin vendime për kultura që do të mbjellin dhe për normat e farës, nivelin e plehut dhe inputet e tjera, në fillim të sezonit bujqësor. Rendimentet përfundimtare dhe çmimet për prodhimet e këtyre kulturave bujqësore, që do të merren disa muaj më vonë, nuk njihen me siguri. Sa më e madhe të jetë pasiguria aq më i madh është risku. Pasiguria ka të bëjë me mosparashikimin e asaj që do të ndodhë në të ardhmen, kurse risku shpreh anën sasiore të pasigurisë.

Risku dhe pasiguria ndikojnë:

- në sasinë e burimeve ose faktorëve të përdorur,
- në kombinimin e produkteve të prodhuara,
- në rritjen e vështirësisë së marrjes hua të parave për shkak të ndryshimit të normave të interesit,
- në rritjen e vështirësisë për marrjen e vendimeve.

Në një mjedis ku ekziston risku vendimet merren duke përdorur disa lloje mesataresh ose “vlera të pritura” për rendimentin, koston dhe çmimet.

Burime të riskut në bujqësi janë të tri fushat e drejtimit të fermës: *prodhimi, marketingu* dhe *financa*. Në përputhje me këtë ekzistojnë: *Risku i prodhimit dhe risku i tregut* përbëjnë riskun e biznesit. Risku i biznesit përfshin faktorët që ndikojnë në nivelin e të ardhurës neto të fermës.

Risku financiar përfshin ndryshueshmërinë e normave të interesit, mundësinë për të gjetur hua të reja dhe ndryshueshmërinë e lëvizjes së parave, që shkaktohen nga risku i prodhimit dhe i tregut ose risku i biznesit.

Elementet e vendimeve me risk.

Marrja e vendimeve me risk tregon që çdo fermer ka nevojë të dijë dhe të kuptojë se si bëhen ose llogariten parashikimet dhe si përdoret probabiliteti në bërjen e parashikimeve.

Përdorimi i probabilitetit është shumë i rëndësishëm kur bëhet parashikimi i rezultateve të ardhshme. Probabiliteti tregon numrin e rasteve që mund të ndodhë një ngjarje e mundshme.

Probabilitetet janë dy llojesh:

- *Probabilitetet objektive* ose aktuale që llogariten mbi bazën e të dhënave reale të regjistruara nga burime të ndryshme.
- *Probabilitetet subjektive* që përcaktohen nga informacioni i siguruar nga burime të ndryshme plus përvojën dhe qëndrimet e individit.

Hapat për marrjen e vendimeve me risk.

Procesi i marrjes së vendimeve me risk kalon në këto hapa:

- *Përcaktimi i burimeve të mundshme të riskut* duke marrë parasysh llojin e vendimit që do të marrë fermeri.
- *Përcaktimi i ngjarjeve të mundshme* të cilat ndikohen nga faktorë të tillë si: moti, sëmundjet, insektet, barërat e këqija, ushqimet e konservuara dhe pjelloria e tokës.
- *Përcaktimi i strategjive alternative* para se të merret vendimi duhet për të gjetur alternativën më të mirë, në përputhje me qëndrimin ndaj riskut dhe nivelit të pranimit të tij.
- *Përcaktimi i rezultateve për çdo alternativë* pas përcaktimit të alternativave.
- *Vlerësimi i marrëdhënieve midis riskut dhe fitimeve* nisët nga disa kritere që bazohet në marrëdhëniet midis riskut dhe fitimit:
 - *Ngjarja me probabilitet më të madh*- sipas këtij kriteri përcaktohet ngjarja që ka probabilitetin më të madh dhe zgjidhet alternativa që ka vlerë më të madhe.
 - *Maksimizimi i vlerës së pritur* - ky kriter kërkon të zgjidhet alternativa me vlerë të pritur më të lartë. Vlëra e pritur paraqet rezultatin mesatar për një alternativë të veçantë.

- *Krahasimi i fitimeve dhe riskut* - fermerët që kundërshtojnë riskun duhet të marrin parasysh fitimet e pritura dhe risqet që shoqërojnë alternativat e ndryshme. Një alternative që ka vlerë të pritur më të ulët dhe risk më të lartë se një tjetër duhet të përjashtohet.
- *Maksiminë*- ky kriter përqendrohet në rezultatet më të këqija për çdo alternativë duke mos i marrë parasysh rezultatet e tjera. Kriteri i maksiminëve përdoret kur marrësi i vendimit supozon se nuk ka rëndësi alternativa pasi do të ndodhë rezultati më i keq.
- *Fitimet minimale*. - për shkak të gjendjes financiare marrësi i vendimit mund të dëshirojë një probabilitet më të lartë për një fitim minimal.

Metodat që kontrollojnë dhe pakësojnë riskun në bujqësi

Momenti i rëndësishëm kur studiohet risku dhe pasiguria është përcaktimi i metodave të drejtimit ose kontrollit të riskut.

Metodat që kontrollojnë riskun e prodhimit janë:

- *Zgjedhja e aktiviteteve të qëndrueshme* që karakterizohen nga stabiliteti në të ardhura, nga një vit në tjetrin. Zgjedhja e aktiviteteve më dobiprurëse kalon në disa hapa:
 - **Inventarizimi i tokës.** Këtu përfshihen: klima, pjelloria e tokës dhe burimet e ujit për ujitje. Në fushat ku kulturat bujqësore janë të ndjeshme ndaj motit, fermerët zgjedhin kulturat që përshtaten mirë ndaj thatësirës së motit ekstrem.
 - **Përcaktimi i kulturave bujqësore alternative.** Bazuar në burimet dhe rajonizimin e kulturave bujqësore në përputhje me kërkesat e tregut.
 - **Përcaktimi i vazhdimësisë së kulturave.** Kjo do të thotë që pasi një kulturë është prodhuar, të ketë kohë të mjaftueshme për mbjelljen e kulturës tjetër.
 - **Marrja parasysh e kërkesave për punë dhe kapital.** Kërkesat mujore për punë mund të analizohen duke u bazuar në një kalendar të hollësishëm të veprimeve.
- *Kombinimi i prodhimi* e pakëson riskun e tij. Zgjedhja e një kombinimi të drejtë të aktiviteteve që do të zhvillohen në fermë, mundëson kontrollin e riskut duke studiuar ndryshueshmërinë e çmimit dhe të prodhimit
- *Fleksibiliteti i prodhimit* tregon aftësinë për të bërë rregullime në veprimet që kryhen në fermë.

Metodat që kontrollojnë riskun e tregut.

Risku i tregut ekziston për shkak të ndryshueshmërisë së çmimeve të produkteve bujqësore dhe se prodhuesi nuk e di se si do të jetë çmimi në të ardhmen, kur merr vendimin për të prodhuar një produkt. Ka disa metoda për të pakësuar riskun e tregut e konkretisht janë:

- *Kontratimi i mëparshëm* është metoda më e përhapur për të kontrolluar riskun e tregut.
- *Magazinimi për shitje të mëvonshme ose shpërndarja e tregut* është një metodë e rëndësishme që kontrollon dhe ul riskun e tregut.

Metodat që kontrollojnë riskun financiar. Risku ka efekte të mëdha në drejtimin financiar të biznesit. Siç e dihet, likuiditeti është aftësia e pasurisë për t'u kthyer në para. Shembuj të pasurive likuide janë pagesat qeveritare, librezat e kursimit, inventaret e produkteve bujqësore dhe blektorale dhe paratë në dispozicion të biznesit etj.

Sigurimi mund të jetë një pagesë ose një pagese ose një kosto minimale për të përballuar një humbje të madhe. Një fermer mund të bëjë sigurimin e pronës, të prodhimeve bujqësore, e jetës dhe atë shëndetësor.

Kategoritë e riskut në bujqësi janë të grupuar më poshtë:

Risku i prodhimit: Bujqësia shpesh karakterizohet nga ndryshimet e mëdha të prodhimit ose risku i prodhimit. Ndryshe nga bizneset e tjera, fermerët nuk janë të aftë të parashikojnë me saktësi sasinë e

prodhimit për shkak të faktorëve të jashtëm, si moti (rreshjet, temperaturë ekstreme), insektet dhe sëmundjet.

Risku i çmimit ose i tregut: Lulatja e çmimeve të inputeve dhe prodhimeve është një burim i rëndësishëm i riskut të tregut në bujqësi. Ndryshimi i çmimit të prodhimit fillon nga tregu. Tregjet e segmentuara bujqësore ndikohen kryesisht nga oferta lokale dhe kushtet e kërkesës, ndërsa tregjet më të integruara në nivel global ndikohen shumë nga dinamika ndërkombëtare e prodhimit. Në tregjet lokale, risku i çmimit shpesh reduktohet me efektin “mbrojta natyrore”, në të cilin një rritje e prodhimit vjetor tenton të zvogëlojë çmimin e prodhimit. Në tregjet e integruara, një reduktim i çmimit në përgjithësi nuk është i lidhur me kushtet e ofertës lokale dhe prandaj ndryshimet e çmimit mund të ndikojnë shumë tek prodhuesit. Një tjetër lloj i riskut të tregut lind në procesin e shpërndarjes të prodhimit në treg. Paaftësia për të shpërndarë produktet që prishen shpejt, në tregjet e duhura në kohën e duhur mund të dëmtojë prodhimin e fermerëve. Mungesa e infrastrukturës dhe tregjeve të zhvilluara mirë e bën këtë një burim të rëndësishëm të riskut.

Risku financiar: Mënyra si bizneset financojnë aktivitetet e tyre është shqetësimi kryesor për shumë aktivitete ekonomike; bujqësia gjithashtu ka veçoritë e veta. Shumë cikle prodhimi bujqësor shtrihen në periudha të gjata kohe, dhe fermerët duhet të parashikojnë shpenzimet që ata do mund t'i rekuperojnë pasi produkti ka dalë në treg. Kjo krijon probleme potenciale të rrjedhës të parave dhe thellohet nga mungesa e aksesit në shërbimet e sigurimeve, marrja e kredive dhe kostoja e madhe e marrjes borxh. Këto probleme klasifikohen si risk financiar.

Risku institucional: Një tjetër burim i rëndësishëm i pasigurisë për fermerët është risku institucional i gjeneruar nga ndryshimet e papritura të rregullave, ligjet që ndikojnë aktivitetet e fermerëve. Ndryshimet në ligje, shërbime financiare, pagesat në mbështetje të nivelit të çmimit ose të ardhurave dhe asistencë financiare mund të ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme produktivitetin ose efektivitetin e aktiviteteve bujqësore. Risqet institucionale përfshijnë dhe riskun e prishjes të kontratës.

Risku teknologjik: Fermerët janë përgjegjës për të gjitha pasojat e aktiviteteve të tyre. Zbatimi i teknologjive të reja në modernizimin e bujqësisë, siç është futja e bimëve të modifikuara gjenetiki shkakton një rritje të riskut të detyrimeve të prodhuesit.

Risku personal: Familjet bujqësore janë të ekspozuara ndaj risqeve personale, që ndikojnë jetën dhe mirëqënien e njerëzve që punojnë në fermë dhe, gjithashtu, ndaj riskut të aseteve nga përmytjet, zjarri, thatësira dhe dëmtime të mundshme ose vjedhje të pajisjeve të prodhimit dhe ndonjë aset tjetër në fermë.

Tema 6. Përshkrimet e punës të personelit në fermat bujqësore.

Analiza e vendit të punës mundësohet kur ekziston formulari i plotësuar në mënyrë korrekte dhe sipas udhëzimeve “Përshkrimi i vendit të punës”. Ky formular shërben për identifikim dhe përcaktimin e vendit të caktuar të punës në grupin përkatës të punëve dhe të përcaktimit të klasës përkatëse të pagesës. Analiza e formularit bazohet në:

- krahasimin e shkallës së përgatitjes profesionale të kërkuar,
- emërtimin e vendit të punës,
- përmbajtjen,
- njohuritë e kërkuara (sipas rregullave ligjore) dhe informacionet e tjera me vendet krahasuese të punës.

Efikasiteti i një vendi pune varet nga organizimi i tij. Postet e punës së punëtorëve mund të klasifikohen sipas kriteve të ndryshme:

Sipas funksionit që kryejnë:

- menaxherë,
- specialistë,
- punonjës,
- mirëmbajtjes,
- punonjës sigurie;

Sipas ndarjes së punës:

- individuale dhe
- kolektive;

Sipas shkallës së mekanizimit të mjeteve:

- manuale,
- manuale të mekanizuar,
- makinë-manuale,
- makinë e mekanizuar,
- e automatizuar,
- etj.

Sipas sezonit të punës:

- punëtorë të përhershëm dhe
- sezonal

Sipas numrit të të punësuarve që punojnë në një vend pune:

- individ ose
- grupe;

Sipas kufizimit të hapësirës punuese:

- vende të stacionuara dhe
- vende lëvizëse të punës;

Sipas shkallës së mekanizimit të punës:

- vende pune me punë të mekanizuar,
- vende pune me punë pjesërisht të mekanizuar dhe
- vende pune me krah.

Për të përshkruar procesin e punës duhet të mbështetemi tek organigrama e organizimit të punës të ndërmarrjes bujqësore. Në ndërmarrje të mëdha bujqësore dhe të organizuara puna menaxhohet nga tre nivele.

Niveli i parë i menaxhimit - është niveli më i lartë i hierarkisë menaxheriale. Menaxherët e këtij niveli kanë përgjegjësi për hartimin e planeve të karakterit afatgjatë, për marrjen e vendimeve apo formulimin e politikave që ndikojnë mbi gjithë ndërmarrjen.

Niveli i dytë - përfshinë të gjithë ata menaxherë të cilët qëndrojnë nën nivelin e lartë ku përcaktohen të gjitha politikat e ndërmarrjes, por që janë përgjegjës për realizimin e planeve të përgjithshme të projektuara nga menaxheri.

Niveli i tretë - menaxherët e këtij niveli quhen ndryshe edhe “menaxherët e nivelit të parë”, pasi përbëjnë bazën e piramidës së menaxhimit. Këta persona menaxhojnë punën e punëtorëve të cilët kryejnë punët bazë të biznesit. Menaxherët e nivelit të tretë janë specialistë që merren me organizimin e punës në ndërmarrjen bujqësore duke ushtruar këto përgjegjësi kryesore.

- përgjegjësinë për cilësinë dhe sasinë e prodhimit/shërbimit;
- caktimin e vendeve të punës dhe të detyrave të punonjësve të ndryshëm;
- udhëzimin dhe instruktimin e punëtorëve për aktivitetet e përditshme të punës;
- përgjegjësinë e mbajtjes së lidhjeve të mira në sipërmarrje (për atmosferën, frymën bashkëpunuese etj.);
- komunikimin me punëtorët për problemet, ankesat, propozimet e tyre, si dhe adresimin e tyre të menaxhimit i nivelit më të lartë dhe e anasjellta;

- ndihmën për të zgjidhur ankesat e punëtorëve;
- mbikëqyrjen dhe drejtimin e vartësve;
- përgjegjësinë për sigurimin e trajnimit të punëtorëve;
- sigurimin e materialeve, pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për kryerjen e veprimtarive në ndërmarrjen bujqësore;
- përgatitjen e raporteve periodike për punën e punëtorëve;
- sigurimin e disiplinës në ndërmarrjen bujqësore;
- motivimin e punëtorëve.

Tema 7. Ndarja e detyrave dhe organizimi i vogël i punës në fermat bujqësore

Për ndërmarrjet e mëdha bujqësore me një qarkullim të lartë të produkteve një rol të veçantë luan sistemi i organizimit të punës së punonjësve të saj. Organizimi i mirë i punës në ndërmarrje është çelësi për ekzistencën e saj të suksesshme dhe të qëndrueshme. Lideri modern e ka më se të qartë se pasuria e tij më e rëndësishme janë punëtorët që punojnë aty. Organizimi i punës në ndërmarrje përfshin gjëra të tilla si:

- vendosjen e stafit të personelit,
- trajnimin e tyre dhe ri-trajnimit,
- normalizimin e ditës së punës,
- sistemin e shpërblimeve dhe dënimeve,
- sistemin e pagesave dhe listën e pagave, si dhe
- ruajtjen e konkurrencës së shëndoshë, si një nxitje për rritjen profesionale të punonjësve.

Organizimi i vogël i punës, si funksion menaxhues, është bashkimi dhe koordinimi i burimeve njerëzore, financiare, fizike, informative etj., të nevojshme për arritjen e objektivave të një biznesi. Kuptimi bashkëkohor i organizimit i sheh njerëzit ndoshta si burimet më të çmuara të biznesit. Vetëm ata mund t'i japin biznesit ndryshueshmërinë dhe përshtatjen ndaj nevojave të konsumatorëve apo konkurrencës së rreptë. Gjatë organizimit të vogël të punës një sipërmarrës duhet t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme: Çfarë duhet bërë? Kush do ta bëjë? Si - në cilën mënyrë? Kur duhet bërë diçka? Gjithë veprimtaria, në përgjigje të pyetjeve të cituara më lart, kryhet në një mjedis të jashtëm dhe të brendshëm të caktuar. Ky mjedis përcakton çfarë duhet bërë për suksesin e biznesit. Mjedisi i jashtëm përbëhet nga dy pjesë:

- ***mjedisi i konkurrencës***, që përfshin bizneset e tjera me të cilat ai ndërvepron. Ky mjedis shfaqet me rivalitetin e konkurrentëve, rreziqet nga bizneset e reja apo zëvendësueset, si dhe me fuqinë e furnitorëve apo të konsumatorëve. Për të mbijetuar dhe triumfuar, një biznes, duhet të krijojë epërsi ndaj konkurrentëve, duke u orientuar nga cilësia, kostot konkurruese dhe risitë.
- ***Makromjedisi***, i cili ka natyrë politiko-ligjore, ekonomike, shoqërore, demografike dhe teknologjike.

Organizimi i punës në mjedisin e brendshëm ka të bëjë me ndarjen e detyrave brenda një ndërmarrje/ biznesi bujqësor. Struktura e organizimit funksionon si mjet menaxhimi, kur kemi të bëjmë me bashkërenditjen burimeve të ndërmarrjes dhe funksioneve të ndryshme të ndërmarrjes si: blerja, prodhimi, magazinimi, shitja, marketingu dhe administrimi i çështjeve ekonomike dhe personelit. Në firmat private apo biznes familjar, me vetëm një pronar, shpesh është një person që bën punën organizative. Rritja e ndërmarrjes dhe numrit të punëtorëve paraqet nevojën e riorganizimit. Përzgjedhja e mënyrës së organizimit përcakton:

- Shpërndarjen e punëve dhe përgjegjësi.

- Shpërndarjen e vendimarrjes dhe kompetencat.
- Drejtimin dhe bashkërenditjen e veprimtarisë, pra, njeriu i përshtatshëm në vendin e duhur.

Nëse konsiderohet i nevojshëm ndryshimi i organizimit mbahen në konsideratë pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë është vendimtare për zhvillimin historik të njësisë së ndërmarrjes?
- Cilat janë detyrat e njësisë së ndërmarrjes në këndvështrim afatshkurtër dhe afatgjatë?
- A është i përshtatshëm organizimi i tanishëm për të arritur këto qëllime?
- Si do të realizohet ndryshimi?
- Çfarë roli do të luajë njësi e ndërmarrjes?
- Në çfarë mënyre kjo njësi është e varur nga njësitë e tjera?
- Si do të ndahen detyrat e punës?

Organizimi i punës në një ndërmarrje bujqësore mund të jetë:

- ***i përgjithshëm dhe brenda të gjitha njësive organizative***, si psh: njësi e prodhimit, njësi e blerjes, njësi e shitjes, njësi ekonomiko-financiare etj.
- ***modern***, sipas proceseve paralele, përgjegjësi të rezultatit, punës në grup, nivelit arsimor të personelit etj.
- ***Klasik***, që synon shpërndarje në shkallë të lartë të shkathësive të punës dhe specializimit të detyrave, përcakton metodën më të mirë për të kryer çdo detyrë, aplikon pagën individuale sipas sasisë së prodhimit apo të punës së kryer.
- ***i orientuar nga cilësia***, ku kërkesat e blerësve janë pikënisje dhe synim, bëhen gjërat e duhura nga fillimi – filozofia e zero gabimeve, punë në grup, zhvillimi i njohurive dhe aftësive bëhet në mënyrë të qëndrueshme.
- ***fleksibël***, ku bashkëpunuesit kanë aftësi të shumta dhe kryejnë punë të ndryshme, i bëjnë punëtorët të identifikohen me ndërmarrjen të tërësi, jo vetëm me njësi të caktuara, Personeli nuk përjeton monotoni, merr pjesë në punën zhvillimore dhe mundësohet shfrytëzimi i “rezervës së diturisë”. Organizimi i punës duhet të karakterizohet nga sinjeriteti dhe komunikimi.
- ***duke mësuar***, ku bashkëpunuesit marrin përgjegjësinë për ndryshime të përhershme të metodave të rritjes së cilësisë dhe prodhueshmërisë. Kështu ata krijojnë një model organizimi të punës duke mësuar.

Tema 8. Marrëdhëniet juridike të të punësuarve në fermat bujqësore

Marrëdhëniet juridike të të punësuarëve në fushën e bujqësisë, si në të gjithë fushat e tjera të ekonomisë, mbështeten ligjërisht në dokumentet e poshtëshënuara:

- Kushtetuta e Shqipërisë.
- Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- Kodi i punës dhe aktet e tij ligjore.
- Kontrata kolektive e punës.
- Kontrata individuale e punës.
- Rregullorja e brendshme.
- Zakonet lokale dhe profesionale.

Legjislacioni i punës rregullon marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit në fushën e bujqësisë. Secili ka të drejtën për të fituar mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, të cilën personi e zgjedh dhe e pranon vetë. Kjo do të thotë se askush nuk mund t'i nënshtrohet punës së detyruar. Në

këtë kuadër afirmohet liria për të zgjedhur profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit profesional. Natyrisht që, e drejta për punë, ka nevojë për ndërhyrjen e shtetit, me qëllim që të sigurohen mundësitë dhe kushtet e përshtatshme për punësim. Shteti është përgjegjës për të respektuar parimet e përgjithshme dhe rregullat kushtetuese në fushën e punësimit (pra shteti përcakton “rregullat e lojës”). P.sh., ai zotohet a përfshihet tërësisht dhe mban përgjegjësi për zbatimin e parimit të barazisë në marrëdhëniet e punës. Gjithashtu, ai respekton të gjitha të drejtat kushtetuese që lidhen ngushtë me punonjësit (të punësuarit). P.sh., sipas Kushtetutës, shteti e ka detyrë të tij të sigurojë mbrojtjen shoqërore të punës (neni 49/2), lirinë sindikale (neni 50), të drejtën për grevë të punonjësve (neni 51), si dhe të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose në rastet e paaftësisë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj (neni 52). Legjislacioni që rregullon gamën e gjerë të marrëdhënieve dhe të problemeve të lidhura me punën dhe punësimin është më i gjerë se kuadri dispozitiv ligjor i Kodit të Punës.

Janë pjesë e legjislacionit të Punës:

- Ligji për Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Statuti i Inspektoriatit të Punës;
- Ligji për Nxitjen e Punësimit dhe
- një mori e madhe aktesh nënligjore, si vendime dhe udhëzime që rregullojnë aspektet e tjera të lidhura me punën.

Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit që rregullon marrëdhëniet e punës, si dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në këtë kontratë punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një kohëzgjatje të caktuar ose të pacaktuar kohe, kjo në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Kontrata individuale e punës është gjithmonë një titull detyrues dhe i përket kategorisë së kontratave me shërbime të ndërsjella, që do të thotë se detyrimet dhe të drejtat e palëve janë të dyanshme. Kushtet e kontratës individuale të punës dallohen në kushte objektive dhe ato subjektive. Kushtet subjektive janë subjektet e kësaj kontrate të cilat për të lidhur një kontratë të vlefshme, duhet të kenë zotësi për të vepruar. Me kushte objektive të kontratës së punës kuptohen:

a) marrëveshja midis palëve – kontrata e punës quhet e lidhur në çastin në të cilat palët arrijnë në një marrëveshje ndërmjet tyre, dmth ai që ka bërë propozimin merr dhe pëlqimin e palës tjetër.

b) Shkaku i kontratës është qëllimi për të cilën bëhet shprehja e vullnetit në kontratë dhe ka të bëjë me dyanësinë shërbim-shpërblim. Ky shkak duhet të jetë gjithmonë i ligjshëm.

c) Objekti – është shërbimi personal i punës, dmth ato energji pune ose intelektuale që punëmarresi është i detyruar të përmbushë kundrejt shpërblimit. Objekti duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm i mundshëm, i ligjshëm, i përcaktueshëm.

d) Kontrata mund të përfundohet ose të ndryshohet me gojë ose me shkrim. Me shkrim duhet të përmbajë identitetin e palëve/ vendin e punës/ përshkrimin e përgjithshëm të punës/ datën e fillimit të punës/ kohëzgjatjen kur palët lidhin kontratë me afate të caktuara/ kohëzgjatjen e pushimeve të paguara/ afatin e njoftimit të zgjidhjes së kontratës/ elementet përbërese të palës dhe datën e dhënies së saj/ kohën normale javore të punës/ sipas rastit dhe marrëveshje kolektive të punës të zbatueshme.

e) Llojet e kontratave të punës - kontrata pune për një kohëzgjatje të pacaktuar; kontrata pune për një kohëzgjatje të caktuar; kontrata pune që lidhen për kohëzgjatjen e nevojshme për kryerjen e një pune të caktuar; kontrata pune me provë; kontrata të punës me kohë të pjesshme.

Me kontratën e punës me kohë të pjesshme, punëmarrësi pranon të punojë me orë, gjysmë dite pune ose ditë të plotë pune, për një kohëzgjatje normale javore ose mujore më të vogël se ajo e punëmarrësve që punojnë me kohë të plotë në të njëjtat kushte.

Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos:

- a. identitetin e palëve;
- b. vendin e punës;

- c. përshkrimin e përgjithshëm të punës;
- d. datën e fillimit të punës;
- e. kohëzgjatjen kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar;
- f. kohëzgjatjen e pushimeve të paguara;
- g. afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës;
- h. elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj;
- i. kohën normale javore të punës;
- j. kontrata e punës duhet të përmbajë dhe kontratën kolektive në fuqi.

Kur kontrata e punës lidhet me gojë, punëdhënësi është i detyruar që, brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, të hartojë me shkrim dokumentin përkatës, të nënshkruar prej tij dhe punëmarrësit, ku të përfshihen sidomos elementet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Mos-hartimi i këtij dokumenti me shkrim nuk çënon vlefshmërinë e kontratës, por sjell vetëm përgjegjësinë e punëdhënësit, sipas nenit 202 pika 2 të këtij Kodi.

Tema 9. Parimet, burimet, sistemet dhe subjektet e së drejtës

Fjala "e drejtë" përdoret në dy kuptime: **1.** në kuptimin e së drejtës objektive, d.m.th. të një tërësie rregullash sjelljeje, normash juridike që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore; **2.** në kuptimin e së drejtës subjektive, të një tagri që e gëzon subjekti, shtetasi. Teoricienët e së drejtës të periudhës bashkëkohore **e cilësojnë të drejtën si një tërësi ose grumbull normash juridike.** Ky është koncept *normativ*, sepse e vë theksin tek e drejta si tërësi normash ose rregullash sjelljeje. Kjo rregull sjelljeje nuk del shumë në dukje në disa raste, por pavarësisht nga kjo, ajo është në çdo normë. Si rrjedhojë, *të gjitha normat juridike janë rregulla sjelljeje, por jo çdo rregull sjelljeje është normë juridike.* P.sh., nuk janë norma juridike rregullat fetare, ato morale dhe ato të ngjashme me to.

Norma juridike janë vetëm ato rregulla sjelljeje që kanë marrë fuqi detyruese nga shteti. Këto norma shteti ose i vendos vetë ose i sanksionon duke i bërë të detyrueshme zakonet e mëparshme që zbatoheshin sipas traditave. ***E drejta është një tërësi normash që rregullojnë jetën shoqërore në një vend të caktuar dhe që karakterizohen nga qenia e sanksioneve që garantojnë zbatimin e tyre.*** Zbatim i së drejtës do të thotë të kryesh veprimet që të detyron ligji ose të mos kryesh veprimet që ligji i ndalon. Në jurisprudencën klasike ndarja kryesore e së drejtës është ndarja e saj në *të drejtë publike* dhe *private*. Në të drejtën publike bëjnë pjesë degët e së drejtës që sanksionojnë marrëdhëniet ndërmjet organeve të shtetit dhe të shtetasve, si dhe marrëdhëniet e organeve shtetërore ndërmjet tyre. Në të drejtën private bëjnë pjesë degët e së drejtës që rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella, kryesisht ekonomike, ndërmjet shtetasve. Shkenca juridike e mbështet ndarjen e së drejtës në publike dhe në private sipas interesave të shtetit ose të personit privat, që mbrohet prej normave të së drejtës.

E drejta publike mund të përkufizohet si *tërësia e normave juridike që kanë të bëjnë me pozitën e shtetit dhe të qeveritarëve, si edhe e normave që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet qeveritarëve dhe shtetasve.* E drejta publike ndahet në disa degë kryesore:

E drejta kushtetuese përkufizohet si tërësia e normave që përcaktojnë parimet themelore të organizimit politik të shoqërisë dhe të shtetit. Në sistemin juridik shqiptar këto norma janë përfshirë në një dokument themelor, në Kushtetutë. ***E drejta administrative*** përbëhet nga normat specifike që rregullojnë veprimtarinë administrative. ***E drejta financiare*** tërësia e normave juridike që rregullojnë veprimtarinë financiare të shtetit dhe të enteve të tjera publike dhe që kanë të bëjnë njëkohësisht edhe me administrimin e fondeve publike.

Në kuadrin e financave publike ekziston: E drejta fiskale, e drejta penale, e drejta procedurale penale, e drejta e punës, e drejta civile. E drejta civile nuk vepron e shkëputur nga degët e tjera të së drejtës. Ajo lidhet me ***të drejtën tregtare*** dhe me ***të drejtën familjare.***

E drejta tregtare rregullon marrëdhëniet juridike civile në tregti, pozitën juridike të tregtarëve dhe të shoqërive tregtare, procedurën e falimentimit dhe marrëdhëniet e tjera pasurore.

E drejta familjare rregullon marrëdhëniet personale të bashkëshortëve dhe ato ndërmjet pjesëtarëve të familjes.

E drejta civile lidhet edhe me degë të tjera të së drejtës, siç janë e drejta administrative ose e drejta e punës. Në të drejtën civile metoda e rregullimit të marrëdhënieve pasurore karakterizohet nga barazia e palëve.

E drejta dhe ekonomia. Si në shtetin, ashtu dhe në të drejtën gjejnë shprehjen e tyre marrëdhëniet ekonomike, struktura ekonomike e shoqërisë. E drejta ruan dhe sanksionon marrëdhëniet ekonomike që ekzistojnë në shoqëri.

Tema 10. Kuptimi i së drejtës agrare, raporti i saj me degët e tjera të së drejtës

E drejta agrare është tërësia e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore që lindin në lidhje me tokën dhe objektet kryesore që janë të lidhur në mënyrë natyrore me të, siç janë pyjet, kullotat, livadhet dhe ujrat; si edhe veprimtarinë prodhuese të tokës dhe marrëdhëniet në familjen bujqësore.

Objektet e së drejtës agrare janë:

- Ka marrëdhënie shoqërore dhe kërkon rregullimin juridik të veçantë me tokën, pyjet, livadhet, ujrat dhe familjen bujqësore.
- Ka pasur dhe ka një legjislacion të veçantë që rregullon marrëdhëniet shoqërore të tokës si p.sh: ligji për tokën, për policin pyjore etj.
- Ka metodën e saj të rregullimit juridik për të arritur rregullimin juridik të marrëdhënieve shoqërore agrare, që rregullojnë shtetin me familjen bujqësore.
- Shteti shqiptar është rregullator i marrëdhënieve të ndryshme me marrëdhëniet agrare.

E drejta agrare studion në tërësi normat që e përbëjnë të drejtën agrare. Burimet e së drejtës agrare janë Kushtetuta, Ligjet, Aktet e pushtetit ekzekutiv. Toka shqiptare e viteve 1990. ishte pronë e shtetit dhe mbrojtja e saj bëhej nga organet shtetërore dhe hapi më i rëndësishëm ishte miratimi nga parlamenti pluralist i ligjit “për dispozitat kryesore kushtetuese” ku në bazë të ligjit kushtetues parlamenti miratoi ligjin nr. 7051 dt.19.07.1991 për tokën. Ky ligj e ndau tokën bujqësore në tre grupe:

- në tokë bujqësore si bimësi pemishte, vreshta, ullinj.
- në toka të zëna si pyje, kullota dhe livadhe
- në toka jo bujqësore si ndërtime, oborre, rrugë, hekurudha etj.

Organet shtetërore për ndarjen e tokës janë: Komisioni qeveritar i tokës pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Kriteret për ndarjen e tokës bujqësore u përcaktuan me vendim të Këshillit të ministrave me nr.225 dt.2.8.1991 sipas këtij vendimi toka ndahej sipas gjendjes aktuale të sipërfaqes që kishte kooperativa bujqësore si dhe nr. e frymëve. Toka ndahej në çdo familje sipas nr të frymëve, antarë të kooperativës llogariteshin të gjithë si: nxënës , student , ushtarak , ndërsa familjet që banonin në fshat merrnin rreth ½ e tokës ndërsa për anatarët e kooperativës jepej 4 dynym, në një vendim të Këshillit të ministrave, u përcaktuan kriteret për ndarjen e tokës nën dhe mbi ujë dhe cilësia e tokës. Sipas ligjit nr. 7051 për tokën, toka ju jepej personave fizik dhe juridik në pronësi ose në përdorim, dhe nuk e shfrytëzonin atë për qëllime bujqësore apo blektorale, pasi u hiqej e drejta e përdorimit dhe këto toka u konsideruan të pa ndara. Me këtë ligj mbi administrimin e tokave të refuzuara të 1995 , u sanksionua se toka e refuzuar për tu marr në dorëzim, pronësi, përdorim, nga përfituesi u konsiderua tokë bujqësore

shtetërore, dhe kalonin në administrimin e Drejtorisë së përgjithshme të pyjeve dhe kullotave. Familja bujqësore sipas legjislacionit në fuqi. Ligji për tokën dhe aktet që kanë dalë në zbatim të tij përcaktojnë qartë njohjen e familjes bujqësore. Ligjvënësi nuk njih si subjekt individ të veçantë, por ai njih si subjekt kolektiv familjen bujqësore, familja bujqësore rregullohet sipas kodit civil. Zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme refuzon regjistrimin e tokës në rastet kur:

- nuk është zbatuar para-blerja që cakton ligji.
- madhësia që shitet mbetet më e vogël se parcela.
- në blerje mund të përfitojnë persona që nuk e gëzojnë këtë të drejtë.
- ka shkelje nga kërkesat e ligjit.

Tema 11: Prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë

Në nenin 11, pika 1 të Kushtetutës sonë thuhet: “Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike”. Nocioni i pronësisë është shprehje e aspektit ekonomik, për arsye se thelbi i saj është vlerësimi i të mirave materiale nga person i caktuar. Të drejtat e njeriut janë parime themelore pa të cilat njerëzit s’mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet. Respektimi i tyre bën të mundur progresin e plotë të individit dhe të shoqërisë. Pronësia është një institucion juridik me rëndësi ekonomike, shoqërore dhe politike. Ajo është marrëdhënie shoqërore ndërmjet personave me karakter ekonomik, si dhe marrëdhënie juridike civile pasurore. Të drejtat e pronësisë sanksionohen nga normat e së drejtës civile. Rregullimi me këto norma i të drejtave të pronësisë do të thotë vendosje e një regjimi të caktuar juridik për pasurinë, për vëllimin dhe për përmbajtjen e tagrave të pronësisë, për mënyrat e ushtrimit të tyre, për mënyrat dhe shkaqet e fitimit dhe të humbjes së pronësisë. E drejta subjektive e pronarit mbrohet dhe garantohet edhe nga Kushtetuta, e cila afirmon mbrojtjen e njëlojtë nga ligji si për pronën private, dhe për atë publike. Kushtetuta përcakton vetë mënyrat e fitimit të pronësisë private, duke sanksionuar shprehimisht ato më klasike, si: *me dhurim, me trashëgimi dhe me blerje*. Duhet bërë dallim midis koncepteve *pasuri* dhe *pronësi*:

Pasuria është tërësia e të drejtave subjektive me karakter pasuror që i takojnë një personi. Pjesë përbërëse të pasurisë janë të drejtat reale dhe të drejtat personale.

Pronësia është një e drejtë pushteti që i njihet pronarit dhe që është e lidhur gjithmonë me një send të caktuar. Pronësia është e drejta për të poseduar, gëzuar dhe disponuar sendin brenda caqeve të caktuar në ligj.

Posedimi është një gjendje fakti, është pushtet efektiv (faktik) i mbrojtur nga normat e së drejtës. Pronari mund të ngrejë padi kundër kujtdo që e cenon posedimin e tij, që do të thotë se të gjithë të tjerët janë të detyruar ligjërisht që të përmbahen nga cenimi i posedimit të pronarit.

Gëzimi (usus) është një nga tagrat e pronarit, sipas së cilave pronari ka të drejtën e përdorimit të sendit dhe të vjeljes së fryteve të tij.

Disponimi përbën kalimin e sendeve nga një gjendje në një tjetër me vullnetin e pronarit ose të personit të autorizuar prej tij ose nga vetë ligji. Si rrjedhojë, sendet dalin tërësisht ose pjesërisht nga posedimi dhe gëzimi i pronarit, ose mund të pushojnë së qenuri

Kriteri themelor i dallimit të llojeve të pronësisë është ai në bazë të subjektit pronar: kur subjekt i pronësisë është shteti, pasuria që është në zotërim të tij quhet *pronë publike* ose *pronë shtetërore*; kur subjekti i pronësisë është individ ose disa individë, pasuria në zotërim të tyre quhet *pronë private*. Objekt i të drejtës së pronësisë janë sendet pa dallim, pra të luajtshme apo të paluajtshme. Në ditët e sotme pronë do të quhet:

Pasuria e paluajtshme është toka dhe çdo gjë tjetër që është lidhur në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me të.

Pasuria e luajtshme do të quhet çdo send që nuk përbën pasuri të paluajtshme.

Të drejtat in rem janë të drejta me karakter pasuror që rrjedhin nga marrëdhëniet kontraktore e vendosen nga vullneti i lirë i palëve.

Të drejtat personale janë të drejta që lidhen me cilësitë personale të personit mbajtës të tyre, nuk mund të shiten, nuk mund të dhurohen, nuk mund të lihen në trashëgimi.

Pronësia intelektuale përfshin të gjitha marrëdhëniet pasurore dhe jopasurore që lindin nga e drejta e autorit; patentat; markat e prodhimit dhe markat tregtare.

Nocioni "**e drejtë e autorit**" përdoret në dy kuptime *objektiv* dhe *subjektiv*. Me të drejtë të autorit në kuptimin objektiv kuptohet tërësia e normave juridike të nxjerra nga shteti, me anë të së cilave rregullohen të gjitha marrëdhëniet juridike që lindin në fushën e krijimtarisë letrare, artistike dhe intelektuale. Me të drejtë të autorit në kuptimin subjektiv kuptohet tërësia e të drejtave personale të autorit, përmbajtja e së cilës përbëhet nga *të drejtat morale* dhe nga *të drejtat ekonomike*.

Në të *drejtat ekonomike* futen riprodhimi i veprës së tij; importimi i veprës me qëllim shpërndarjeje për publikun në formën e shitjes a të marrjes me qira; përkthimi i veprës në gjuhë të tjera; shfaqja e veprës para një publiku të caktuar etj.

Patentat nuk janë quajtur si pasuri, por si të drejta civile.

Markat e prodhimit dhe markat tregtare janë shenjat dalluese të produktit, të cilat shërbejnë për individualizimin e tyre në lidhje me produkte të tjera të ngjashme, për shkak të cilësive të tyre të veçanta.

Të drejtat që lidhen me ushtrimin e profesionit ka një natyrë autonome dhe të drejta të tilla tregojnë mënyrën se si ka evoluar ai.

Shpresat legjitime dhe pretendimet potenciale kanë të bëjnë me të drejtat që u njihen personave të ndryshëm në lidhje me të drejtën e tyre të pronës, të njohura në bazë ligjit ose të akteve të organeve shtetërore kompetente.

Me fitim të pronësisë kuptohet veçanërisht fakti juridik me vërtetimin e të cilit një personi fizik a juridik, apo shtetit si tërësi, i lind e drejta e pronësisë mbi një send (pasuri) të caktuar, si p.sh.: kontrata e shitje ose e dhurimit të një sendi, akti administrativ i shpronësimit të një pasurie etj.

Të gjitha mënyrat e fitimit të pronësisë ndahen në dy grupe kryesore: *Mënyra të parme të fitimit të pronësisë* janë ato kur pronësia mbi një send të caktuar fitohet për herë të parë ose pavarësisht nga e drejta e pronarit të mëparshëm mbi një pasuri. *Mënyra të prejardhura të fitimit të pronësisë* janë ato nëpërmjet të cilave pronësia fitohet nga një subjekt i caktuar në bazë të së drejtës së pronarit të mëparshëm të sendit. **Për sendet e përcaktuara individualisht, pronësia kalon në çastin e lidhjes së kontratës, kurse për sendet e përcaktuara në gjini, pronësia fitohet me dorëzimin e tyre. Pronësia humbet me vullnetin e pronarit, kur:**

- me kontratë ose me veprim juridik të njëanshëm, ai ia kalon pronësinë një tjetri;
- e zhduk sendin për shkak të amortizimit;
- heq dorë nga pronësia, duke e braktisur atë;
- heq dorë nga pronësia mbi pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme në dobi të një tjetri.

Humbja e pronësisë pa vullnetin e pronarit mund të ndodhë:

- kur me Vendim të Këshillit të Ministrave, por të bazuar në ligj, pronari shpronësohet për interesa publike;
- kur me vendim të gjykatës vërtetohet se pronësinë e ka fituar një tjetër;
- kur pasuria ka qenë objekt i një veprimi juridik të kundërligjshëm.

Tema 12. Bashkëpronësia dhe shpronësimi

Ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave. Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve caktohen në përpjestim me pjesët përkatëse. **Çdo bashkëpronar ka këto të drejta:**

- të përfitojë nga të ardhurat e sendit të përbashkët në përpjestim me pjesën e tij;
- të përdorë sendin e përbashkët sipas qëllimit të përcaktuar dhe në mënyrë që të mos i pengojë bashkëpronarët e tjerë të përdorin atë sipas të drejtave të tyre;
- të tjetërsojë ose disponojë në çdo mënyrë tjetër pjesën e tij në sendin e përbashkët, por kur ky është një send i paluajtshëm, mund ta shesë pjesën e tij vetëm duke respektuar të drejtën e parablerjes që kanë bashkëpronarët e tjerë sipas nenit 204 të këtij Kodi;
- të kërkojë pjestimin e sendit të përbashkët edhe sikur të ketë një marrëveshje të kundërt, përveç kur ky pjestim dëmton së tepërmi qëllimin përkatës ose është ndaluar me ligj;
- të kërkojë kthimin jo vetëm të pjesës së tij, por të gjithë sendit të përbashkët, me kusht që ky t’u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve.

Bashkëpronësia e detyrueshme. Objektet e përbashkëta të ndërtesës nuk lejohet të ndahen, përveç kur ndarja e ndonjërit prej tyre mund të kryhet pa ia vështirësuar përdorimin e tij asnjërit nga bashkëpronarët.

Çdo bashkëpronar ka këto detyrime:

- Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve, në përpjesëtim me vleftën e pjesës së secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.
- Të paguajë shpenzimet për ruajtjen dhe gëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës, për kryerje shërbimesh në dobi të përbashkët dhe për ndryshime të vendosura nga shumica e bashkëpronarëve në përpjesëtim me vleftën e pjesës së secilit, përveç kur ka marrëveshje tjetër.
- Të mos kryejë në katin ose njësinë e ndarjes së katit, që është në pronësi të veçantë të tij, ndërtime të cilat mund t’u shkaktojnë dëme objekteve të përbashkëta të ndërtesës.
- Të ndreqë dëmin ose të paguajë shpenzimet për zëvendësimin e tij, që ai vetë ose një anëtar i familjes së tij i ka shkaktuar me faj, cilitdo objekti të përbashkët.
- Të mos kryejë, pa lejen paraprake të asamblesë, në katin ose në njësinë e ndarë të katit që është në pronë të tij, shtesa ose ndryshime të cilat mund të çenojnë pamjen e jashtme të ndërtesës.

Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore

Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore, u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore. Familja bujqësore përbëhet nga personat që lidhen ndërmjet tyre për shkak gjinie, martese, birësimi ose pranimit si anëtar i saj. Familja bujqësore përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj. Në pasurinë e familjes bujqësore nuk përfshihen sendet e përdorimit thjesht vetjak të anëtarëve, si dhe sendet që anëtari ka fituar me të ardhurat e tij vetjake, me dhurim ose me trashëgim. Anëtari i familjes bujqësore nuk mund të tjetërsojë asnjë pjesë të pasurisë së familjes bujqësore, gjersa nuk është bërë pjesëtimi i saj. Çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore.

Shpronësimi.

Një rëndësi të veçantë në studimin e pronësisë merr edhe shpronësimi. E drejta për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të brendshëm për interes publik pasuritë e personave fizikë e juridikë privatë, i përket shtetit. Objekt i shpronësimit mund të jenë si sendet e paluajtshme, dhe ato të luajtshme e që janë në pronësi private të personave fizikë a juridikë. Këto masa të kufizimit të pronësisë mund të zbatohen vetëm për interesa publike dhe vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë (kompensimi), siç e parashikohet edhe në ligj.

Disa nga rastet për të cilat mund të vendoset shpronësimi janë:

- Për realizimin e detyrimeve të shtetit që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare.
- Për kryerjen e investimeve në transport, energji, telekomunikacion, veprat ujore etj.
- Për mbrojtjen e monumenteve dhe të objekteve të paluajtshme me karakter arkeologjik, historik, kulturor dhe shkencor.
- Për rastet kur, për shkaqe objektive, objektet e luajtshme dhe të paluajtshme krijojnë rrezik të përhershëm për sigurinë e shëndetit publik.

Tema 13. Uzurfrukti dhe servituti

Uzurfrukti është e drejta e një personi për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë e ta mirëmbajë atë. Uzurfrukti krijohet me ligj ose me një veprim juridik. Ai mund të fitohet edhe me parashkrimin fitues. Ai mund të jetë me ose pa afat, por në çdo rast nuk mund të kalojë jetën e uzufruktarit. Kur e drejta e uzufruktit gëzohet nga një person juridik, nuk mund të zgjasë më shumë se tridhjetë vjet. Uzurfrukti që krijohet me veprim juridik duhet të bëhet me akt noterial, ndërsa kur fitohet me testament veprohet sipas dispozitave përkatëse. Uzurfrukti mbi një send të paluajtshëm duhet të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Uzurfrukti mund të jetë në favor të më shumë se një personi. Kur e drejta e njërit prej tyre shuhet, ajo u kalon uzufruktarëve që mbeten, në përpjesëtim me pjesët. Në këtë mënyrë veprohet deri në shuarjen e së drejtës së uzufruktarit të fundit që mbetet.

Të drejtat që rrjedhin nga uzurfrukti

Uzurfruktari gëzon sendin e vënë në uzurfrukt, por nuk mund të ndryshojë destinimin ekonomik që ka patur ai në fillim të uzurfruktit, pa pëlqimin e pronarit ose pa autorizimin e gjykatës së rrethit, kur pronari dhe uzurfruktari nuk merren vesh. Gjatë vazhdimit të uzurfruktit ose në mbarimin e tij, uzurfruktari mund të heqë shtesat që i janë bërë sendit, në bazë të ligjit që mund të shkëputen pa e dëmtuar atë, duke e kthyer në gjendjen e tij fillestare, përveç kur parashikohet ndryshe në aktin e krijimit. Uzurfruktari në mbarim të uzufruktit nuk ka të drejtë të kërkojë shpërblimin për përmirësimet e bëra në send gjatë përdorimit edhe sikur të jetë shtuar vlefata e tij, përveç kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të uzurfruktit. Shtesa e vleftës mund të kompensohet me dëmet që mund t'i jenë shkaktuar sendit pa fajin e uzufruktarit. Kur nuk ka vend për kompensim, uzurfruktari mund të heqë shtesat e bëra, pa u dëmtuar sendi, përveç kur pronari pranon të paguajë vleftën e tyre, si të ishin të ndara nga sendi. Uzurfruktarit i takojnë frutat natyrore dhe ato civile që prodhon sendi gjatë kohëvazhdimit të uzurfruktit. Frutat natyrore që nuk janë ndarë nga sendi në kohën e fillimit të uzurfruktit, i përkasin uzufruktarit dhe anasjelltas, kur ato nuk janë ndarë nga sendi kur mbaron uzurfrukti, i përkasin pronarit. Uzurfruktari mund t'ia kalojë një tjetri këtë të drejtë për një kohë ose për gjithë kohën e qënies së saj, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe. Kalimi duhet t'i njoftohet me shkrim pronarit, përndryshe uzurfruktari i mëparshëm dhe personi që ka fituar një të drejtë të tillë përgjigjen solidarisht ndaj pronarit. Uzurfruktari ka të drejtë të tjetërsojë sendet objekt uzurfrukti në masën që ato destinohen të tjetërsohen dhe në përputhje me natyrën e tyre. Në raste të tjera uzurfruktari nuk mund të tjetërsojë sendet në uzurfrukt pa pëlqimin e pronarit ose pa autorizimin e gjykatës së rrethit, përveç kur në aktin e krijimit është parashikuar ndryshe. Autorizimi nuk duhet të jepet kur preken interesat e pronarit, uzufruktarit ose të personave të tretë. Kur sendet në uzurfrukt janë tjetërsuar ose janë zëvendësuar me sende të tjera, këto i përkasin pronarit dhe njëkohësisht janë objekt i uzurfruktit.

Uzurfruktari ka të drejtë të japë me qira sendet në uzurfrukt, përveçse kur është parashikuar ndryshe në aktin e krijimit të tij. Kur pushon uzurfrukti, qiradhëniet për një afat mbi pesë vjet, kanë vlerë

vetëm për pesë vjet nga dita që ka filluar qiradhënia. Uzurfruktari gëzon të drejtat e servituteve të lidhura me pronën mbi të cilën ka uzurfruktin dhe të drejtat e tjera reale që do t'i gëzonte vetë pronari, përveç kufizimeve të parashikuara në aktin e krijimit apo në ligj. ***Uzurfrukti mbaron:***

- me vdekjen e uzurfruktarit ose me mbarimin e personit juridik uzurfruktar;
- me mbarimin e afatit të caktuar në aktin e krijimit;
- me bashkimin e cilësive të pronarit e të uzurfruktarit në një person të vetëm;
- me shkatërrimin tërësisht ose humbjen e sendit të dhënë në uzurfrukt;
- me mospërdorimin e uzurfruktit radhazi për njëzetë vjet.

Uzurfrukti mund të pushojë kur uzurfruktari shpërdoron të drejtat ose nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga uzurfrukti. Megjithatë gjykata, sipas rrethanave që do të rezultojnë mund të urdhërojë që uzurfruktari t'i japë garanci, në rast se ka qënë shkarkuar nga një detyrim i tillë ose me kërkesën e pronarit t'i lihet atij administrimi i sendit në uzurfrukt ose një personi tjetër ose dhe dhënia me qira e sendit. Uzurfruktari mund të kërkojë që, me shpenzimet e tij, të heqë dorë nga uzurfrukti për shkak të barrëve e detyrimeve që rrjedhin prej tij. Kur mbaron uzurfrukti, uzurfruktari ose trashëgimtarët e tij detyrohen të vënë në dispozicion të pronarit sendet e vëna në uzurfrukt.

Servituti është barra që i ngarkohet një prone, për përdorimin dhe dobinë e një prone të një pronari tjetër. Servituti vendoset me ligj ose me vullnetin e njeriut. Pronari i pronës shërbyese nuk është i detyruar të kryejë ndonjë veprim për të bërë të mundur ushtrimin e servitutit, përveç kur në ligj ose nga titulli, parashikohet ndryshe. Pronari, në favor të të cilit është vënë servituti, detyrohet t'i shpërblejë pronarit të pronës shërbyese dëmin që i shkaktohet nga krijimi i servitutit. Pronari i një prone që, në bazë të ligjit, ka të drejtë të kërkojë nga pronari i një prone tjetër krijimin e një servituti, në mungesë të një marrëveshjeje, mund t'i drejtohet gjykatës. Servituti detyruet mund të krijohet edhe me akt të organit shtetëror, në rastet e parashikuara me ligj. Vendimi duhet të përcaktojë rregullat e ushtrimit të servitutit dhe shpërblimin e dëmit përkatës. Rregullat për ndërtimin e banesave e të ndërtimeve të tjera, largësia ndërmjet tyre, marrja e dritës dhe e pamjes, nxjerrja e ballkoneve e ndërtime të tjera të kësaj natyre, rregullohen me ligj të veçantë duke respektuar të drejtat e pronarit të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Pronari duhet të lejojë persona të tjerë që të ndërtojnë në pronën e tij të paluajtshme kanale ose të vendosin gypa për kalimin e ujit ose të gazit, si dhe kablllo e tela telegrafikë ose elektrikë dhe instalime të tjera të kësaj natyre, por vetëm kur këto vepra nuk kanë mundësi të kryhen ndryshe ose pa u bërë shpenzime të mëdha. Pronari, kur i shkaktohet dëm, ka të drejtë të shpërblehet. Pronari mund të krijojë mbi pronat e veta ose në dobi të tyre, çdo lloj servituti, me kusht që të mos jetë në kundërshtim me rendin juridik. Servitutet vullnetare krijohen me kontratë ose me testament. Servitutet janë vijuese kur ushtrimi i tyre bëhet pa qenë nevoja për veprime të herëpashërshme të njeriut, siç janë vijat e ujit, pikat e strehëve e të tjera të kësaj natyre. Servitutet janë jo vijuese, kur në ushtrimin e tyre kërkohet kryerja e veprimeve të tashme të njeriut, siç janë e drejta për të marrë ujë, për kullotjen e bagëtive e të tjera të kësaj natyre. *Servitutet mund të jenë të dukshme e të padukshme.* E drejta e servitutit përfshin çdo gjë që është e nevojshme për ta përdorur atë. Pronari, pa pëlqimin e uzurfruktarit, nuk mund të ngarkojë pronën me servitute që cenojnë të drejtat e uzurfruktarit. Servituti mbi një pronë që u përket disa personave në bashkëpronësi mund të krijohet vetëm me miratimin e gjithë bashkëpronarëve. Servituti i krijuar nga vetëm një ose disa bashkëpronarë, hyn në fuqi kur bashkëpronarët e tjerë bashkarisht apo veçmas, kanë dhënë miratimin për krijimin e tij.

Tema 14. Kontratat, veçoritë e kontratave në sektorin bujqësor

Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike. Kontrata mund të lidhet për të krijuar detyrime. Në kontratë palët përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, por brenda kufijve të vendosura nga ligji në fuqi. Që të lidhet një **kontratë** dhe që të jetë **e vlefshme**, duhet që të ekzistojë pëlqimi kontraktor i palëve; të jetë i mbështetur në një shkak të ligjshëm; të jetë përcaktuar objekti që formon lëndën e kontratës; të ketë formën e caktuar ligjore.

- **Kontrata e shitjes** ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi.
- **Kontrata e dhurimit** me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat ajo i pranon.
- **Kontrata e qirasë** me të cilën njëra palë detyrohet t’i japë palës tjetër një send të caktuar në gëzim të përkohshëm, por kundrejt një shpërblimi të caktuar.
- **Kontrata e sipërmarrjes** me të cilën njëra palë detyrohet që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër, një punë ose një shërbim, kurse pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë.
- **Kontrata e transportit** ku transportuesi merr përsipër të transportojë nga një vend në një tjetër udhëtarë, mallra ose bagazhe, kurse udhëtari, dërguesi i mallrave ose i bagazheve është i detyruar të japë për transport mallrat e kontraktuara, si dhe të paguajë çmimin e transportit.
- **Kontrata e huapërdorjes** ku njëra palë i jep palës tjetër, por *pa kundërshpërblim*, një send të caktuar që mund ta përdorë përkohësisht, kurse kjo palë detyrohet ta kthejë atë send në afatin e caktuar në kontratë.
- **Kontrata e porosisë** me anë të së cilës njëra palë merr përsipër të kryejë një ose më shumë veprime juridike për llogari të palës tjetër, por në emër të tij
- **Kontrata e komisionit** që ka si objekt një shërbim të specifikuar dhe të specializuar nga ana e të porositorit, shërbim që ka të bëjë vetëm me shitblerjen e mallrave.
- **Kontrata e depozitës** me të cilën njëra palë merr nga tjetra një send të luajtshëm, por me detyrimin për ta ruajtur dhe për ta kthyer në natyrë.
- **Kontrata e huasë** shfaqet në dy forma kryesore: dhënia e sendeve në gjini, por pa shpërblim, nga një person te një tjetër në formën e ndihmës ekonomike; dhënia e huasë në formë kredie nga ana e subjekteve dhe e institucioneve të specifikuar me ligj.
- **Kontrata e sigurimit të pasurisë, të jetës dhe të shëndetit** ku njëra palë, nëse vërtetohet ngjarja e parashikuar në kontratë, merr përsipër t’i paguajë palës tjetër ose një personi të tretë, në dobi të së cilit është lidhur kontrata, një shpërblim në të holla brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë, por kundrejt një primit të paguar nga i siguruari.

Kontrata është gjithnjë veprim juridik i dyanshëm si i tillë mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj tjetër shfaqjeje të vullnetit.

Pjesë përbërëse e elementeve thelbësore të kontratës janë edhe *kushtet e kontratës*. Në lidhje me këtë neni 676 i Kodit civil përcakton shprehimisht se:

“Kontrata quhet e lidhur, kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë të heshtur.”

Kushtet e kontratës janë tri llojesh *kushte thelbësore, të zakonshme dhe të rastit*

Kontrata, si burim i lindjes së detyrimeve, ka një fillim, një ekzistencë dhe një mbarim. *Fillimi i ekzistencës së kontratës shënohet nga koncepti i lidhjes së kontratës. Kontrata do të quhet e lidhur kur palët e kanë shprehur lirisht vullnetin e tyre se janë dakord mbi të gjitha kushtet thelbësore.*

Pranimi është deklarimi që bën personi të cilit i është drejtuar propozimi ose dëshiron dhe shpreh vullnetin e tij për lidhjen e kontratës së propozuar, sipas kushteve të propozimit. Nëse pranimi i

propozimit nuk përputhet me përmbajtjen e vetë propozimit, ai quhet *mospranim*, por njëkohësisht është si një *propozim i ri*.

Zgjidhja e kontratës për konceptin juridik të zgjidhjes së kontratës, kemi parasysh kontratat e lidhura në mënyrë të rregullt e që i plotësojnë kushtet për t'u quajtur të tilla.

Tema 15. Marketingu bujqësor

Ekzistojnë shumë përkufizime mbi konceptin “marketing”. Disa prej tyre janë:

- Marketingu është një proces social dhe manaxherial nëpërmjet të cilit individët dhe grupet përftojnë atë çka duan dhe kanë nevojë, përmes krijimit, ofrimit dhe shkëmbimit të produkteve me vlerë me të tjeret. Marketingu përfshin të gjitha aktivitetet e orientuara drejt plotësimit të nevojave ose dëshirave të konsumatorëve nëpërmjet shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve.
- Marketingu lidh konsumatorët me produktet.
- Marketingu është procesi i krijimit të konsumatorëve dhe konsumatorët janë shpirti që mban gjallë biznesit.

Hapi i parë që duhet hedhur është të përcaktohet strategjia e marketingut. Nuk ka një mënyrë të vetme për të hartuar një strategji marketing. Ekzistojnë disa mënyra për hartimin e një strategjie marketingu. Strategjia duhet të jetë pjesë e një procesi të vazhdueshëm e vlerësimit të biznesit dhe unike për ndërmarrjen. Ekspertët kanë përcaktuar disa hapa që mund të ndiqen për të orientuar më mirë shitjet dhe për të fituar besnikërinë e konsumatorëve. Strategjia e përgjithshme e marketingut duhet të përfshijë katër strategji të ndryshme:

- **Strategjinë e depërtimit në treg.** Përcaktimin e mënyrave të shitjeve.
- **Strategjinë e rritjes.** Kjo strategji e ndërtimit të biznesit mund të përfshijë: një strategji të brendshme, për shembull si të rrisni burimet njerësore; një strategji bjerjeje, për shembull të blini një biznes tjetër që mund t'ju vlejë, një strategji horizontale ku ju mund të ofroni të njëjtin tip produkti në përdorues të ndryshëm ose një strategji vertikale ku ju do të vijoni të ofroni të njëjtin produkt por duke përdorur një mënyrë tjetër shpërndarjeje në treg.
- **Strategjinë e kanaleve të shpërndarjes.** Zgjedhja e kanaleve pra mënyrave të shpërndarjes së produkteve mund të përfshijë partneritetin me një kompani që merr produktet tuaja dhe i shpërndan nën markën e produkteve të veta, shitje përmes burimeve të brendshme të shpërndarjes, distribucionit në markete.
- **Strategjinë e komunikimit.** Si do të arrini te klientët? Zakonisht një kombinim i taktikave të mëposhtme do të funksiononte më së miri: promovime, reklama, marrëdhëniet me publikun, shitjet personale dhe materiale të shtypura si broshura, katalogë, fletushka, etj. Pasi të jetë zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse të marketingut, atëherë ju mund të përcaktoni strategjinë tuaj të shitjeve. Kjo përfshin mënyrën se si planifikoni të shisni produktin tuaj.
- **Strategjia e forcës së shitjeve.** Nëse planifikoni të keni një forcë shitjeje brenda biznesit tuaj, mendoni të përdorni punonjës të brendshëm apo të jashtëm për të bërë shitjet e produkteve tuaja. Sa punonjës do të punësoni për shitjet? Çfarë strategjie punësimi do të përdorni? Si do t'i trajtoni këta punonjës? A keni menduar që këta punonjës t'i paguani përmes përqindjes nga shitjet që do të bëjnë?
- **Aktivitetet e shitjeve.** Në kohën kur po përcaktoni strategjinë e shitjeve është e rëndësishme që ta reflektoni përmes disa aktiviteteve. Për shembull, duhet të identifikoni cila është perspektiva e biznesit tuaj. Në momentin që listoni të gjitha idetë mbi perspektivën e biznesit, duhet të listoni prioritetet, të përcaktoni tregjet me potencial më të lartë për blerjen e produkteve. Më pas, identifikoni se sa telefonata dhe takime duhet të bëni me këta blerës për

një periudhë të caktuar kohe. Në këtë mënyrë ju mund të përcaktoni numrin mesatar të telefonatave dhe kontakteve për shitje, mesataren e shpenzimeve për shitje dhe mesataren e shpenzimeve për shitës.

Nga fakti se kuptimi i konceptit kyç të marketingut përqëndrohet te konsumatori, çdo subjekt tregtar që merret me prodhimin e produkteve dhe shërbimeve, për të qenë i suksesshëm asnjëherë nuk harron që:

- Në ekonominë dhe tregun e lirë konsumatori është MBRET.
- Çdo herë duhet të vendosë vetën në lëkurën e konsumatorit.
- Duhet të kuptojë përfitimet e konsumatorit nga produkti apo shërbimi ynë.
- Duhet të shesë në bazë të nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve e jo në bazë të nevojave tona, karakteristikave të produktit dhe vetive të tij.
- Duke i plotësuar nevojat e konsumatorit arrin plotësimin e kënaqësisë së tij.

Marketingu është një fushë e gjerë dhe e bukur, ku përveç njohurive shkencore duhet të kesh edhe shpirt krijues për të qenë një profesionist i vërtetë në këtë sektor.

Marketingu është i suksesshëm kur është:

- I përfitueshëm (Profitable).
- Sulmues, më shumë sesa në pozita mbrojtëse (Offensive).
- I integruar (Integrated).
- Strategjik, i orientuar nga e ardhmja (Strategic).
- Efektiv, të japë rezultate (Effective).

Procesi i menaxhimit të Marketingut kalon nëpër këto faza:

- Analiza e gjendjes aktuale - ku jemi tani?
- Vendosja e objektivave - ku duam të jemi?
- Hartimi i strategjive - cila mënyrë është më e mira?
- Përcaktimi i taktikave - si do të arrijmë aty ku duam?
- Zbatimi - të arrijmë atje ku duam!
- Kontrolli – a jemi në rrugën e duhur për të arritur atje ku duam.

Planifikimi i marketingut është i nevojshëm sepse:

- Nxiti të menduarit në mënyrë sistematike për të ardhmen;
- Koordinon më mirë përpjekjet e kompanisë;
- Zhvillon standarde të performancës për kontroll;
- Harton objektiva dhe politika;
- Përgatit më mirë për zhvillime të pa parashikuara;
- Përfshin më gjallërisht manaxherët.

Lind pyetja, pse duhet marketingu bujqësor?

Marketingu i prodhimeve/produkteve bujqësore duhet pasi nëpërmjet tij arrihet:

- Matet pulsi i tregut
- Përgatiten plane veprimi të qëndrueshme
- Zbatohen dhe mësohet gjatë rrugës....
- Përsëritet çdo gjë nga e para

Tema 16. Sigurimi i kapitalit dhe kredisë në bujqësi

Dy janë çështjet kryesore që duhen trajtuar mbi kapitalin.

Sasia e kapitalit të përdorur- Kur kapitali është i pakufizuar i vetmi problem që shtrohet është përcaktimi i sasisë së kapitalit që do të përdoret. Parimi ekonomik që përdoret në këtë rast është:

prodhimi marxhinal në vlerë (**Pmav**) = koston marxhinale të faktorit (**KMa**). Kostoja marxhinale e kapitalit është e barabartë me paratë shtesë plus interesat që duhet të paguhen për përdorimin e tij. Zakonisht sasia e kapitalit të përdorur përcaktohet nga krahasimi i përqindjes margjinale të fitimit nga kapitali me normën e interesit. Parimet ekonomike sugjerojnë që kapitali do të investohet në biznese bujqësore, atëherë kur sigurohet një fitim shtesë që është i barabartë ose më i madh se norma aktuale e interesit.

Shpërndarja e kapitalit të kufizuar midis alternativave të përdorimit në një mënyrë të tillë, që prodhimi marginal në vlerë i lekut të fundit të jetë i barabartë në të gjitha alternativat e përdorimit.

Burimet e sigurimit të kapitalit janë:

- **Pasuria e vetë pronarit ose pasuria neto** - kapitali, pronë e fermerit, quhet pasuri e
- **Kapitali jashtë fermës**. - përfshin sasinë e parave që të tjerët investojnë në shkëmbim të pjesëmarrjes në pronësi, në fitimin dhe në riskun e fermës.
- **Marrja me qira e pasurive** ky burim përfshin marrjen me qira të tokës, të makinerive dhe të mjeteve të tjera.
- **Kontratimi i investitorëve bujqësor**-fermerët mund të kontraktojnë shërbimet e tyre me investitorë bujqësor. Për shembull, prodhuesit e ushqimeve të blegtorisë mund të kontraktojnë me prodhuesit e vezëve dhe mishit të pulave ose dhe me prodhuesit e tjerë bujqësor, që konsumojnë këto ushqime.
- **Kredit** - kredia është burimi i dytë më i madh i sigurimit të kapitalit në bujqësi. Marrja borxh e parave mund të sigurojë një mjet më të shpejtë të rritjes së madhësisë së biznesit.

Llojet e kredive.

Kreditë klasifikohen sipas:

- **afatit të shlyerjes** në kredi afatshkurtër në të cilën përfshihen sasi të kredive, që do të paguhen plotësisht brenda një viti; kredi afatmesëm në të cilën përfshihen ato kredi afati i shlyerjes së të cilave është më shumë se një vit, por më pak se 10 vjet; kredi afatgjatë në të cilën përfshihen kreditë me afat shlyerje 10 vjet ose më shumë dhe që klasifikohen si kredi afatgjatë.
- **qëllimit të përdorimit** në kredi për mjete afatgjatë; kredi për mjete të tjera; kredi personale.
- **garancisë së përdorimit** në kredi të garantuara; kredi të paguarantuar.
- **metodës së shlyerjes së kredive** klasifikohen edhe sipas metodave që përdoren për shlyerjen e tyre në përputhje me qëllimin, llojin e garancisë (kolateralit) të përdorur dhe projektit të lëvizjes së parave në biznes.

Për shlyerjen e kredisë përdoren metodat e mëposhtme:

- **Pagesa në një moment të vetëm**
- **Pagesa e linjave të kreditit**
- **Pagesa me këste**

Shuma e kredisë që do të shlyhet (pa interesin) shpesh quhet principial.

Faktorët që ndikojnë në marrjen e kredisë

Përdorimi i kreditit varet nga kapaciteti huamarrës i biznesit. Kapaciteti huamarrës është shuma maksimale e kredisë që mund të marrë biznesi. Diferenca midis kapacitetit huamarrës dhe shumës së marrë borxh përbën **kredinë rezervë**. Kredia rezervë është pjesa e papërdorur e kapacitetit huamarrës. Faktorët që ndikojnë në shumën e kredisë që do të merret janë:

- *Levarazhi dhe dobishmëria.* Levarazhi llogaritet si raport i kredisë ose detyrimeve me pasurinë neto. Nëse fitimi nga mjetet totale është më i madh se sa kostoja e kapitalit të marrë borxh (interesi), rritja e levarazhit është një avantazh për rritjen e dobishmërisë së fermës.
- *Levarazhi dhe rrisku.* Levarazhi punon në favor të fermerëve në vite të mbara dhe kundër tyre në vite jo të mbara.
- *Aftësia ripaguëse e biznesit bujqësor.* Çdo biznes duhet të sigurojë paratë e domosdoshme për të paguar shpenzimet e fermës, taksat mbi të ardhurat, shpenzimet e jetesës familjare dhe të shlyej detyrimet.

Faktorët që ndikojnë në dhënien e kredisë

Në dhënien e kredive ndikojnë një sërë faktorësh: qëllimet e kredisë, reputacioni dhe aftësitë drejtuese, gjendja ose pozita financiare, aftësia riparuese, kolaterali ose garancia.

Fermerët marrin kredi nga *bankat tregtare, kooperativat e kreditit bujqësor, individët dhe tregtarët dhe burime të tjera* që janë dhe institucione të tjera financiare si: Banka e Kursimeve, Kompanitë e Sigurimit të Jetës dhe institucione të tjera financiare shtetërore dhe private.

Kapitali mund të përdoret në dy lloje investimesh:

- Për shpenzime operative vjetore, si: farë, pleh, ujë, kimikate, karburant etj.
- Për pasuri kapitale, si: tokë, makineri, ndërtesa, pemëtore dhe bagëti.

Për analizën e çdo lloji investimi përdoren metoda të ndryshme për shkak të ndryshimeve që ekzistojnë në kohën e kryerjes së shpenzimeve dhe marrjes së të ardhurave.

Tema 17: Sigurimi dhe përdorimi i tokës

Format e ndryshme të administrimit të tokës. Toka ka një sërë karakteristikash të cilat janë të listuara më poshtë:

- Toka është një burim prodhues **i përhershëm** që nuk amortizohet.
- Niveli e lëndëve ushqyese në tokë përbën **pjellorinë** e saj.
- Toka është një burim **i palëvizshëm** që do të thotë se ajo nuk mund të spostohet për t'u kombinuar me burimet e tjera prodhuese.
- Toka nuk është vetëm një **burim specifik në përgjithësi**, por edhe çdo **fermë apo parcelë** është e veçantë.
- Sasia e tokës së mundshme për bujqësi është kryesisht e fiksuar, megjithëse sasira të vogla toke mund të futen në prodhim nga pastrimi dhe drenazhimi ose mund të pakësohet nga përdorimi jobujqësor.

Planifikimi i përdorimit të tokës.

Ekzistenca e burimeve të ndryshëm toke në çdo fermë shpjegon faktin pse hapi i parë në planifikimin e përgjithshëm është inventarizimi i plotë i burimit tokë, që përfshin llojet e tokës, drenazhimin, pjerrësinë dhe prodhimin. Pa kryerjen e këtij inventari, shumica e planeve dobiprurëse nuk mund të hartohen. Planifikimi i përgjithshëm synon maksimizimin e fitimeve nga shumica e burimeve të pandryshueshme. Sasia e fiksuar e tokës në periudhën afatshkurtër, bën që puna për planifikimin, të fillojë me të. Përdorimi i tokës është i ndikuar nga ndryshimet rajonale të produktivitetit të saj.

Format e administrimit të tokës. Një fermer me fillimin e aktivitetit të tij duhet të marrë dy vendime të rëndësishme: *sa tokë duhet të ketë dhe si duhet ta sigurojë atë.* Gabimet që bëhen në këtë pikë mund të jenë me pasoja të mëdha për biznesin e fermës për shumë vite. Një biznes bujqësor me

sipërfaqe tokë shumë të vogël mund të mos përdor plotësisht burimet e tjera prodhuese duke kufizuar fitimin në nivele të ulëta. Nga ana tjetër një sipërfaqe tokë e madhe mund të kërkojë marrjen hua të një sasive të madhe parash duke shkaktuar problem në lëvizjen e parave dhe në aftësinë drejtuese të fermerit. Administrimi i tokës ka të bëjë me kontrollin e tokës dhe jo pronësinë e saj. Kontrolli i tokës mund të arrihet me dy mënyra:

- Pronësia mbi tokën dhe marrja me qira e tokës.

Pronësia mbi tokën

Përparësitë e pronësisë mbi tokën janë:

- *Siguri në përdorim dhe zotërim.*
- *Kolateral ose garanci për marrjen e një borxhi.*
- *Pavarësi dhe liri drejtimi.*
- *Masë mbrojtëse ndaj inflacionit.*
- *Rrit krenarinë e pronarit.*

Vështirësitë/mangësitë e pronësisë mbi tokën janë:

- Qarkullimi i parave.
- Fitim të ulët nga kapitali.
- Më pak kapital qarkullues.
- Kufizon madhësinë e biznesit.

Burimet më kryesore të sigurimit të tokës janë:

- Blerja e tokës
- Trashëgimnia
- Dhuratat e ndryshme.

Nëpërmjet marrjes së tokës me qira fermeri në përgjithësi do të sigurojë një fitim më të madh me një sasi të kufizuar kapitali. Përparësitë e marrjes së tokës me qira janë:

- kontrolli mbi një sipërfaqje më të madhe.
- më shumë kapital qarkullues.
- drejtim shtesë.
- madhësi më fleksibël.
- detyrime financiare më fleksibël.

Vështirësitë/mangësitë e tjera të marrjes me qira të tokës janë:

- Pasiguria.
- Investime të pakta.
- Akumulimi i ngadaltë i pasurisë.

Blerja e tokës mbështetet në ligj si çdo veprim tjetër financiar. Hapi i parë për marrjen e vendimit për të blerë tokë duhet të jetë **përcaktimi i vlerës së tokës**. Ndërsa **potenciali i të ardhurave** është një tregues i rëndësishëm për përcaktimin e vlerës së tokës. Faktorë të tjerë që ndihmojnë në përcaktimin e vlerës së tokës janë lloji i tokës, topografia dhe klima, zona ose rajoni, vendndodhja, ndërtesat dhe përmirësimet, madhësia, afërsia me tregjet, presioni urban. Ekzistojnë dy metoda bazë për të përcaktuar vlerën e tokës ose çmimit të saj:

Metoda e vlerës së tregut. Sipas kësaj metode krahasohen karakteristikat e tokës që është shitur kohët e fundit, me tokën që do të vlerësohet. Çmimi i krahasueshëm i shitjes së tokës përcaktohet mbasi rregullohen diferencat për faktorë, të tillë si: lloji i tokës, produktiviteti, madhësia, rajoni, vendndodhja, ndërtesat dhe përmirësimet, afërsia me tregjet, presioni urban.

Tre faktorë të tjerë që merren parasysh kur caktohet çmimi krahasues i shitjes janë:

- Metoda e financimit të blerjes.
- Marrëdhëniet midis palëve.
- Koha e shitjes.

Metoda e kapitalizimit të të ardhurave. Kapitalizimi i të ardhurave përdor metodat e analizës së investimeve për të vlerësuar vlerën neto aktuale të një shume të ardhurash të ardhëshme nga toka. **Ekuacioni** i llogaritjes së vlerës aktuale ose prezente është:

$$V = \frac{An}{i}$$

An - e ardhura neto mesatare vjetore;

i- përqindja zbritëse ose përqindja e kapitalizimit;

V- vlera e tokës.

Hapi i parë në metodën e kapitalizimit të të ardhurave është **përcaktimi i të ardhurave neto mesatare vjetore**. Ato përcaktohen si diferencë e të ardhurave totale që priten të sigurohen nga toka dhe shpenzimeve që kryhen për realizimin e tyre. Të ardhurat totale përcaktohen duke u bazuar në vlerësimin e prodhimit dhe çmimit të shitjes së tij. Kostoja totale e faktorëve, përcaktohet duke u bazuar në sasinë e shpenzimeve të përdorura sipas llojit të tyre dhe çmimeve të blerjes. Hapi i fundit në metodën e kapitalizimit të të ardhurave është zgjedhja e përqindjes së kapitalizimit.

Llojet e qirasë në bujqësi.

Qiraja është një kontratë ligjore nëpërmjet së cilës, pronari i tokës i jep fermerit të drejtën e zotërimit dhe përdorimit të saj për një periudhë kohe të caktuar, kundrejt një pagese të përcaktuar që shpesh quhet **rentë**. Pagesa, mund të jetë **në para, në pjesë prodhimi ose një kombinim i të dyjave**. Ekzistojnë tre lloje qirash:

- **Qiraja në para** që e ka rentën të specifikuar si pagesë në para për hektarë ose për dynym.

Renta në para ka disa përparësi dhe vështirësi.

- Thjeshtësia,
- Liri drejtuese.
- Risku.
- Kërkesat për kapital.
- Përdorimi i keq i tokës.
- Përmirësime të dobëta.
- Qira e pandryshueshme.
- **Qiraja me pjesë në bujqësi** janë të përhapura shumë në perëndim dhe në zona të tjera ku dominojnë fermat e grurit. Këto qira përcaktojnë që pronari duhet të marrë një pjesë të caktuar të prodhimit të prodhuar.

Përparësitë dhe vështirësitë e qirave me pjesë në bujqësi

- Qiraja me pjesë në bujqësi është e ndryshueshme.
- Risku dhe pasiguria ndahen midis palëve.
- Liria e drejtimit është më e vogël.
- **Qiraja me pjesë në blegtori** është shumë e ngjashme me atë me pjesë në bujqësi me përjashtim që të ardhurat në blegtori ndahen midis pronarit dhe fermerit qiramarrës. Qiramarrësi siguron të gjithë punën dhe makineritë, ndërsa pronari, tokën, ndërtesat, një pjesë të bagëtive dhe shpenzimet operative.

Përparësitë dhe mangësitë që lidhen me një qira me pjesë në blegtori janë:

- Niveli i qirasë është më i lartë për pronarin.
- Risku dhe pasiguria ndahen midis palëve.
- Rriten kërkesat për kapital nga pronari.
- Drejtimi i biznesit kryhet nga të dyja palët.
- Kërkohen regjistrime të sakta.

Treguesit që vlerësojnë nivelin e fragmentimit të tokës

Shumica e autorëve të cilët janë përpjekur të bëjnë vlerësimin e nivelit të fragmentarizimit, përdorin *një mesatare të thjeshtë të numrit të ngastrave për fermë dhe një madhësi mesatare të fermës*. Këto metoda vlerësimi që shprehin anën sasiore të fragmentarizimit nuk janë të sakta sepse ato nuk marrin parasysh distancën e parcelave nga njëra-tjetra dhe nga shtëpia e fermerit.

Një tregues tjetër që mund të masë nivelin e fragmentarizimit është *koeficienti që llogaritet duke pjestuar distancën mesatare të ngastrave me madhësinë mesatare të tyre*. Ky tregues është një vlerësues i mirë i distancës por nuk merr parasysh madhësinë e fermës dhe madhësinë e ngastrave. Fragmentimi i fermës shoqërohet me përparësi dhe të meta që ndikojnë në efektivitetin e prodhimit në fermë.

Përparësitë kryesore janë:

- Redukton riskun e prodhimit.
- Ndhmon në realizimin e qarkullimit bujqësor.
- Përdorimi i disa zonave ekologjike.
- Përdorimi racional i fuqisë punëtore në fermë.
- Shfrytëzimi i veçorive të tregut të produkteve.

Vështirësitë kryesore janë:

- Humbje të sipërfaqes së tokës.
- Rriten shpenzimet e transportit.
- Harxhimi i kohës së punës.
- Pengon investimet për ujitjen e tokës.
- Mos shfrytëzimi i mekanikës bujqësore.
- Pengon krijimin e shoqatave të përbashkëta të fermerëve.

Tema 18. Qiraja e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave

Toka bujqësore në pronësi të shtetit janë sipërfaqet që në dokumentacionin kadastral figurojnë në kategorinë e resursit “tokë bujqësore”, të cilat në kohën e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 452, datë 17.10.1992 të Këshillit të Ministrave “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, kanë qenë në administrim të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe kanë mbetur pa u ndarë në pronësi apo në përdorim të familjeve bujqësore, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi, dhe të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të VKM 460, datë 22.05.2013 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” gëzojnë statusin juridik të pronësisë shtetërore. Baza ligjore për trajtimin e këtyre tokave me qira: Ligji nr. 8318, datë 01.04.1998 “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, i ndryshuar; VKM nr. 460, datë 22.05.2013 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr.6, datë 05.06.2013 “Për kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e përlllogaritjes së kritereve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit”. Dokumentacioni i plotë i nevojshëm përcaktohet në VKM nr. 460, datë 22.05.2013 “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”.

Aplikimi fillestar -Subjektet të cilët kërkojnë për të marrë me qira tokë bujqësore në pronësi të shtetit, paraqesin kërkesën pranë Ministrisë në cilësinë e autoritetit qiradhënës.
Kërkesa paraqitet me shkrim dhe përmban:

- Identitetin e kërkuesit dhe, në rastin e personave fizikë ose juridikë, dokumentin e regjistrimit si subjekt tregtar;
- Planimetrinë e sipërfaqeve të parcelave (pronave) që kërkohen për qiramarrje në shkallën 1:2500;
- Pasqyrën kadastrale të parcelave (pronëve) me madhësinë e sipërfaqes për secilën prej tyre;
- Vërtetimin e siguruar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) për statusin juridik të pronësisë, për të gjitha parcelat e tokës objekt kërkese për qiramarrje, në rastin kur këto sipërfaqe përfshihen brenda zonave kadastrale ku është kryer regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme ose vërtetimin nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) e qarkut, në rastin kur këto sipërfaqe përfshihen në zona kadastrale ku nuk është kryer regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme;
- Vërtetimin e lëshuar nga DAMT-ja e qarkut për kategorinë e tokës sipas bonitetit për parcelat objekt i kërkesës për qiramarrje;
- Një përshkrim të përgjithshëm të projektit për veprimtarinë bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën objekt kërkese për qiramarrje, në të cilën specifikohen kulturat bujqësore ose speciet e bimëve që do të mbillen, teknologjitë që do të aplikohen në kultivimin e bimëve dhe përpunimin e produkteve, investimet në infrastrukturë, të shprehura në tregues fizikë dhe monetarë, tregu i shitjes, burimet e financimit të shprehura në vlerë, që garantojnë investimet, ndikimin e veprimtarisë në shtimin e numrit të të punësuarve;
- Afatin e përdorimit të tokës për qiramarrje, në varësi edhe të kulturave bujqësore ose specieve të bimëve që do të mbillen.
- Vërtetimin se nuk ka detyrime financiare ose ligjore të pashlyera ndaj shtetit.

Tema 19. Shfrytëzimi i pyjeve, fondi pyjor si dhe regjimi juridik i ujërave

Ligji për *Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor kombëtar* në Republikën e Shqipërisë ka për qëllim zhvillimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, pasuri kombëtare me rëndësi të veçanta, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës dhe tokës, në ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhues, ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm. Objekt i këtij ligji janë administrimi, qeverisja dhe mbrojtja e fondit pyjor e kullësor kombëtar, mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, të pasqyruar në dokumentet strategjike dhe angazhimet në kuadrin e konventave, marrëveshjeve, protokolleve dhe traktateve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, për të garantuar përmbushjen në vijimësi të funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale dhe kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë. Ky ligj përcakton rregullat, detyrimet, të drejtat, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e institucioneve shtetërore, të njëjsteve të qeverisjes vendore, pronarëve dhe biznesit privat, për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kullësor kombëtar, gjithashtu përcakton funksionimin e Shërbimit Pyjor si shërbim publik, unifikon sistemin e informacionit të pyjeve dhe kullotave, pavarësisht formës së pronësisë.

Në varësi të formës së pronësisë fondi pyjor dhe kullësor, administrohet nga:

- njësitë e qeverisjes vendore, për fondi pyjor e kullësor brenda kufijve territorial administrativ;
- ministria për fondin pyjor dhe kullësor që është pjesë e rrjetit të Zonave të Mbrojtura të Republikës së Shqipërisë;
- pronarët privatë, pyjet dhe kullotat e livadhet në pronësi të tyre;

Njësia e qeverisjes vendore ngre strukturën e saj për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullor brenda kufijve territorial administrativ me personel inxhiniero-teknik me arsim pyjor. Numri i nëpunësve në strukturën e administrimit të fondit pyjor dhe kullor përzgjidhet në funksion të sipërfaqes si vijon:

- Një nëpunës për 750 – 1000 ha për pyjet e lart
- Një nëpunës për 1500 – 2500 ha për pyjet e ulët dhe shkurre
- Një nëpunës për 4000 – 6000 ha për kullota dhe livadhe.

Njësia e qeverisjes vendore, bashkëpunon me shoqërinë civile dhe strukturat e shërbimit pyjor, për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor e kullor të marrë pronësi. Kriteret dhe procedurat e administrimit të fondit pyjor e kullor kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Administrimi i fondit pyjor dhe kullor kombëtar bëhet sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pavarësisht formës së pronësisë.

Mbrojtja e pyjeve, mjedisit pyjor dhe e kullotave nga dëmtimet që ndikojnë në ekuilibrin ekologjik të tyre, është detyrim i përhershëm dhe përgjegjësi ligjore e të gjitha strukturave shtetërore, njësisive të qeverisjes vendore, pronarëve privatë dhe personave fizikë a juridikë, vendas e të huaj, që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor e kullor kombëtar. Mbrojtja e tyre bazohet në dispozitat e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Mbrojtja e fondit pyjor e kullor kombëtar nga dëmtimet, prerjet ose kullotjet pa leje, sëmundjet, insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi i paligjshëm, si dhe çdo element tjetër i cili dëmton apo ka gjasa të dëmtojë, përfshirë veprat hidroteknike, pritmat malore dhe gardhet, veprat e ujit të pijshëm për blegtorinë, lerat, hauzet, koritat, çezmat, të cilët ndodhen brenda fondit pyjor e kullor kombëtar e që shërbejnë për zhvillimin dhe mbrojtjen e tij, është detyrim i përhershëm e të gjitha strukturave shtetërore, njësisive të qeverisjes vendore, pronarëve privatë dhe personave fizikë a juridikë, vendas e të huaj, që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor e kullor kombëtar. Luftimi i sëmundjeve, dëmtuesve dhe insekteve në fondin pyjor e kullor kombëtar në rastet e forcës madhore, organizohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe pronarët privatë, ndërsa fondet e nevojshme përballohen nga buxheti i shtetit. Trajtimi i pyjeve dhe kullotave bazohet në masat dhe rekomandimet e planifikuara në planet e mbarështimit, nëpërmjet planeve operacionalë vjetorë, të cilët zbatohen nga strukturat që administrojnë pyjet, kullotat dhe livadhet publike, pronarët privatë, si dhe nga të gjithë personat juridikë e fizikë, që zhvillojnë veprimtari në fondin pyjor e kullor kombëtar.

Vëllimi i materialit drusor që do të shfrytëzohet çdo vit, planifikohet brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit, të fondit pyjor kombëtar, bazuar në planet e mbarështimit. Këtij vëllimi i shtohet edhe vëllimi i materialit drusor me vlerë ekonomike, i planifikuar nga prerjet kulturore si edhe nga dëmtimet si rezultat i katastrofave natyrore ose zjarret. Përdorimi i kullotave publike dhe private, kryhet duke zbatuar rekomandimet e planit të mbarështimit, për: kohën e hyrjes dhe të daljes së bagëtive; aftësinë mbajtëse, për të mos lejuar mbikullotjen; kullotjen racionale. Përfshihen përkohësisht nga kullotja, ngastrat e kullotave dhe livadheve eksperimentale; ku kryhen punime përmirësuese; të degraduara.

Tema 20. Sigurimi dhe drejtimi i krahut të punës

Krahu i punës është *një input i vazhdueshëm* duke marrë parasysh shërbimin që ai siguron. Ai nuk mund të ruhet për një përdorim të mëtejshëm. *Krahu i punës është një input i shpejtë, i pandashëm duke nënkuptuar që ai ekziston vetëm në njësi të plota e të pandashme.* Burimet e krahut të punës për fermat bujqësore janë:

- Fermerët dhe anëtarët e tjerë të familjes.
- Punëtorët e marrë me qira.

Punëtorë të rregullt konsiderohen ata që punojnë më shumë se 150 ditë në vit dhe punëtorë sezonalë konsiderohen ata që punojnë në fermë për një kohë të shkurtër. Qëllimi i drejtimit të krahut të punës nuk është maksimizimi i fitimeve nga puna, por përdorimi i të gjithë faktorëve të prodhimit për të arritur me efektivitet objektivat e fermerit. Lidhur me gjendjen dhe përdorimin e krahut të punës, ekzistojnë tre situata në fermat bujqësore:

- Krahu i punës i përhershëm ose fiks
- Krahu i punës variable
- Krahu i punës i kufizuar

Për matjen e efektivitetit të punës, shpesh përdoret koncepti i **numrit të personave që është e nevojshme të punojnë gjatë një viti në fermë** (koeficienti person - vite). Kjo është një procedurë për të kombinuar **punën e fermerit, punën e familjes dhe atë të marrë me pagesë**, në një shifër të vetme, për të bërë kështu të mundur krahasimin midis fermave.

Efektiviteti i punës matet me treguesit e mëposhtëm:

- ***Vlera e prodhimit bujqësor për person.***

$$\text{Vl. Prodh. Bujq.për Person} = \frac{\text{Vl. totale e produkteve të prodhuara}}{\text{Nr. e personave që punojnë në një vit}}$$

Ky tregues i efektivitetit të do të influencohet nga madhësia e biznesit, lloji i aktivitetit, makineritë dhe paisjet e tjera që kursejnë krahun e punës dhe që janë përdorur në fermë.

- ***Kostoja e punës për ha tokë të punueshme.***

$$\text{Kostoja e punës/ha} = \frac{\text{Kostoja totale e punës}}{\text{Numri i hektarëve të punuar}}$$

- *Njësi pune për person.*

Njësitë totale të punës të nevojshme

Njësitë e punës për person =

Numri i personave për një vit

Përmirësimi i efektivitetit të punës

Efektiviteti i punës mund të përmirësohet duke rritur sasinë e kapitalit të investuar për punëtor nëpërmjet përdorimit të makinerive me kapacitet më të madh dhe formave të tjera të mekanizimit. Përqindja margjinale e zëvendësimit dhe çmimet e inputit përcaktojnë strukturën e duhur. Buxheti i pjesshëm mund të jetë i dobishëm për të kontrolluar dobishmërinë e një kapitali të propozuar për zëvendësimin e punës. Marrëdhëniet e mira njerëzore mund të jenë faktori më i rëndësishëm në menaxhimin e krahut të punës të marrë me pagesë. Kjo përfshin gjëra të tilla si: qëndrimi miqësor, besueshmëria, respekti reciprok dhe dëshira për të dëgjuar sugjerimet dhe ankesat e të punësuarit.

Programet nxitëse përdoren shpesh si shtesë e pagave bazë. Ato synojnë të rrisin **fitimin** nëpërmjet:

- reduktimit të kohës së punës së punonjësve,
- rritjes së interesit të punëtorit për punë,
- rritjes së produktivitetit të punës.

Tema 21. Sigurimi dhe përdorimi i makinerive bujqësore

Traktorët dhe makineritë e tjera bujqësore përfaqësojnë një investim me përmasa të mëdha në një fermë bujqësore komerciale. Kostot mund të kontrollohen nëpërmjet 4 metodave të përgjithshme:

- Shmangia e investimeve të panevojshme për makineri për të pakësuar kostot fikse.
- Kontrolli i kostove variabël ose operative.
- Rritja e koeficientit të shfrytëzimit të traktorëve dhe makinerive për të pakësuar kostot fikse për njësi prodhimi.
- Zgjedhja e alternativës më të dobishme të zotërimit dhe përdorimit të traktorëve dhe makinerive.

Një fermer duhet të jetë në gjendje të llogarisë kostot fikse dhe variabël të një makinerie dhe të kuptojë se si lidhen kostot me përdorimin e makinerisë. Kostot fikse fillojnë me blerjen e një makinerie dhe vazhdojnë për aq kohë sa makineria është pronë e fermerit.

Amortizimi është një tregues llogaritës që lidhet me veprimtaritë investuese të biznesit dhe mund të shihet si i tillë nga dy këndvështrime:

- Amortizimi është një shpenzim jo në para që përfaqëson **një humbje të vlerës së një mjeti afatgjatë** për shkak të përdorimit në biznes, për të krijuar të ardhura.
- Amortizimi shërben **për të shpërndarë vlerën fillestare** gjatë gjithë jetës ekonomike.

Shuma e amortizimit që i përket një mjeti, është e barabartë me vlerën e humbur gjatë gjithë kohës së përdorimit.

Shpenzimet për interesat llogariten duke u mbështetur në sasinë mesatare të kapitalit të investuar për makineri dhe normën e interesit.

Taksat dhe siguracionet për makineritë llogaritet duke u mbështetur në ligje dhe norma të përcaktuara.

Ruajtja ose strehimi element i kostove fikse të makinerive mund të jenë dhe kostoja për ruajtjen ose strehimin e makinerive në ndërtesa të posaçme.

Pagesat e qirasë do të përfshihen në kostot e pandryshueshme ose kostot e pronësisë.

Në grupin e kostove variable bëjnë pjesë:

Kostot e mirëmbajtjes-janë shpenzime të detyrueshme për çdo vit në mënyrë që mjetet afatëgjate të jenë në gjendje të mirë pune.

Kostot operative të fermës konsiderohen të gjitha paratë që kemi nxjerrë për realizimin e të ardhurave dhe mbajtjen e biznesit.

Kostot e punës janë kostot direkte për pagesën e secilit punonjës të fermës të përfshirë në krijimin e produkteve për shitje. Ekzistojnë dy burime të rëndësishme pune që nevojitet për drejtimin e makinerive bujqësore në fermë: *puna e pronarit të fermës ose e pjestarëve të familjes së tij dhe puna me qira.*

Marrja me qira e makinerive është një alternativë më e preferueshme për sigurimin e tyre, kur sasia e kapitalit është shumë e kufizuar, dhe përqindja e interesit për kapitalin e marrë hua është e lartë. Zakonisht, kohëzgjatja e marrëveshjeve të qirasë mund të jetë pak ditë ose një sezon prodhimi. Marrja me qira e makinerive mund të jetë në dy forma:

- Marrja me qira e makinerive për disa ditë ose për një sezon prodhimi dhe përdorimi i tyre nga qiramarrësi.
- Marrja me qira, për një ose disa ditë, për kryrejen e një ose disa proceseve të punës kundrejt një pagese ose tarife të caktuar dhe përdorimi i makinerisë nga pronari i saj.

Ka disa parime ekonomike që përdoren për marrjen e vendimeve në lidhje me makineritë bujqësore. Ato janë:

- parimi i zëvendësimit të faktorëve.
- koncepti i kostos oportune.
- dallimi midis kostove fikse dhe kostove variabël.

Objektivi kryesor gjatë zgjedhjes së makinerive është blerja e makinerisë që realizon të gjitha kërkesat **brenda një kohe të caktuar dhe me kosto totale minimale.**

Zgjedhja e një makinerie bujqësore përfshin dy momente të rëndësishme:

- kapaciteti i makinerive dhe,
- shkallën e përdorimit ose shfrytëzimit.

Tema 22: Madhësia e fermës dhe rritja e saj

Procesi i gjetjes së madhësive optimale të fermës quhet rritje e saj. Për shkak të një faktori të kufizuar, siç është **toka**, prodhimi në afatin e shkurtër mund të rritet vetëm nga **intensifikimi i prodhimit.**

Dallohen tri lloje kostosh në lidhje me madhësinë e fermës në afatin e gjatë:

- Kosto kostante
- Kosto në rënie
- Kosto në rritje

Kostot në rënie tregojnë **fitime të shkallës në rritje**, ndërsa **kostot në rritje** tregojnë **fitime të shkallës në rënie.** Këto marrëdhënie tregohen në figurën e mëposhtme, duke përdorur kurbën e kostos mesatare për njësi prodhimi parë në këndvështrimin afatgjatë.

Kostot në rënie tregojnë **ekonomizim** të madhësisë, ndërsa **kostot në rritje** tregojnë **jo ekonomizimin** e saj. *Fermerët synojnë të rrisin madhësinë e bizneseve të tyre deri në momentin ku kostot mesatare totale janë në rënie dhe fitimi për njësi të prodhimit është në rritje, për një nivel të dhënë të çmimeve të produkteve.*

Faktorët që ndikojnë në **ekonomizim** të madhësisë së fermës janë:

- Shpërndarja në më shumë njësi prodhimi e kostove fikse me rritjen e madhësisë së fermës.
- Rritja e efektivitetit të përdorimit të punës, makinerive dhe ndërtesave me rritjen e madhësisë së fermës.
- Përqëndrimi në një sipërmarrje të veçantë dhe zgjerimi i saj mund ta bëjë me efektive madhësinë e fermës.

Faktorët që ndikojnë në **joekonomizim të madhësisë** janë:

- Në qoftë se **prodhimi rritet vazhdimisht**, ai do të arrijë në një pikë të tillë **ku disa faktorë do të jenë të kufizuar**.
- **Prodhimi bujqësor realizohet nga organizma të gjalla** me aftësi të kufizuara biologjike.
- Edhe kur të gjithë **faktorët e material të prodhimit: toka, puna dhe kapitali** disponohen në sasi të mjaftueshme, **faktori drejtim** bëhet i kufizuar.

Rritja e madhësisë së fermës bujqësore mund të përcaktohet si ndryshim në sipërfaqen e tokës; vlerën e prodhimit total; investimet kapitale totale.

Domosdoshmëria e rritjes së madhësisë së fermave bujqësore kushtëzohet nga disa faktorë:

- Shfrytëzimi i efekteve të ekonomisë së shkallës ose gjetjes së madhësisë optimale të fermës.
- Sigurimi i një të ardhurë neto që është e kënaqshme për mbajtjen e familjes fermere.
- Rritja e kapacitetit të traktorëve, makinerive dhe pajisjeve të tjera prodhuese.
- Niveli i lartë i aftësive drejtuese.

Rritja e madhësisë së fermës bujqësore duhet të plotësojë disa kushte:

- Rezerva në aftësinë drejtuese të biznesit të fermës.
- Dobishmëria e biznesit..
- Madhësia fillestare minimale.
- Burimet e papërdorura.
- Burimet e përshtatshme.

Sipas llojit, fermat janë fermat kapitaliste dhe fermat familjare. Tërësia e fermave familjare, sipas mënyrës së financimit të rritjes:

- Ferma që janë në gjendje të financojnë një zhvillim të tillë që t'i lejojnë ato të synojnë drejt strukturës që do të rezultojë optimale.
- Ferma që edhe pse nuk janë në gjendje të përmirësojnë më tej pozicionin e tyre të efektivitetit afatgjatë, mund të realizojnë një përqindje shitjeje të tillë që ju lejon atyre të ruajnë një nivel efektiviteti të kënaqshëm dhe të mjaftueshëm për të mbijetuar.
- Fermat që nuk investojnë ose që realizojnë një ritëm rritjeje më të ulët se ai i domosdoshëm për të garantuar edhe mbijetesën në të ardhmen.

Për të qenë i suksesshëm fermerit i nevojitet një strategji e planifikuar mirë për të arritur rritjen e fermës.

Planifikimi bën dallimin midis rritjes së suksesshme dhe rritjes jo të suksesshme. Disa probleme që merren në konsideratë dhe përfshihen në procesin e planifikimi të rritjes së fermave janë:

- Përmirësimi i aftësive drejtuese.
- Sigurimi i kapitalit të nevojshëm për rritjen e fermës.

Katër janë burimet shtesë të kapitalit ku secili ka epërsi dhe të meta në vetvete:

- Vlera neto e pronarit
- Kapitali i marrë borxh ose me kredi
- Pasuritë e jashtme

- Marrja me qira

Biznesi i fermës është vazhdimisht i ekspozuar ndaj risqeve. Një biznes i rritur që është zgjeruar vetëm me kredi ose hua shtesë është i ekspozuar më shumë ndaj riskut financiar. Përqindja e rritjes së madhësisë së fermës shpesh e ekspozon biznesin e saj më shumë ndaj riskut. Riskun mund ta kufizojë sasia e kapitalit debitor të nevojshëm për të financuar rritjen.

Tema 23. Detyrat e kontabilitetit, inventarizimi dhe bilanci në bujqësi

Kontabiliteti merret me matjen, grumbullimin, regjistrimin, përpunimin dhe paraqitjen e informacionit financiar, për të informuar të gjithë të interesuarit dhe ndihmon në mënyrë efektive në drejtimin dhe funksionimin e njësive ekonomike. Kontabiliteti është i përgjithshëm dhe i aplikuar. Disa nga detyrat dhe qëllimet e tij janë;

1) Regjistrimi i veprimeve ekonomike

Njësitë që kanë si qëllim fitimin, kryejnë çdo ditë veprime të ndryshme siç janë: blerja, shitja e produkteve dhe shërbimeve. Kontabiliteti duhet të kryejë regjistrimin e këtyre veprimeve, duke krijuar bazën e informacioneve që u nevojiten subjekteve të ndryshme, që nga administratorët e deri tek institucionet shtetërore.

2) Klasifikimi i veprimeve ekonomike .

Veprimet e ndryshme ekonomike, që janë regjistruar duhet të klasifikohen para se të hartohen raportet financiare. Me klasifikim kuptojmë grupimin e veprimeve ekonomike të njëlojta. Për shembull, veprimet e shitjeve duhet të grupohen së bashku dhe të klasifikohen si “shitje” po kështu veprimet që kanë të bëjnë me blerjet e mallrave duhet të grupohen së bashku në zërin “blerje”.

3) Llogaritja e kostos.

Nëpërmjet regjistrimit të veprimeve të ndryshme ekonomike dhe grupimit të tyre, kontabiliteti ka si qëllim të llogarisë kostot në përgjithësi për tërë njësinë ose për prodhime dhe shërbime të veçanta të saj. Kjo llogaritje i jep njësisë informacion të dobishëm mbi ecurinë e saj.

4) Planifikimi i veprimtarive të ardhme.

Njësitë ekonomike, sidomos ato që kanë qëllim fitimin, duhet të përcaktojnë objektivat e tyre në terma ekonomike dhe synimet në realizimin e veprimtarisë së tyre ekonomike. Në këtë mënyrë, njësi ekonomike ka mundësi të krahasojë rezultatet faktike me ato të planifikuara, për të kontrolluar ecurinë e saj. Ky planifikim duhet të realizohet duke shfrytëzuar informacionet, metodikat dhe procedurat që ofron llogaria.

5) Përcaktimi i tatimeve që duhet t'i derdhen buxhetit.

Kontabiliteti regjistron veprimet ekonomike të njësive dhe në bazë të vëllimit të tyre përcaktohet dhe shuma e llojeve të ndryshme të tatimeve që duhet të paguajë njësi.

6) Kontrolli i regjistrimeve.

Për t'u siguruar që veprimet janë regjistruar, klasifikuar dhe përmbledhur siç duhet, kryhet vazhdimisht kontrolli i tyre. Ky nuk është një kontroll thjesht aritmetik, por synon edhe kontrollin e respektimit të procedurave të kontabilitetit dhe të politikës së zgjedhur të pasqyrit të veprimtarisë.

7) Regjistrimi automatik i veprimeve.

Ky regjistrim është i domosdoshëm sidomos në njësitë me përmasa të mëdha, në të cilat ekziston një sektor i veçantë, i cili merret vetëm me regjistrimin automatik të veprimeve. Përpunimi i mëtejshëm i të cilave bëhet në sektorin e kontabilitetit.

Kontabiliteti bëhet një instrument i rëndësishëm kontrolli për veprimtarinë e njësisë ekonomike, si nga pikpamja ekonomike ashtu edhe nga ajo financiare. Ai përdoret nga pronarët e fermës, administratorët e fermës, punëmarrësit, bankat dhe Institutet e kreditit, furnitorët dhe kreditorët e ndryshëm aktualë ose potencialë, shteti, etj.

Në funksion të përdoruesve të cilëve do t'iu shërbejnë informacionet kontabël dallojmë:

- **Kontabiliteti financiar** ka si objekt grumbullimin, regjistrimin dhe përpunimin e informacionit në lidhje me marrëdhëniet e njësisë me të tretët. Gjendja financiare, performanca dhe ndryshimet në gjendjen financiare.
- **Kontabiliteti i kostos.** Përcaktimi analitik i kostove, të ardhurave e rezultateve ekonomike që kanë të bëjnë me aktivitete, operacione, procese prodhimi dhe qendra përgjegjësie.
- **Kontabiliteti i drejtimit** grumbullon informacionin nga të dy llojet e mësipërme të kontabilitetit dhe e përpunon atë për nevojat e drejtuesve në vendimarrjen strategjike.

Mbajtja e kontabilitetit financiar është e detyrueshme për të gjitha kategoritë e njësive ekonomike.

Kuptimi i inventarizimit, fazat e kryerjes dhe llojet e inventarizimit.

Inventarizimi është tërësia e veprimeve të kërkimit, klasifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit që kanë si qëllim përcaktimin cilësor dhe sasior të të mirave në dispozicion dhe pronësi të fermës në një moment të caktuar. ***Pasuria është tërësia e kordinuar e burimeve ekonomike që ka ferma në pronësi të saj dhe që pritet të sjellin dobi në të ardhmen. Detyrimet e ndërmarrjes përfaqësojnë shumën të cilat do të shlyhen në të ardhmen duke përdorur pasurinë e saj.*** Pasuria neto përfaqësohet nga pasuria bruto e pakësuar me detyrimet në një moment të caktuar dhe është shumën në dispozicion të plotë të ndërmarrjes për zhvillimin e veprimtarisë së saj.

Procesi i inventarizimit kryhet nëpërmjet fazave të ndryshme që janë:

- **Kërkimi i elementeve që do të inventarizohen** synon të individualizojë elementët pasurorë dhe është një veprim që duhet të kryhet me shumë kujdes, sepse nuk duhet të lërë pa përfshirë asnjë element dhe të dallojë të mirat që janë në pronësi të njësisë nga ato që ndodhen pranë saj, por që u përkasin të tretëve. Identifikimi i përbërësve të ndryshëm të këtyre të mirave mund të kryhet më lehtë nëse ndërmarrja ka mbajtur një kontabilitet të rregullt, në të kundërt vështirësohen procedurat. Kërkimi dhe matja përfundojnë kur janë përcaktuar sasitë fiziko-teknike të të mirave të inventarizuara: pesha, kapaciteti, gjatësia, numri i elementeve përbërës etj. Ka disa lloje të mirash, të cilat nuk mund të inventarizohen, prandaj gjendja e tyre llogaritet duke u bazuar në regjistrimet kontabël.
- **Klasifikimi** synon të formojë grupe homogjene të mirash që kanë karakteristika të njëllajta merceologjike dhe funksionale. Për shembull, në një grup mund të përfshihen ndërtesat, në një tjetër paratë dhe kështu më radhë.
- **Përshkrimi** synon të saktësojë karakteristikat sasiore dhe cilësore jo monetare dhe përben një kusht të domosdoshëm për fazën e mëpasshme të vlerësimit. Përshkrimi duhet të jetë i qartë, por jo shumë i detajuar, aq sa të lejojë një njohje të mjaftueshme të këtyre të mirave dhe të japë informacionin e nevojshëm për to. Për shembull, për terrenet do të përcaktohet vendndodhja, sipërfaqja; për një ndërtesë vendndodhja, viti i ndërtimit, sipërfaqja, katet, etj.
- **Vlerësimi** synon shprehjen në para të karakteristikave sasiore dhe cilësore jomonetare të elementëve të inventarizuar. Elementëve të ndryshëm u caktohet një vlerë mbi bazën e kriterit më

të përshtkatshtëm për realizimin e qëllimit për të cilin kryhet inventarizimi. Kjo fazë është e domosdoshme, sepse vlerëson dhe përcakton tërë të mirat e fermës në të njëjtën njësi gjë që nuk mund të realizohet nëse ato janë të shprehura vetëm në natyrë. E njëjta e mirë mund të vlerësohet në mënyra të ndryshme sipas kohës, vendit, qëllimit dhe personit që kryen vlerësimin.

- **Paraqitja.** Me anë të këtij veprimi të dhënat që merren nga kërkimi, të klasifikuara, përshkruar dhe të vlerësuara përfshihen në një pasqyrë, që ka si qëllim të vërë në dukje rezultatet e veprimeve të inventarizimit.

Kuptimi i inventarit

Me inventar kuptojmë tërësinë e veprimeve nëpërmjet të cilave realizohet klasifikimi sistematik i elementëve pasurore të fermës, matja e tyre si dhe regjistrimi i tyre në sasi e në vlerë. Në inventar regjistrohen të gjitha elementët pasurore të fermës pavarësisht se janë pronë e fermës apo i të tretëve. Inventari pasqyron në mënyrë analitike gjendjen pasurore të fermës në një kohë të caktuar. Realizimi i inventarit përfshin dy veprime të ndryshme.

- përcaktimin, matjen dhe regjistrimin e të gjithë elementëve pasurore të fermës sipas llojit të tyre, në bazë të disa karakteristikave të përbashkëta që ka secila kategori, duke i shprehur në sasi (numër, m², m³, kg, kv etj.) dhe cilësi.

- përcaktimin e vlerës së këtyre elementëve pasurore për çdo lloj ose kategori të veçantë si dhe për fermën në tërësi.

Inventari i elementëve pasurore të fermës është hapi i parë për ndjekjen kontabël të fermës bujqësore. Kjo sepse nëpërmjet tij njihet gjendja e elementëve pasurore të fermës dhe veçanarisht sasi të faktike të disa prej faktorëve të prodhimit, që janë mese të domosdoshme për funksionimin normal të saj.

Inventari bashkë me vlerësimin shërbejnë si bazë për të llogaritur saktë rezultatit ekonomik të realizuar, sepse vetëm nëpërmjet tij bëhet e mundur llogaritja e amortizimit dhe e interesit të kapitalit të pandryshueshëm.

Llojet e inventarëve

Inventarët hartohen në moment dhe për qëllime të ndryshme, prandaj kanë formë, shtrirje dhe mënyra të ndryshme paraqitjeje.

Disa klasifikime të rëndësishme të inventarëve mund të jenë:

Sipas shtrirjes së objektit dallohen:

- **inventarë të përgjithshëm** që shtrihen në tërë të mirat e ndërmarrjes
- **pjesorë** që kanë të bëjnë vetëm me disa grupe prej tyre (për shembull inventari i magazinës, arkës, etj.)

Sipas qëllimit inventarët mund të klasifikohen në:

- **Inventari i krijimit.** Ka si qëllim të evidentojë të mirat me të cilat ndërmarrja fillon veprimtarinë e saj;
- **Inventari i funksionimit.** Evidenton të mirat në fund të çdo periudhe administrative dhe ka si qëllim të japë të dhëna për të matur rezultatit ekonomik që i takon asaj;
- **Inventari i tjetërsimit.** Ka si qëllim të evidentojë të mirat e ndërmarrjes në momentin e ndryshimit të subjektit juridik;
- **Inventari i likuidimit.** Ka si qëllim të evidentojë të mirat e ndërmarrjes në momentin e likuidimit të saj etj.

Sipas natyrës së të dhënave dallohen:

- Inventarët me sasi fizike;
- Inventarët në vlerë.

Sipas origjinës së të dhënave: sipas burimit nga i cili vijnë të dhënat dallohen inventarët:

- **Inventarë faktikë.** Bazohen në përcaktimin fizik të të mirave dhe matjen e sasive të tyre si kusht paraprak për vlerësimin e tyre;
- **Inventarë kontabël.** Marrin të dhënat nga regjistrimet e kryera në skeda, regjistra etj.;
- **Inventarë të përzier.** I marrin të dhëna si nga inventarët faktikë, ashtu edhe nga ata kontabël.

Inventarizimi faktik kryhet për ata elementë të të mirave që ekzistojnë fizikisht dhe që mund të inventarizohen, si për shembull: ndërtesat, makineritë, mallrat etj. Kurse, inventarizimi kontabël kryhet për ata elementë që nuk ekzistojnë fizikisht, si: paratë në bankë, debite, kreditet etj. Të dhënat e këtyre inventarizimeve pasqyrohen në inventarët e përzier;

Sipas përmbajtjes inventarët mund të jenë:

- **Analitikë,** ku elementët e ndryshëm përshkruhen në mënyrë të detajuar dhe analizohen deri në përbërësit e tyre të veçantë ;
- **Sintetikë,** ku elementët e ndryshëm paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i grupuar në kategori homogjene dhe duke treguar vlerat për çdo grup.

Zgjedhja e llojit të inventarit bëhet në përputhje me qëllimin e inventarizimit.

Pasuria dhe karakteristikat e saj.

Procesit të inventarizimit i nënshtrohet tërësia e të mirave me të cilat ndërmarrja zhvillon veprimtarinë e saj. Kjo tërësi të mirash, të koordinuara ndërmjet tyre dhe të vëzhguara në një moment të caktuar, përbën pasurinë e ndërmarrjes.

Pasuria, është tërësia e kordinuar e burimeve ekonomike, që ferma ka në pronësi të saj dhe që pritet të sjellin dobi në të ardhmen. Në përcaktimin e madhësisë së pasurisë së ndërmarrjes duhet t'i referohemi një moment të caktuar, sepse ajo është në ndryshim të vazhdueshëm i cili shkaktohet nga veprimet e shumta ekonomike. Pra, që një burim ekonomik të bëjë pjesë në pasurinë e ndërmarrjes duhet që ai të plotësojë dy kushte :

- të jetë në pronësi të ndërmarrjes;
- të ketë aftësi të sigurojë dobi në të ardhmen.

Gjithashtu, ai duhet të jetë dhe i matshëm. Për shembull, aftësia drejtuese e presidentit të shoqërisë nuk është e matshme, megjithëse mund të sjellë dobi në të ardhmen. Kjo cilësi nuk përbën element pasuror. Elementët pasurorë mund të ekzistojnë në formë fizike, si për shembull: makineritë, mallrat, ndërtesat, ose në formë të paprekshme, si: patentat, të drejtat e autorit, të drejtat për të arkëtuar para nga mallrat ose produktet e shitura etj.

Kuptimi i detyrimeve.

Inventarizimi nuk kufizohet vetëm në përcaktimin e pasurisë dhe të elementëve të saj, por jep edhe gjendjen e detyrimeve që ka ndërmarrja në momentin e kryerjes së tij. Karakteristikë e detyrimeve është se kanë lindur nga ngjarje të shkuara. Shlyerja e tyre do të shoqërohet me daljen e burimeve (përdorimin e pasurisë) në të ardhmen. Prandaj, në inventar evidentohen veç pasurisë së ndërmarrjes dhe detyrimet që ajo ka në momentin e kryerjes së tij. **Detyrimet e ndërmarrjes përfaqësojnë shumën, të cilat ajo do t'i shlyejë në të ardhmen, duke përdorur pasurinë e saj.**

Kuptimi i pasurisë neto dhe dallimi i saj nga ajo bruto. Pasuria neto përfaqësohet nga pasuria bruto e pakësuar me detyrimet në një moment të caktuar dhe është shumën në dispozicion të plotë të ndërmarrjes për zhvillimin e veprimtarisë së saj. **Pasuria Neto = Pasuri Bruto - Detyrime**

Bilanci, paraqitja e elementëve pasurorë, detyrimeve dhe kapitalit të vet.

Bilanci është një pasqyrë financiare në të cilën paraqitet pasuria e fermës, çfarë ajo zotëron dhe çfarë ka marrë hua në një moment të caktuar. Ai përmban rezultatet ekonomiko-pasurore të administrimit si dhe aftësitë paguese të fermës në një moment të caktuar.

Dallimet e bilancit nga inventari janë:

- Në inventar të dhënat paraqiten të renditura njëra pas tjetrës pa ndarje dhe klasifikime midis tyre, sepse qëllimi i inventarit është evidentimi i gjendjeve që dalin nga inventarizimi. Kurse në bilanc, të dhënat paraqiten të ndara në seksione dhe të grupuara, sepse qëllimi i bilancit është dhënia e informacionit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të fermës;
 - Të dhënat e inventarit janë rezultat i një sërë procesesh që përbëjnë inventarizimin, kurse të dhënat e bilancit merren nga një sërë regjistrimesh dhe pasqyrash kontabël që do t'i trajtojmë në vijim.
- Ana e majtë e bilancit quhet **Aktiv**, ana e djathtë **Pasiv** dhe **Kapitali i vet**.

A) Aktivi i bilancit klasifikohet në dy grupe të mëdha: **Aktivet afatshkurtra** ose qarkulluese quhen të gjitha ato aktive të cilat e japin dobinë e tyre brenda një periudhe të shkurtër. Edhe elementët që përbëjnë aktivin qarkullues grupohen sipas karakteristikave të përbashkëta në disa grupe që janë:

- **Paratë në llogari rrjedhëse ose në arkë.**
- **Gjendje e inventarit.** Këtu futen materialet, lëndët e para, ndihmëse, produktet e ndërmjetme dhe të gatshme, mallrat që ndodhen gjendje në ndërmarrje në momentin e hartimit të bilancit.
- **Kërkesat e arkëtueshme.** Këtu futen klientët, debitorët e ndryshëm, zotimet e ortakëve për të derdhur kapital në shoqëri, etj.
- **Letrat me vlerë.** Këtu futen vlerat e kambialeve që ndërmarrja do të arkëtojë.

B) Aktive afatgjata janë ato aktive që e japin dobinë e tyre dhe qëndrojnë në ndërmarrje për disa vite me rradhë.

Elementët që bëjnë pjesë në aktivet afatgjata grupohen në disa nëndarje sipas karakteristikave të përbashkëta që kanë. Këto nëngrupe janë:

- **Aktive afatgjata material (AAM).** Këtu futen terrenet, ndërtesat, instalimet, makineritë, mjetet e transportit etj. Karakteristikë e përbashkët e tyre është se ato janë të materializuara në një formë të caktuar dhe se përbëjnë strukturën tekniko-prodhuese ose skeletin e ndërmarrjes, pa të cilin ajo nuk mund të ushtrijë veprimtarinë e saj.
- **Aktive afatgjata jomateriale(AAJM).** Këtu futen koncensionet, patentat, licencat, markat etj. Karakteristikë e tyre është se ato nuk kanë një formë të caktuar materiale, por paraqiten në formën e vlerave ose të të drejtave pasurore që janë në pronësi të ndërmarrjes dhe japin dobi në të ardhmen.
- **Aktive afatgjata financiare.** Këtu futen hua të dhëna të tretëve nga ndërmarrja, aksione dhe obligacione të ndërmarrjeve të tjera etj. Karakteristikë e përbashkët e këtyre aktiveve është se ato përfaqësohen nga para përkohësisht të tepërta të investuara me afat të mesëm ose të gjatë në aktivitet, por që nuk përbëjnë veprimtarinë kryesore të ndërmarrjes.

Ana e djathtë e bilancit klasifikohet në dy grupe të mëdha:

Kapitali i vet që përfaqëson financime të brendshme të pasurisë së fermës.

- **Kapitali i derdhur** përfaqëson kapitalin e derdhur ose të sjellë nga ortakë në fermë ose nga pronari;
- **Fondet rezervë** janë fonde që krijohen duke veçuar në to një pjesë të fitimit të realizuar për ta përdorur në fermë për qëllime të caktuara në të ardhmen kur ajo të ketë nevojë për to, sepse mund të ndodhë që të mos ketë realizuar fitime.

- *Fitimet ose humbjet e pashpërndara* përfaqësohen nga rezultate të periudhave të kaluara, të cilat nuk janë përdorur.
- *Fitime ose humbje të ushtrimit.* Fitimet ndikojnë pozitivisht në kapitalin e vet duke e rritur atë, kurse humbjet ndikojnë negativisht.

Detyrimet (kapitali i tretëve) klasifikohen në dy grupe të mëdha:

- *Ma afat të gjatë* që kanë një afat shlyerjeje mbi një vit si: bankat ose institutet e kreditit, huatë obligacioniste etj.
- *Me afat të shkurtër* kanë afat shlyerjeje nën një vit si: kërkesat për tu paguar, letrat me vlerë, detyrimet ndaj punonjësve, detyrimet ndaj shtetit për tatimet, etj.

Ligji për kontabilitetin përmban udhëzime mbi përmbajtjen dhe formën e bilancit. Sipas këtij ligji, bilanci paraqitet si më poshtë: (në bilanc shifrat e vendosura janë të supozuara dhe nuk i përkasin një bilanci real, por janë të vendosura për të sqaruar mënyrën se si paraqiten gjendjet e elementeve pasurore dhe të kapitalit në një moment të caktuar).

Bilanci i ndërrmarrjes më datë: _____

NR	PASURIA	SHUMA	NR	PASIVET DHE KAPITALI I VET	SHUMA
A	AKTIVET AFATSHKURTRA		A	PASIVET AFATSHKURTRA	
I	Mjete monetare	100 000	I	Hua dhe obligacione afatshkurtra	
	1. Para në arkë	1 300 000		1. Hua të marra nga bankat	1 500 000
	2. Para në llogarinë rrjedhëse			2. Bono dhe obligacione	200 000
	Totali i mjete monetare	1 400 000			
II	Aktive financiare afatshkurtra		II	Llogari të pagueshme	
	1. Llogari të arkëtueshme			1. Furnitorë	900 000
	- Klientë	700 000		2. Kreditorë	410 000
	- Debitorë	120 000		3. Detyrimen daj personelit	220 000
	2. Letra me vlerë			4. Detyrime tatimore	355 000
	- Efekte për tu arkëtuar	220 000			
	Totali i akt.fin.afatshkurtra	1 040 000		Totali i pasiveve afatshkurtra	3 585 000
III	Inventari		B	PASIVET AFATGJATA	
	1. Lëndë të para	20 000	I	Hua afatgjatë	4 000 000
	2. Prodhime në process	12 000	II	Obligacione dhe tituj afatgjatë	2 000 000
	3. Produkte të gatshme	103 000		Totali i pasiveve afatgjata	6 000 000
	4. Mallra për rishitje	400 000		TOTALI I PASIVEVE	9 585 000
	Totali i inventarit	535 000		KAPITALI I VET	
	Totali i aktivet afatshkurtra	2 975 000	I	Kapital i derdhur	11 000 000
B	AKTIVET AFATGJATA		II	Rezervat	
I	Investimet financiare afatgjata			1. Rezervat ligjore	10 000
	- 1. Aksione e letra me vlerë	500 000		2. Rezervat statutore	8 000
	- 2. Kërkesa të arkëtueshme (hua të dhëna) afatgjata.	450 000		3. Rezerva të tjera	2 000
	Totali invest. financ. afatgjata.	950 000	III	Fitimet e pashpërndara	40 000
	- Aktive afatgjata materiale		IV	Fitimi i periudhës	90 000

II	1. Toka	3 000 000	Totali i kapitalit të vet	11 150 000
	2. Ndërtesa	12 000 000		
	3. Makineri e paisje	1 600 000		
	Totali aktive afatgj. materiale	16 600 000	TOTALI I PASIVEVE DHE I KAPITALIT TË VET	20 735 000
III	Aktive afatgjata jo materiale			
	1. Shpenzime zhvillimi	20 000		
	2. Patenta	70 000		
	3. liçenca	120 000		
	Totali aktiv afatgj. jomateriale	210 000		
	Aktivitet totale afatgjata	17 760 000		
	TOTALI I AKTIVEVE	20 735 000		

Njohja e gjendjes së aftësisë paguese ka shumë rëndësi për ndërmarrjen, sepse paaftësia paguese e përsëritur çon në refuzimin gjithnjë e më shumë nga ana e kreditorëve për t'i dhënë kredi. Kjo mund të çojë deri në falimentimin e saj, sepse do të jetë e detyruar të shesë elementët pasurore të domosdoshëm të strukturës prodhuese për të shlyer borxhet dhe si pasojë nuk do të ushtroje veprimtarinë e saj.

Tema 24. Pasqyrimi kronologjik i veprimeve ekonomike bujqësore

Duke u bazuar në natyrën e ndryshimeve që shkaktojnë në bilanc transaksionet e ndryshme financiare klasifikohen në katër grupe të mëdha:

- *Transaksione që shkaktojnë ndryshime brendapërbrenda aktivitetit.*
- *Transaksione që shkaktojnë ndryshime në shtim të një ose disa zërave të aktivitetit, njëkohësisht me shtimin e një ose disa zërave të pasivitetit.*
- *Transaksione, që shkaktojnë ndryshime në pakësimin të një ose disa zërave të aktivitetit, njëkohësisht me pakësimin e një ose disa zërave të pasivitetit.*
- *Transaksione që shkaktojnë ndryshime brendapërbrenda pasivitetit.*

Për të pasqyruar lëvizjet e shkaktuara nga tërë veprimet ekonomike kontabiliteti përdor konceptin e llogarisë. **Llogaria** është thjesht një vend, mjet ose pasqyrë ku përmbledhen tërë veprimet që prekin një element të caktuar të pasurisë, kapitalit ose detyrimeve.


Elementët e llogarive

- Titulli i llogarisë është emri i elementit pasuror ose të kapitalit, lëvizjet e të cilit pasqyrohen kjo llogari.
- Vendi ku rregjistrohen rritjet të shprehura në para.
- Vendi ku rregjistrohen pakësimet të shprehura në para.

Forma më e thjeshtë e llogarisë quhet “llogari në formë T-je”. Llogaria përmban dy anë: në njërin pasqyrohen shtesat e zërit të aktivitetit apo të pasivitetit, emrin e të cilëve mban llogaria dhe në tjetrën pakësimet.

Terminologji lidhur me llogaritë

- Ana e majtë e llogarive, pavarësisht nga lloji i tyre quhet “**DEBI**”.
- Ana e djathtë e llogarive pavarësisht nga lloji i tyre quhet “**KREDI**”.



- Të çelësh një llogari, do të thotë ta emërtosh atë dhe të vendosësh në të gjendjen fillestare që merret nga bilanci, e cila mund të quhet “tepricë fillestare”.
 - “**Të mbash**” një llogari do të thotë të regjistrohësh në të veprimet që prekin zërin emrin e të cilit mban llogaria;
 - “**Të mbyllësh**” një llogari do të thotë të gjesh gjendjen ose tepricën përfundimtare të saj.
 - “**Të debitosh**” një llogari do të thotë të regjistrohësh një shumë në debi të saj.
 - “**Të kreditosh**” një llogari do të thotë të regjistrohësh një shumë në kredi të saj.
- Paraqitja në formë T-je është forma më e thjeshtë e paraqitjes së llogarive.

Funksionimi i llogarive aktive dhe pasive.

Për të regjistruar një rritje në llogaritë aktive do të përdorim anën e majtë ose debitin. Meqenëse pakësimet kanë shenjë të kundërt, në llogaritë aktive ato do të pasqyrohen në anën e djathtë ose në kredi. Skematikisht funksionimin e llogarive mund ta paraqesim:

DEBI	Llogaritë aktive	KREDI
Gjendja fillestare Shtesat		Pakësimet

a) Funksionimi i llogarive pasive

Çdo transaksion financiar shkakton ndryshime të njëkohëshme në të paktën dy elementë të pasurisë ose të kapitalit për të njëjtat shuma. Për shembull, nëse një element pasuror shtohet, që të ruhet ekuacioni i bilancit, duhet që të ndodhë edhe një nga ndryshimet e mëposhtme:

- Një element tjetër pasuror (aktiv) të pakësohet;
- Borxhi (pasiv) të shtohet;
- Kapitali vetjak të shtohet.

Pasivet dhe kapitali vetjak ndodhen në anë të kundërt me aktivet në ekuacionin e bilancit. Prandaj nëse shtesat e aktiveve pasqyrohen në debitin e llogarive përkatëse, shtesat e pasiveve dhe të kapitalit vetjak do të pasqyrohen në të kundërt të tyre, që do të thotë në kredi. Po kështu, nëse pakësimet në llogaritë aktive pasqyrohen në kredi, në llogaritë pasive dhe në ato të kapitalit vetjak, ato do të pasqyrohen në debi. Vetëm kështu mund të ruhet barazimi i ekuacionit të bilancit, gjë që duket edhe më poshtë:

Funksionimi i llogarive pasive dhe kapitalit vetjak mund të paraqitet:

DEBI	Pasivi dhe kapitali vetjak	KREDI
Pakësimet		Gjendja fillestare Shtesat

Qëllimi i llogarive është pasqyrimi i ndryshimeve që shkaktojnë veprimet ekonomike në gjendjen e elementëve të pasurisë dhe të kapitalit. Qëllimi i mbajtjes së llogarive është dhënia e informacionit mbi gjendjen e elementëve të veçantë të pasurisë dhe të kapitalit. Për këtë duhet të mbahet parasysh

si gjendja fillestare ashtu dhe ndryshimet e regjistruara në llogari. Për të përcaktuar gjendjen përfundimtare të llogarisë veprohet si më poshtë:

- Mblidhen shumat e regjistruara në debi (teprica+ lëvizje)
- Mblidhen shumat e regjistruara në kredi (teprica+ lëvizje)
- Llogaritet diferenca midis debisë dhe kredisë që përfaqëson tepricën ose gjendjen përfundimtare të zërit, emrin e të cilit mban llogaria.

Veprimet e përcaktimit të tepricës përfundimtare quhen veprime të mbylljes së llogarive.

Parimi i regjistrimi i dyfishtë.

Çdo veprim ekonomik shkakton ndryshime të dyanshme në debi të një ose më shumë llogarive dhe në kredi të një ose më shumë llogarive të tjera për të njëjtën vlerë. Vetëm duke respektuar këtë ligj ruhet barazimi i ekuacionit të bilancit dhe ekuilibri pasuror: Investime= Financime.

Dokumentat që vërtetojnë kryerjen e veprimit ekonomik janë:

- *Dokumenta autorizues*, janë dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar.
 - *Dokumenta justifikues*, dokumenta që tregojnë kryerjen e një veprimi të caktuar i cili shkakton dhe efektet përkatëse në gjendjen pasurore dhe financiare të njësisë ekonomike.
- Të gjitha llogaritë mblidhen në një libër të përgjithshme që quhet “Libri i madh” ku secila prej tyre ka një faqe më vete. *Mbartja është procesi i transferimit të shumave nga “Ditari” në “Librin e madh”.*

Ditari përmban:

- Datën e kryerjes së veprimit.
- Përshkrimi - Emërtimin e llogarive
- Referencën
- Kolonat e shumave debi, kredi.

Data	Përshkrimi i veprimit	Referimi	Shumat në debi	Shumat në kredi

- Në kolonën e parë shënohet për çdo regjistrim data në të cilën kryhet ai;
- Në kolonën e përshkrimit shënohen në të majtë emrat e llogarisë ose llogarive që debitohen dhe në të djathtë emrat e llogarisë ose llogarive që kreditohen, si dhe kryhet një përshkrim i shkurtër me fjalë i veprimit, ku shënohen dhe ekstremet (numri dhe data) e dokumentit origjinal që i vërteton;
- Në kolonën e emëruar “Referimi” shënohet numri që ka në “Librin e madh” llogaria ku do të kryhen mbartjet e regjistrimeve nga “Ditari”. Kjo kolonë nuk plotësohet në momentin kur kryhet regjistrimi në ditar, por në momentin që bëhet mbartja në “Librin e madh”. Plotësimi i kësaj kolone lehtëson kontrollin e mbartjeve dhe evidentimin e gabimeve të mundshme.
- Në kolonën “Shumat në debi” paraqiten shumat që regjistrohen në debi të llogarive;
- Në kolonën “Shumat në kredi” paraqiten shumat që regjistrohen në kredi të llogarive;

Sipas ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ferma është e detyruar të mbajë një ditar, ku të paraqiten dhe të përmbledhen tërë veprimet e saj gjatë periudhës ushtrimore. Ky quhet “Ditari Centralizator”.Mbartja e “Ditarit” dhe e “Librit të madh” janë të detyrueshme me ligj, pavarësisht nga forma në të cilën mbahen. Ferma përveç centralizatorit mban edhe ditarë të veçantë që kanë shumë lëvizje që quhen “Ditarë analitikë”si:“Ditari analitik i hyrjeve të arkës”, “Ditarë analitik i

daljeve të arkës”, “Ditarë analitik i hyrjeve të magazinës”, “Ditarë analitik i daljeve të magazinës”. Mbajtja e ditarëve analitikë janë të detyrueshme me ligj dhe shërbejnë për kontrollin e saktësisë së kryerjes së regjistrimeve kontabël.

Regjistrimi i veprimeve në ditar bëhet nëpërmjet **artikujve kontabël** që hartohen në ditar dhe janë disa llojesh.

- Artikull i thjeshtë.
- Artikull i përbërë.
- Artikull kompleks.

Hapat që ndiqen në regjistrimin e veprimeve ekonomike, përpunimin dhe hartimin e raporteve financiare të cilët së bashku përbëjnë atë që quhet **“cikël kontabël”** janë:

- Regjistrimi kronologjik i veprimeve;
- Regjistrimi sistematik i veprimeve;
- Kontrolli i kryerjes së regjistrimeve dhe evidentimi i gabimeve;
- Korrigjimi i gabimeve duke kryer regjistrimet përkatëse kronologjike dhe sistematike;
- Kontrolli i kryerjes së korrigjimeve;
- Krahasimi i gjendjes faktike(inventarit) me atë kontabël dhe sistemimi i diferencave;
- Hartimi i bilancit;

Për të realizuar ciklin kontabël, sistemi ka disa përbërës bazë që janë:

- Plani i llogarive;
- Sistemi i kodimit të llogarive;
- Ditari centralizator;
- Libri i madh;
- Partitarët;
- Ditarët analitikë;
- Kontrolli i brendshëm;
- Kontrolli i jashtëm;

Hapat që ndiqen në procesin e mbartjes janë:

- Lokalizimi në Librin e Madh i llogarisë së përmendur në anën e majtë të kolonës përshkrimi, llogari kjo që debitohet;
- Regjistrimi i datës së veprimit në llogarinë përkatëse të Librit të Madh;
- Hedhja e shumës nga ditari në debi të llogarisë;
- Regjistrimi në llogari i numrit të faqes së ditarit ku është regjistruar veprimi, duke e shënuar në kolonën: “ Referimi” të llogarisë;
- Regjistrimi i numrit të llogarisë ku është regjistruar veprimi në kolonën “Referimi” të ditarit në rreshtin ku është shënuar emri dhe shuma e llogarisë;
- Të gjitha këto hapa përsëriten edhe për llogarinë që kreditohet.

Plani i përgjithshëm i llogarive

Ligji për kontabilitetin parashikon tërë llogaritë që mund të përdoren nga ferma për regjistrimin e veprimtarisë së tyre. Tërësia e këtyre llogarive përfaqëson atë që quhet **“Plani kontabël i përgjithshëm”**.

Kontrolli i regjistrimeve dhe evidentimi i gabimeve. Bilanci verifikues

Pasi është bërë regjistrimi i veprimeve në llogaritë e Librit të Madh kryhet kontrolli i brendshëm i tyre nëpërmjet hartimit të një bilanci verifikues. **Bilanci verifikues** është një pasqyrë ku paraqiten njëra pas tjetrës tërë llogaritë e bilancit, pavarësisht nëse kanë pasur ose jo lëvizje. Për secilën llogari

paraqiten në kolona të veçanta lëvizjet e mundshme debitore ose kreditore dhe tepricat përfundimtare debitore ose kreditore.

Forma e bilancit verifikues është:

Nr	Llogaritë aktive ose pasive	Lëvizjet debitore	Lëvizjet kreditore	Teprica përfundimtare debitore	Teprica përfundimtare kreditore
1	Tokë				
2	Ndërtesa				
3	Mallra				
4	Llogari rrjedhëse bankare				
5				
6	Kapital i derdhur				
7	furnitorë				
8				

Regjistrimet kontabël janë kryer në rregull kur verifikohen barazimet e mëposhtme:

- Shuma e lëvizjeve debitore = shuma e lëvizjeve kreditore = shumat e ditarit. Ky barazim tregon se rregulli i përgjithshëm i regjistrimit të dyfishtë është zbatuar siç duhet, se tërë veprimet janë mbartur saktësisht nga ditari në llogari.
- Shuma e tepricave përfundimtare debitore = shumën e tepricave përfundimtare kreditore.

Nëse ndonjëri prej këtyre barazimeve nuk verifikohet, kjo tregon se diku është bërë ndonjë gabim.

E rëndësishme është që ky gabim të evidentohet dhe të korrigjohet. Për të evidentuar gabimet fillimisht kryhen disa kontrole aritmetike. Bëhet diferenca midis shumës së lëvizjeve debitore dhe shumës së lëvizjeve kreditore. Shpesh, kjo diferencë ndihmon në lokalizimin e gabimit. Nëse nga kjo diferencë nuk evidentohet gabimi, atëherë bëhen kontrollet e mëposhtme:

- Kontrollohen mbledhjet në bilancin verifikues;
- Kontrollohen mbartjet nga Libri i madh në bilancin verifikues;
- Rillogariten tepricat e llogarive;
- Kontrollohen mbartjet nga Ditari në Librin e madh;
- Analizohet regjistrimi në ditar nga dokumenti fillestar për të kontrolluar nëse ai është kryer në rregull.

Ky barazim tregon se janë llogaritur saktë tepricat (gjendjet) përfundimtare të llogarive.

Nëse ndonjëri prej këtyre barazimeve nuk verifikohet, kjo tregon se diku është bërë ndonjë gabim. E rëndësishme është që ky gabim të evidentohet dhe të korrigjohet.

Korrigjimi i gabimeve

Në regjistrat kontabël nuk lejohet asnjë korrigjim ose fshirje shifrash për të mos lënë vend për abuzime. Prandaj, korrigjimi kryhet duke hartuar artikuj të rinj kontabël në ditar të cilët më pas mbarten në llogari. Zakonisht, për të korrigjuar një artikull të gabuar hartohen dy artikuj të tjerë kontabël:

- **Artikulli stornues**, që ka si qëllim të anulojë artikullin e gabuar. Ky mund të jetë i njëjtë me artikullin e gabuar, por shumat shënohen me ngjyrë të kuqe ose të futura në një kuadrat. Regjistrimi i shifrave në këtë mënyrë do të thotë se kur të mblidhen shumat në ditar apo në llogari, këto do të zbriten nga të tjerat. Ky mund të jetë dhe artikulli i kundërt me artikullin e gabuar;

- **Artikulli i drejtë**, që pasqyron veprimin siç tregohet në dokument.

Mbyllja e veprimeve të periudhës kryhet nëpërmjet një artikulli kontabël me anë të të cilit kreditohen llogaritë aktive dhe debitohen llogaritë pasive për tepricat përkatëse. Vetëm pasi ndiqen tërë këto procedura mund të kalohet në hartimin e bilancit të periudhës.

Shembull:

Veprimi: kalohen para nga arka në bankë 500 000 lekë. Gabimisht është regjistruar:

Data	Përshkrimi	Referimi	Shumat në debi	Shumat në kredi
	Llogari rrjedhëse bankare		500 000	
	Te			
	Arka			50 000
	Për xhirimin e parave në bankë			

Pra, gabimisht në shifrën e regjistruar në kredi të llogarisë “Arka” është harruar një zero. Meqë, kjo ka çenuar zbatimin korrekt të rregullit të regjistrimit të dyfishtë, kolonat 3,4,5 të bilancit verifikues nuk barazohen. Pasi kryhet kontrolli evidentohet gabimi. Artikulli stornues është:

Data	Përshkrimi	Referimi	Shumat në debi	Shumat në kredi
	Llogari rrjedhëse bankare		500 000	
	Te			
	Arka			50 000
	Ose Arka		50 000	
	Te			
	Llogari rrjedhëse bankare			500 000
	Për korigjimin e gabimit			

Dhe artikulli i drejtë që kryhet është:

Data	Përshkrimi	Referimi	Shumat në debi	Shumat në kredi
	Llogari rrjedhëse bankare		500 000	
	Te			
	Arka			500 000
	Për xhirimin e parave në bankë			

Për të hartuar bilancin e periudhës për të tëra llogaritë e Librit të madh (jo ato analitike) gjenden lëvizjet debitore kreditore dhe tepricat (gjendjet) përfundimtare debitore ose kreditore të tyre. Tepricat e tyre pasqyrohen në bilanc. Më pas duhet të bëhet mbyllja e përgjithshme e veprimeve të periudhës. Kjo realizohet duke hartuar një artikull kontabël që quhet “artikulli i mbylljes, i cili mbartet dhe në llogari. Ai është artikulli i kundërt me atë të çeljes me anë të të cilit llogaritë aktive kreditohen dhe llogaritë pasive debitohen për tepricat përkatëse dhe në këtë mënyrë të tëra këto llogari mbyllen. Artikulli i mbylljes ka formën:

Data	Përshkrimi	Referimi	Shumat në debi	Shumat në kredi
------	------------	----------	----------------	-----------------

	Kapital i derdhur Fitime ose humbje të pashpërndara Fitime ose humbje të ushtrimit			
	Hua nga bankat Furnitorë Kreditorë Efekte për tu paguar Terrene Ndërtesa Obligacione Kredi bankare Materiale Klientë Efekte për të paguar Arka Llogari rrjedhëse			

Tema 25. Llogaritë e rezultatit dhe llogaritë e mallrave

Shpenzimet janë kostot e të mirave të shitura nga ndërmarrja ose të shërbimeve të kryera prej saj gjatë procesit të realizimit të të ardhurave. Shpenzimet e kryera nga ferma janë të shumëllojshme. Për t'i përcaktuar, studiuar, evidentuar dhe interpretuar sa më mirë, ato klasifikohen në disa grupe të mëdha që janë:

- **Shpenzime të mallrave, lëndëve të para e shërbimeve të konsumuara për ushtrimin e veprimtarive kryesore (prodhimi, shitja).** Këto shpenzime për peshën dhe rëndësinë që kanë trajtohen në vazhdim;
- **Shpenzimet e personelit.** Këtu futen rrogat, pagat, shtesat mbi pagat, detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore, shpenzimet e kualifikimit të personelit etj;
- **Shpenzimet e tjera dytësore që lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë.** Këtu përfshihen kostot e shërbimeve të blera për qëllime administrative ose dhe të tjera, si për shembull: për ngrohje, magazinim pranë të tretëve, kancelari a ndriçim energji elektirke, ruajtje, konsulencë, abonimet në shtyp, reklamë, PTT, prime të sigurimit, mirëmbajtje etj;
- **Shpenzimet e rënies në vlerë të aktiveve të qëndrueshme,** domethënë të atyre elementëve të pasurisë që e japin dobinë për shumë vite dhe përdoren në shumë cikle prodhuese.
- **Shpenzimet financiare** janë shpenzime, që kryhen për të siguruar financime me afat të shkurtër, të mesëm e të gjatë. Këto përfaqësohen nga interesa passive për kredinë në llogari rrjedhëse, interest që u paguhen furnitorëve, interesat pasive mbi obligacionet dhe interesa të tjera, shpenzimet nga ndryshimet e kurseve të këmbimit;
- **Shpenzime fiskale,** që janë shpenzimet për taksat dhe tatimet që paguan ndërmarrja siç janë: TVSH, tatimet mbi veprimtarinë dhe prodhimin, tatimet mbi fitimin dhe tatime të tjera të veçanta.

Të ardhurat janë shumatat që realizon ndërmarrja nga shitja e mallrave, produkteve ose shërbimeve që ajo prodhon ose tregton.

Edhe të ardhurat klasifikohen në funksion të llogaritjes dhe evidentimit më të qartë të tyre në:

- **Të ardhura nga shitjet**, të cilat realizohen nga shitja e mallrave, produkteve dhe shërbimeve gjatë periudhës. Këto të ardhura do të trajtohen më hollësisht në kërkesat e ardhshme;
- **Të ardhura financiare**, që janë të ardhurat e realizuara nga financimet me afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë të kryera ndaj të tretëve. Këtu futen interesat aktive në llogari rrjedhëse, interes që u merren klientëve, interes aktive mbi titujt, të ardhurat nga ndryshimet e kurseve të këmbimit, dividendë të përfituar, qira aktive etj.
- **Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata të bilancit**, kur ato shiten me çmim më të lartë se vlera e mbetur e tyre.

Klasifikimet e mësipërme të shpenzimeve dhe të ardhurave përputhen me ato të parashikuara nga ligji “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” si dhe nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të). Zbatimi i ligjit dhe i standardeve janë të detyrueshme për të gjitha ndërmarrjes në funksion të respektimit të kërkesave të saktësisë dhe qartësisë së pasqyrave kontabël.

Rezultati i fermës. Për të realizuar qëllimin e veprimtarisë së saj, ferma synon që shuma e të ardhurave të jetë më e madhe se shuma e shpenzimeve që kryen për të realizuar këto të ardhura. Pra fitimi është diferenca midis të ardhurave me shpenzimet. **Të ardhura – Shpenzime = Fitimi**
Fitimi përfaqëson një pasuri të krijuar rishtazi dhe jo ndryshim të formës së pasurisë që ekzistonte më parë. Nëse diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve është negative ferma realizon humbje.

Fitimi rrit kapitalin e vet të fermës. Kur të ardhurat janë të barabarta me shpenzimet, atëherë ferma rivendos pasurinë e harxhuar dhe kur janë më të mëdha, pasuria e fermës, rritet duke u bërë më e madhe nga sa ishte para kryerjes së këtyre veprimeve.

- **Funksionimi i llogarive të të ardhurave.** Llogaria e të ardhurave është paraqitur si pjesë e kreditimit të llogarisë së kapitalit vetjak.

Në pasqyrën e mëposhtme, llogaria e të ardhurave është paraqitur si pjesë e kreditimit të llogarisë së kapitalit vetjak:

D KAPITALI VETJAK K	
DEBI (Pakësimet)	KREDI (Shtesa)
	D Të ardhura K
	DEBI (Pakësimet) KREDI (Shtesa)

- **Funksionimi i llogarive të shpenzimeve.** Llogaria e shpenzimeve paraqitet si pjesë e debitit të llogarisë së kapitalit vetjak.

D KAPITALI VETJAK K	
	DEBI (Pakësimet) KREDI (Shtesa)
D Shpenzime K	
DEBI (Pakësimet)	KREDI (Shtesa)

Gjendja fillestare
Gjendja përfundimtare

Xhirimi i gjendjes fillestare _____



Metoda e përshkruar më sipër për evidentimin e blerjeve, shitjeve dhe gjendjeve quhet **metoda e inventarit periodik**. Kjo metodë përdoret në ndërmarrje, ferma dhe njësi tregtare, të cilat kanë një shumëllojshmëri mallrash dhe lëvizje të shpeshta të tyre. Përveç metodës së inventarit periodik ekziston edhe një metodë tjetër e evidentimit kontabël të blerjeve, shitjeve, gjendjeve dhe ndikimit që ato kanë në rezultat. Kjo quhet **metoda e inventarit të vazhdueshëm**. Edhe kur përdoret kjo metodë, llogaritë e shpenzimeve të blerjes dhe të ardhurave nga shitja funksionojnë njëllëj.

Tema 26. Tatimi mbi vlerën e shtuar

Tatimi mbi vlerën e shtuar është tatim mbi konsumin. Vlera e shtuar përfaqëson vlerën e krijuar rishtazi nga puna dhe kapitali. Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH), paguajnë të gjithë personat fizike e juridike, të cilët nga veprimtaria e tyre ekonomike realizojnë një xhiro, aktualisht jo më të vogël se 5 milionë lekë në vit. Nuk paguajnë TVSH vetëm ata persona fizikë ose juridike që zhvillojnë veprimtari ekonomike në sektorin e shërbimeve financiare, shërbimeve postare, organizatat jofitimprurëse, dhënia me qera e tokës për një periudhë mbi 2 muaj etj. Për të nxitur eksportet, shteti shqiptar ka përjashtuar me ligj TVSH për to. Për të llogaritur dhe dokumentuar TVSH si dokument justifikues shërben fatura tatimore, e cila në çdo rast plotësohet nga shitësi i mallit. Fatura përpilohet në dy kopje, ku origjinali i dërgohet blerësit dhe shërben si dokument bazë për të justifikuar shumën e TVSH-së të zbritshëm. Kopja e dytë mbahet nga shitësi, mbi bazën e të cilës ai llogarit dhe pasqyron TVSH-në e pagueshme, i cili aktualisht është 20% dhe quhet shkalla tatimore. Për eksportet nuk paguhet TVSH pra është 0%. Kjo përqindje zbatohet dhe në blerjet, gjithmonë mbi vlerën e tatueshme të mallrave ose të shërbimeve të furnizuara. TVSH-ja zbatohet në çastin e lëshimit të faturës.

Zbatimi i TVSH-së ka disa përparësi:

- Ul inflacionin
- Ndihmon eksportet
- Ndimon investimet
- Është e thjeshtë për tu zbatuar.

Regjistrimi i TVSH për shitjet bëhet në kredi të llogarisë “Shteti TVSH”. Detyrimi ndaj shtetit nga tatimi i llogaritur në masën 20% mbi vlerën e mallrave të shitura dhe klientit i detyrohen fermës, jo vetëm për vlerën e mallit, por edhe atë të TVSH-së përkatëse.

Regjistrimi kontabël bëhet në artikullin kontabël:

Referimi	Përshkrimi i veprimit	Shume debi	Shuma kredi
	Klientë	XXXXXX	
	Te		
	Shitje mallrash		XXXXXX
	Shteti TVSH		XXXX
	Rregjistrohet shitja e mallrave sipas faturës së ndërmarrjes Nr ___ datë ___		


Regjistrimi i TVSH për blerjet. Kur ndërmarrja kryen një blerje, fatura e emetuar nga furnitori,

përmban TVSH-në e cila regjistrohet edhe nga ndërmarrja. TVSH-ja e llogaritur mbi çmimin e mallrave të blerë i zbritet detyrimit të ndërmarrjes ose e thënë ndryshe përfaqëson pakësim të këtij detyrimi.

Regjistrimi kontabël i faturës së furnitorit (i blerjes që ajo vërteton) bëhet me artikullin kontabël:

Referimi	Përshkrimi i veprimit	Shume debi	Shuma kredi
	Blerje mallrash	XXXXX	
	Shteti TVSH	XXXX	
	Te		
	Furnitorë		XXXXX
	Rregjistrohet blerja e mallrave sipas faturës së furnitorit Nr ___ datë ___		

Skematikisht funksionimi i llogarisë “Shteti TVSH” paraqitet:



Llogaritja e detyrimit të ndërmarrjes ndaj shtetit për TVSH përfaqësohet nga diferenca ndërmjet TVSH-së së llogaritur për shitjet me atë të faturuar për blerjet. **Në llogarinë “Shteti TVSH e zbritshme”** regjistrohet vetëm TVSH-ja, e cila është llogaritur mbi blerjet dhe që i zbritet ndërmarrjes. Kjo llogari korrespondon me debitin e llogarisë “Shteti TVSH” dhe në të gjatë periudhës kryhen vetëm debitime.

Në llogarinë “Shteti TVSH e mbledhshme” regjistrohet vetëm TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet dhe që i shtohet detyrimit ndaj shtetit. Kjo llogari korrespondon me kreditimin e llogarisë “Shteti TVSH” dhe në të gjatë periudhës kryhen vetëm kreditime.


Në llogarinë “Shteti TVSH për tu derdhur” regjistrohet detyrimi ndaj shtetit për TVSH-në i llogaritur si diferencë ndërmjet tepricave të llogarive “Shteti TVSH e mbledhshme” dhe “Shteti TVSH e zbritshme” në rast kur kjo diferencë është pozitive. Llogaritja e këtij detyrimi bëhet duke mbartur në këtë llogari tepricat e “Shteti TVSH e mbledhshme” dhe “Shteti TVSH e zbritshme”.

Në llogarinë “Shteti TVSH për tu marrë” regjistrohet detyrimi i shtetit ndaj ndërmarrjes për TVSH të derdhur tepër i llogaritur si diferencë ndërmjet llogarive “Shteti TVSH e mbledhshme” dhe “Shteti TVSH e zbritshme” në rast kur kjo diferencë është negative. Mbajtja e tepërcave dhe llogaritja e detyrimit ose të drejtës ndaj shtetit për TVSH bëhet në fund të çdo muaji, detyrim ky i cili përcaktohet nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Marrëdhëniet me zyrën e tatimeve. Ndërmarrja është e detyruar me ligj që në fund të çdo muaji të llogarisë dhe regjistrojë detyrimin ndaj shtetit për TVSH, pavarësisht nësa ka detyrim apo jo ndaj këtij lloji tatimi. Këto detyrime paraqiten në deklaratën tatimore që e harton ndërmarrja dhe e çon në zyrën e tatimeve.

Tema 27. Rregjistrimet e tjera për blerjet dhe shitjet

Tërësia e shpenzimeve të kryera nga ferma për të realizuar proceset shpërndarëse, përbëjnë atë që quhet kosto e shpërndarjes. Kostoja e mallrave të shitura është shuma e kostos së blerjes, kostos së shpërndarjes. **Shpenzimet e shpërndarjes janë** shpenzimet e personelit, të transportit, të ruajtjes së mallrave në magazinë, të ambalazhimit, të sigurimit kundrejt rreziqeve të ndryshme, të kërkimeve të tregut, të reklamës, financiare e tatimore dhe administrative etj. Llogaritë që përdoren për regjistrimin e shpenzimeve të shpërndarjes të kryera brenda fermës janë “**Shpenzime shitjeje**”, ose “**Shpenzime blerjeje**”. Në fund të periudhës, këto llogari mbyllen në llogarinë “**Humbje dhe fitime**”. Skema e regjistrimit të shpenzimeve të transportit nga ndërmarrja që i përballon në përputhje me klauzolën e lëvrimit është:



Më i komplikuar është regjistrimi i shpenzimeve të transportit dhe ngarkim-shkarkimit, sepse mënyra e regjistrimit të tyre varet nga:


- **Klauzola e përdorur në kontratë** dhe
- **Pozita e regjistruarit (është shitësi apo blerësi).**

Kur malli i porositur mbërrin në destinacion, blerësi e kontrollon atë. Gjatë vëzhgimit, ai mund të shohë defekte, ndryshim në madhësi, ngjyrë etj., të mallit që i ka ardhur në krahasim me atë që ka kërkuar. Në këtë rast, blerësi ka të drejtë t’ia kthejë mallin shitësit. Kthimet e mallrave të shitura përfajqësojnë pakësim ose zbritje të shitjeve dhe regjistrohen si të tilla duke i evidentuar në një llogari të emërtuar “**Kthime të mallrave të shitura**”.

Kjo llogari funksionon në të kundërt të llogarisë që korrigjon, dmth vetëm debitohet gjatë gjithë periudhës për të tëra kthimet nga shitje të kryera gjatë saj dhe në fund të periudhës tepërcia debitoare e

saj xhirohet në llogarinë **“Humbje dhe fitime”** duke ndikuar negativisht në rezultat. Tatimi i llogaritur mbi vlerën e mallrave të kthyer do të regjistrohet në debi të llogarisë **“Shteti TVSH”**, sepse pakëson detyrimin e fermës për këtë tatim. Në rastin e evidencës analitike të TVSH llogaria që debitohet për TVSH të mallrave të shitur që janë kthyer është: **“Shteti TVSH e zbritshme”**.


Skema e funksionimit të llogarisë “Kthime të mallrave të shitura”.



Për evidentimin e tyre përdoret llogaria **“Kthime të mallrave të blera”**, e cila është e kundërta e llogarisë **“Blerje mallrash”**, që edhe e korrigjon, prandaj kjo llogari vetëm kreditohet gjatë gjithë periudhës për tërë kthimet e mallrave të kryera gjatë saj. Në fund të periudhës, teprica kreditore e saj xhirohet në llogarinë **“Humbje dhe fitime”** duke ndikuar pozitivisht në rezultat. Edhe në rastin e evidencës analitike të TVSH-së, llogaria që debitohet për TVSH-në të mallrave të blerë që janë kthyer është **“Shteti TVSH e mbledhshme”**.

Në rastet kur mallrat nuk plotësojnë kushtet cilësore sipas kontratës por mund të përdoren blerësit i akordohen uljet e çmimeve. Ato përfaqësojnë pakësim të të ardhurave nga shitja për shitësin dhe të shpenzimeve të blerjes për blerësin dhe regjistrohen si të tilla. Shitësi përdor llogarinë **“Zbritje çmimesh të lejuara”**, e cila është llogari korrigjuese e llogarisë **“Shitje mallrash”** dhe meqënëse zbritjet kanë shenjë të kundërt me shitjet, atëherë kjo llogari debitohet për zbritjet e çmimeve të lejuara klientëve gjatë periudhës ushtrimore. Në fund të periudhës, teprica debitore e kësaj llogarie xhirohet në llogarinë **“Humbje dhe fitime”** duke ndikuar negativisht në rezultat. Nëse çmimi i mallrave ulet, atëherë ulen edhe të ardhurat nga shitja si dhe detyrimi i ndërmarrjes ndaj shtetit për TVSH për këto shitje. Prandaj, TVSH-ja e llogaritur mbi vlerën e uljes së çmimit regjistrohet në debi të llogarisë **“Shteti TVSH”** dhe përfaqëson një TVSH të zbritshme. Në rastin e evidencës analitike të TVSH, llogaria që debitohet për TVSH të llogaritur mbi zbritjen e çmimit të mallrave të shitur është: **“Shteti TVSH e zbritshme”**.


Skema e funksionimit të llogarisë “Kthime të mallra të blera”.




E njëjta mënyrë arsyetimi vlen edhe për uljet e çmimeve të përfituara nga mallrat e blera. Për evidentimin e tyre blerësi përdor llogarinë **“Zbritje çmimesh të përfituara”**, e cila është llogari korigjuese e llogarisë **“Blerje mallrash”**. Në fund të periudhës, teprica kreditore e kësaj llogarie xhirohet në llogarinë **“Humbje dhe fitime”**, duke ndikuar pozitivisht në rezultat. Në rastin e evidencës analitike të TVSH, llogaria që debitohet për TVSH e llogaritur mbi zbritjen e çmimit të mallrave të blerë është **“Shteti TVSH e mbledhshme”**.

Skontot regjistrohen edhe nga shitësi edhe nga blerësi. Për evidentimin e tyre shitësi dhe blerësi përdorin llogarinë **“Skonto të lejuara”** dhe **“Skonto të përfituara”** që në fund të periudhës ushtrimore xhirohen në llogarinë **“Humbje dhe fitime”** duke ndikuar edhe këto në rezultat.

Skema e funksionimit të llogarisë “Skonto të lejuara”.



Skema e funksionimit të llogarisë “Skonto të përfituara” paraqitet si më poshtë:



Për regjistrimin e TVSH-së për uljet e çmimeve dhe skontot tregtare përdoren llogaritë **“Shteti TVSH e zbritshme”** dhe **“Shteti TVSH e mbledhshme”**. Mallrat tregtohen të ambalazuara dhe shitblerja e tyre shoqërohet edhe me veprime për ambalazhet. **Ambalazhet mund të jenë:** falas, ambalazhe që faturohen, ambalazhe qarkulluese me afat përdorimi më të vogël dhe më të madh se një vit. Shitblerja e tyre me afat përdorimi nën një vit regjistrohet njëjloj si shitblerja e mallrave, kurse ambalazhet me afat përdorimi mbi një vit trajtohen si aktive të qëndrueshme.

Tema 28. Aktivet e qëndrueshme dhe rregjistrimet që lidhen me to

Pasuria e ndërmarrjes përbëhet nga dy grupe të mëdha elementësh pasurore:

- Aktivet afatgjata ose të quajtura ndryshe aktivet e qëndrueshme;
- Aktivet afatshkurtra.

Aktivet afatgjata janë tërë ato aktive që e japin dobinë e tyre dhe qëndrojnë në ndërmarrje në të njëjtën formë për disa vite me rradhë. Elementët që bëjnë pjesë në aktivet afatgjata grupohen në disa nënndarje, sipas karakteristikave të përbashkëta që kanë. **Këto nëngrupe janë:**

- **Aktive afatgjata materiale (AAM)** futen terrenet, ndërtesat, instalimet, makineritë, mjetet e transportit etj. Karakteristikë e përbashkët e tyre është se ato janë të materializuara në një formë të caktuar dhe se përbëjnë strukturën tekniko-prodhuese ose skeletin e fermës, pa të cilin ajo nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e saj;
- **Aktive afatgjata jomateriale (AAJM)** nuk kanë një formë të caktuar materiale, por paraqiten në formën e vlerave ose të drejtave pasurore, që janë në pronësi të fermës dhe japin dobi në të ardhme, ato janë aktive që nuk shfaqen në formë monetare, por ashtu si çdo aktiv janë të identifikueshme..

AAJM përbëhen nga: Shpenzimet kërkimore, konsencionet, patentat, liçencat, emri i mirë, aktive afatgjata financiare.

- **Aktive afatgjata financiare.** Këtu futen hua të dhëna të tretëve nga ndërmarrja, aksione dhe obligacione të ndërmarrjeve të tjera etj. Karakteristikë e përbashkët është se ato përfaqësohen nga para përkohësisht të tepërta, të investuara me afat të gjatë në veprimtarinë që nuk bëjnë rolin kryesor të ndërmarrjes nga të cilat do të nxirren dobi në disa periudha.

Evidenca kontabël e aktiveve afatgjata mbahet në llogari të gjendjeve, të cilat emërtohen sipas llojit të aktivit, gjendjet dhe lëvizjen e të cilit pasqyrojnë. Kështu në ndërmarrje mbahen llogaritë : “terrene”, “makineri”, “ndërtesa”, “mjete transporti”, “orendi e pajisje” etj.

Evidentimi i aktiveve afatgjata materiale në bilanc mbahet me kosto fillestare të tyre. Me kosto historike do të kuptohet kostoja e blerjes ose sigurimit të aktivit në momentin që ai ka hyrë në ndërmarrje për herë të parë. **Ajo përbëhet nga:**

- **Kostot e blerjes,** e cila përfshin çmimin e blerjes si dhe shpenzimet për taksat e importit dhe taksa të tjera dhe kostot e tjera të drejtpërdrejta.
- **Kostot e tjera të drejtpërdrejta që janë:** Pagesat e kryera për projektimin e aktivit; Pagat, tatimet dhe kontributet përkatëse që u paguhen punonjësve në lidhje me ndërtimin e aktivit; Kostot e transportit që lidhen me sjelljen e aktivit në vendin e shfrytëzimit; Kostot, që lidhen me përgatitjen e terrenit dhe instalimin e aktivit; Kostot e testimit nëse aktivi funksionon në mënyrën e duhur; Tarifat për shërbimet profesionale që lidhen me blerjen dhe venien në punë.

Evidentimi i aktiveve afatgjata jomateriale mbahet me koston fillestare të tyre, e cila përbëhet nga:

- çmimi i blerjes dhe
- kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me blerjen.

Ulja e vlerës së aktiveve të qëndrueshme. Rënia e vlerës së aktiveve afatgjata ndodh vit pas viti gjatë përdorimit të tyre, derisa kjo vlerë të bëhet zero, derisa del jashtë përdorimit dhe shkaktohet nga: **konsumi fizik** dhe **konsumi moral**. Shpenzimet e konsumit të aktiveve të qëndrueshme që i përkasin një periudhe ushtrimore, në terma teknike quhen “**amortizim**”. Amortizimi është një shpenzim që përcaktohet nga rënia e vlerës së aktivit gjatë përdorimit, pra dhënies së dobisë, dhe jo nga faktorë të tjerë të jashtëm ose të tregut.

Llogaritja e amortizimit ka të bëjë me përcaktimin e rënies së vlerës për çdo vit. Vlera e shpenzimit të amortizimit vjetor varet nga:

- Kosto historike e aktivit që do të amortizohet;
- Vlera që mund të realizohet, kur aktivi nuk përdoret më;

- Jetëzgjatja e aktivitet (koha e përdorimit) ose prodhimi i prodhuar prej tij;
- Metoda e amortizimit.

Disa nga metodat kryesore të llogaritjes së amortizimit janë:

- **Metoda lineare.** Sipas kësaj metode presupozohet se përfitimet e marra nga aktivi gjatë tërë viteve të jetës së tij janë të barabarta. Prandaj, pjesët e kostove të tij që i ngarkohen kostove të çdo periudhe, janë të barabarta.
- **Metoda e njësive të prodhimit të prodhuara nga aktivi.** Kjo metodë bazohet në faktin që për të prodhuar të njëjtat sasi produkti ose shërbimi konsumohet e njëjta vlerë e aktivitet, d.m.th sa më shumë njësi të prodhohë ai gjatë një periudhe të caktuar, aq më shumë dobi ka dhënë dhe aq më shumë është konsumuar. Pra, konsumi nuk varet nga koha e përdorimit, por nga prodhimi vjetor apo nga shërbimet e realizuara.
- **Metoda degressive (rënëse).** Ideja bazë ku mbështetet kjo metodë është se gjatë viteve të para të jetës, kur aktivitet janë të reja, sjellin më shumë dobi, ndërsa me kalimin e viteve dobia e tyre ulet. Prandaj, sipas kësaj metode llogaritet më shumë amortizim gjatë viteve të para të jetës.
- **Metoda progresive (rritëse).** Ideja bazë ku bazohet kjo metodë është se gjatë viteve të fundit vlera e aktivitet ulet më shpejt se sa gjatë viteve të para, gjithashtu vitet e fundit kërkojnë më shumë shpenzime për riparime e mirëmbajtje, të cilat i shtohen vlerës së amortizueshme.

Regjistrimi kontabël i amortizimit të aktiveve të qëndrueshme bëhet në një llogari të posaçme të emërtuar **“Shpenzime amortizimi”**. Kjo llogari analizohet sipas llojeve të aktiveve për të cilat llogaritet amortizimi në llogaritë “Shpenzime amortizimi të ndërtesave”, “Shpenzime amortizimi të automjeteve etj. Këto llogari debitohen për shpenzimet e amortizimit të llogaritura dhe në fund të periudhës teprica e tyre, gjithmonë debitoare, xhirohet në llogarinë “Humbje e fitime”. Përdorimi i llogarisë **“Amortizimi i akumuluar”**si kundërparti e regjistrimeve të amortizimit dhe kryerja e regjistrimeve në llogaritë përkatëse të aktiveve, përveçse është e detyrueshme me ligj për të siguruar uniformitet në vlerësim, i siguron edhe një avantazh të madh fermës. Amortizimi përfaqëson një shpenzim për fermën dhe i shtohet të gjitha shpenzimeve të tjera, të cilat xhirohen në debi të llogarisë **“Humbje dhe fitim”** për të llogaritur rezultatin.

Skema e funksionimit të llogarive “Shpenzime amortizimi” dhe “Amortizimi i akumuluar” paraqitet si më poshtë:

D Amortizim i akumuluar K	D Shpenzime amortizimi K	D Humbje fitime K
XXXX		
← Regjistrim i amortizimit gjatë periudhës →		
Amortizimi gjatë disa periudhave	Shuma e shpenz. të amortiz të periudhës	Xhirimi në fund të periudhës
D Llogaria Amortizim i akumuluar K		
XXX		
Me vlerën fillestare		

Shpenzimet e amortizimit kanë shenjë të kundërt me fitimin, domethënë do të ndikojnë negativisht mbi të. Pra, rezultati dhe shpenzimet e amortizimit janë në përpjesëtim të zhdrejtë. Nëse rezultati është negativ, kemi humbje. Në këtë rast, rezultati ka të njëjtën shenjë me shpenzimet dhe si pasojë

edhe me shpenzimet e amortizimit, pra humbja dhe shpenzimet e amortizimit janë në përpjesëtim të drejtë. Pra, aq sa rriten shpenzimet e amortizimit aq rritet edhe humbja e fermës.

Tema 29. Lista e llogarive, plani kontabël dhe llogaritë private

Plani i llogarive është një listë e tërë veprimesh që do të përdoret nga njësia ekonomike për regjistrimin, përpunimin dhe hartimin e raporteve financiare. Ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” përcakton emërimet dhe funksionimin e llogarive të cilat përmblihen në atë që quhet **“Plani i përgjithshëm kontabël”**. Kodifikimi i llogarive konsiston në vendosjen e një numri të veçantë identifikues për secilin prej tyre dhe janë hartuar sipas sistemit dhjetor të numërimit.

Përparësitë që siguron grupimi dhe kodifikimi mbi bazë dhjetore i llogarive janë:

- *Lehtëson përdorimin e planit të llogarive duke sqaruar identitetin e llogarive jo vetëm me anë të emrit, por edhe të numrit.*
- *Shmang gabime dhe ngatërime me njëra tjetrën të llogarive ,me emra të ngjashëm;*
- *Siguron unifikimin e emërimit dhe përdorimit të llogarive të njëjta në ndërmarrje të ndryshme;*
- *Krijon mundësinë e shtimit të llogarive të reja për pasqyrimin e veprimeve specifike të ndërmarrjeve të veçanta.*

Llogaritë janë përbushur në klasa me shifër nga 0 deri 9 dhe brenda çdo klasë në grupe me 2 shifra (10-19, 21-29, 31-39, 41-49 etj.). Klasa 0 është e lirë, ndërsa klasa 8 është rezervuar për llogaritë e posaçme. Klasat 1 deri në 7 përmbajnë llogaritë e kontabilitetit të përgjithshëm (financiar) nga të cilat: Klasat 1-5: llogaritë e bilancit; Klasat 6 dhe 7: llogaritë e rezultatit. Psh.

KLASA 6 LLOGARITË E SHPENZIMEVE

60. BLERJE TË KONSUMUARA (BLERJET DHE NDRYSHIMI I GJENDJEVE)

61–62 SHPENZIME TË TJERA NGA JASHTË

63. TATIME, TAKSA DHE DERDHJE TË NGJASHME

64. SHPENZIME TË PERSONELIT

66. SHPENZIME FINANCIARE

69. TATIME MBI FITIMIN DHE të NGJASHME

60. BLERJET DHE NDRYSHIMI I GJENDJEVE

601 Blerje materialesh të para

603 Ndryshimi i gjendjeve të materialeve e mallrave të blera

6031 Ndryshimi i gjendjeve të materialeve të para

6035 Ndryshimi i gjendjeve të mallrave

605 Blerje mallrash

Klasa 9 është rezervuar për kontabilitetin analitik të shfrytëzimit, për t’u përdorur nga njësiti ekonomike që e mbajnë këtë kontabilitet veças nga kontabiliteti i përgjithshëm.

Mjaft llogari përmbajnë përveç emërimit bazë edhe fjalët "llogari të lidhura". Kështu p.sh. llogaria 40 "Furnitorë dhe llogari të lidhura" rigrupon të gjitha detyrimet ndaj furnitorëve, qofshin këto për fatura të pranuar, efekte tregtare për t’u paguar, fatura të pambërritura, qofshin edhe për paradhënie të akorduara furnitorëve të cilat kanë një sens të kundërt me të parat (janë detyrime debitore). Psh.

40. FURNITORË DHE LLOGARITË LIDHURA

401 Furnitorë

403 Efekte për t'u paguar

404 Furnitorë për aktive të qëndrueshme

409 Furnitorë (debitore). Parapagime dhe pagesa pjesore të kryera për porosi


Lista e llogarive të paraqitura në këtë plan kontabël përbën një kuadër bazë, nga i cili njësitë ekonomike mund të zgjedhin e përdorin ato llogari që janë të nevojshme, por me respektimin e kushteve.

Rregullat e përdorimit të planit të llogarive.

Ligji për kontabilitetin përcakton dhe rregullat e përdorimit të planit të llogarive të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha ndërmarrjet. Çdo ndërmarrje harton planin e saj të llogarive, i cili bazohet në planin e përgjithshëm të tyre. Ndërmarrja nuk është e detyruar të mbajë llogaritë e planit të përgjithshëm nëse ato nuk i nevojiten. Gjithashtu, ajo ka të drejtë të çelë dhe llogari të tjera specifike në përputhje me nevojat e saj, por përdorimi i tyre duhet të miratohet nga Ministria e Financave ose sektorët përkatës të financave. Ndërmarrja ka të drejtë të kryejë një nënndarje të mëtejshme të llogarive të planit të përgjithshëm me kusht që të respektohet rendi i klasifikimit. Njësitë ekonomike mund të shpërndajnë veprimet e tyre në:

- veprime të realizuara në Shqipëri dhe të realizuara jashtë;
- veprime në lekë dhe në monedha të huaja;
- kërkesa për t'u arkëtuar ose detyrime për t'u paguar me afat të gjatë, të mesëm ose të shkurtër.

Llogaritë private. Pasuria e fermës financohet nga pronari i saj dhe nga ai i të tretëve. Të qënit pronar i jep të drejtën e tërheqjes së elementëve të kësaj pasurie deri në masën e pronës së tij që quhen ***“Tërheqje private”***. Kushtet e tregut dhe të konkurrencës kërkojnë zgjerimin e përmasave dhe të veprimtarisë, të cilat sjellin nevojën për kapitali shtesë. ***“Derdhjet private”*** të kryera nga pronari shkaktjnë shtim të kapitalit vetjak të fermës por nuk përfajqësojnë të ardhura sepse nuk realizohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj. Evidentimi i tërheqjeve dhe derdhjeve private bëhen në llogarinë ***“Llogari e pronarit”*** që është pjesë e llogarisë së kapitalit të vet por jo llogari të ardhurash dhe shpenzimesh të periudhës ushtrimore. Në fund të periudhës, kur kryhen veprimet e mbylljes, teprica debitore ose kreditore e kësaj llogarie xhirohet në pakësim ose shtim të kapitalit vetjak të fermës në llogarinë ***“Kapitali vetjak”***.



Tema 30. Rregjistrimet kontabël në fushën e personelit dhe qarkullimi i pagesave

Në momentin që punëtorët deklarohen të punësuar kryhet regjistrimi i tyre në regjistrin themeltar të personelit, i cili mbahet nga zyra e personelit, ku për secilin prej tyre hapet një dosje e veçantë ku pasurohet vazhdimisht me të dhëna të reja. Shpërblimi përcaktohet me ligj me anë të marrëveshjes midis punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Forma e shpërblimit të personelit përcaktohet në varësi të kategorizimit të tij duke u shpërblyer me **rrogë** ose **pagë** për punën e kryer. **Rrogë** quhet shpërblimi i punonjësve për kryerjen e detyrave ose funksioneve që u janë caktuar në funksion të kualifikimit të tyre, pavarësisht nga koha dhe mënyra e kryerjes. **Pagë** quhet shpërblimi që marrin punëtorët për sasinë dhe cilësinë e punës së kryer ose kohën e punës në fermë. Pagat janë të formës: **me kohë, me copë, me normë**. Dokumenti që shërben për të llogaritur, dokumentuar dhe pasqyruar shpërblimet është **listëpagesa**. Në të llogariten dhe pasqyrohen shpërblimet bruto, ndalesa e tatimit mbi të ardhurat, ndalesa e kuotës së sigurimeve dhe paga neto e punonjësve.

Sipas legjislacionit aktual llogaritja e pagës neto tregohet në tabelën e mëposhtme:

Llogaritja e pagës sipas VKM nr. ____ dt. _____

Nr	Emër/ Mbiemër	Paga bruto	Paga mbi të cilën llog kontributet	PUNËMARRËSI			PUNËDHËNËSI			Paga para TAP	TAP Progresive	Paga me Bankë	Kosto totale punëdhënës
				Sigurimet punëma rrësi 9,50%	Sigurimet shëndetë sore 1,70%	Totali i punë marrësit 11,2%	Sigurimet e punë dhënësit 15%	Sigurimet shëndetë sore 1,70%	Totali i punë dhënësit 16,70%				
1		87,000	87,000	8,265	1,479	9,744	13,050	1,479	14,529	87,000	7,410	69,846	101,529
2		60,000	60,000	5,700	1,020	6,720	9,000	1,020	10,020	60,000	3,900	49,380	70,020
3		31,000	31,000	2,945	527	3,472	4,650	527	5,177	31,000	130	27,398	36,177
4		29,000	29,000	2,755	493	3,248	4,350	493	4,843	29,000	-	25,752	33,843
TOTALI			207,000	19,665	3,519	23,184	31,050	3,519	34,569	207,000	11,440	172,376	241,569

Shpërblimi bruto përfajqëson për fermën shpenzim, i cili regjistrohet në debi të llogarisë së shpenzimeve të periudhës **“Shpenzime për paga”** gjithashtu një detyrim ndaj personelit që në datën e llogaritjes regjistrohen në llogarinë **“Personeli- paga e shpërblime për t’u paguar”**. Ndërsa kuota e sigurimeve dhe tatimet e ndaluara nga shpërblimi për fajqësojnë detyrime të fermës ndaj sigurimeve dhe shtetit. Paga e shpërblimeve të punës mund të kryhet: **me para në dorë, me çek ose me xhirim në llogari**. Ferma i detyrohet sigurimeve shoqërore për kuotat siç paraqiten në tabelën më lart dhe përfajqësojnë shpenzime të periudhës dhe regjistrohen në llogarinë **“Shpenzime për kuota të sigurimeve shoqërore”**. Llogaritja dhe dokumentimi që përballohet nga ferma bëhet në listpagesën e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu ferma mund t’u japë vartësve edhe paradhënie të cilat duhet të shlyhen nga pagat pasardhëse. Për evidentimin e tyre përdoret llogaria **“Personeli-paradhënie dhe pagesa pjesore”** e cila është një llogari detyrimesh të personelit ndaj fermës, e cila kreditohet për marrjen e paradhënies dhe debitohet për shlyerjen e saj. Regjistrimin kontabël i pagës neto të punëtorit X është:

Referimi	Artikulli kontabël	Paradhënie	Shuma debi	Shuma kredi

	Shpenzime për paga		87 000	
	Te			
	Shteti-tatime dhe taksa të ndaluara nga të ardh. e personelit			7 410
	Sigurime shoqërore			9 744
	Personeli- paradhënie e pag. pjesore	-		
	Personeli -paga e shpërblime për t’u paguar.			69 846
	Sipas listpag. së datës janë regj. detyr. e fermës ndaj punëtorit A. Kurti për pagën, tatime, sig. shoq.			

Për të kryer pagesa e të mirave dhe shërbimeve të blera ferma mund të përdorë çekun. Çeku është një autorizim me shkrim i emëtuesit të tij për bankën ku ai ka llogarinë, për të paguar menjëherë në favor të përfituesit të çekut të shënuar në të, shumën e shënuar. Për të evidentuar çeket e emetuara ose

të pranuar, ferma përdor llogarinë “*Çeqe të emetuar*” që ka vetëm tepricë kreditore dhe “*Çeqe për tu arkëtuar*” që ka vetëm tepricë debitore, në të cilat evidentohen për sa kohë nuk është bërë arkëtimi ose pagesa e tyre duke mbajtur regjistra analitikë prej nga ku shumat mbarten periodikisht në centralizator dhe llogari. Për pagesën e detyrimeve ferma përdor edhe *urdhërxhirimin*. Ai është një urdhër me shkrim që ferma debitore i jep bankës për të xhiruar nga llogaria e fermës në llogarinë e kreditorit ose furnitorit të saj shumën e parave të shënuar në të. Për shitjet e mëvonshme të mallrave dhe shërbimeve mund të bëhen ose me anë të regjistrimit në llogari ose me anë të emetimit të kambialit. ***Kambiali është një zotim me shkrim*** i emetuesit të tij për t’i paguar zotëruesit në një datë të caktuar shumën e shënuar në të bashkë me një përqindje interesi.

Tema 31. Mbyllja vjetore dhe analiza e bilancit

Në fund të çdo periudhë administrative kryhen një sërë veprimesh dhe regjistrimesh kontabël që i shërbejnë hartimit të pasqyrave financiare, të cilat pasqyrojnë rezultatet e tërë veprimtarisë së fermës gjatë asaj periudhe si: Bilanci i periudhës, pasqyra e llogarisë “Humbje dhe fitime” si dhe pasqyrat dhe shpjegimet që shoqërojnë bilancin. Veprimet e mbylljes nisin me përcaktimin e saktë të shpenzimeve dhe të ardhurave që i përkasin periudhës ushtrimore. Domosdoshmëria e llogaritjes së tyre kushtëzohet nga respektimi i kërkesave të parimit të të drejtave të konstatuara, i cili është një nga parimet bazë të sanksionuara nga ligji “për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Për të mundësuar përfshirjen në rezultatit të periudhës vetëm të shpenzimeve dhe të ardhurave që i përkasin asaj kryhen ato që quhen regjistrime kontabël të sistemimit ose të korigjimit të vlerave. Llogaritë që përdoren për sistemimin e të ardhurave dhe shpenzimeve janë:

- “Shpenzimet e parapaguara”
- “Të ardhura për t’u shpërndarë”
- “Shpenzime të llogaritura”
- “Të ardhura të llogaritura”

Në fund të periudhës ushtrimore duhet të bëhet edhe mbyllja e llogarisë së pronarit në llogarinë e kapitalit të vet. Të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat e regjistruara në llogaritë përkatëse të shpenzimeve dhe të ardhurave të saj përmbliohen dhe transferohen në llogarinë “Humbje e fitime”, e cila bën të mundur:

- Kalimin nga një periudhë ushtrimore në një tjetër
- Përcaktimin e rezultatit të periudhës ushtrimore
- Përcaktimin e madhësisë së kapitalit të vet në fund të periudhës

Pasi është bërë mbyllja e llogarive të shpenzimeve dhe të ardhurave, hartohet “***Bilanci verifikues***” jo vetëm për të vërtetuar saktësinë e regjistrimeve por edhe për të hartuar bilancin përfundimtar.

Në fund të periudhës ushtrimore, për të mundësuar mbylljen e librave të vjetër dhe hapjen e të rinjve hartohet ***artikulli i mbylljes së llogarive të gjendjeve***. Ferma është e detyruar të paraqesë në fund të periudhës së bashku me bilancin dhe llogarinë “Humbje e fitime” dhe disa pasqyra të tjera që janë:

- Pasqyra e amortizimeve;
- Pasqyra e aktiveve të qëndrueshme me vlerën bruto;
- Pasqyra e shumave të parashikuara për rreziqe;
- zhvlerësime dhe shpenzime;
- Pasqyra e numrit të personelit të punësuar, pagave dhe shpërblimeve;
- Pasqyra e shpërblimeve për organet e drejtimit;
- Pasqyra e shpërndarjes së rezultatit;

- Pasqyra e llogaritjes së fitimit të tatueshëm,etj.

Vlerësimi i mbylljes vjetore dhe analiza e bilancit. Vetëm bilanci, llogaria ekonomike dhe pasqyrat që i shoqërojnë ato në mbylljen vjetore nuk mund të japin një pasqyrë të gjendjes ekonomiko-financiare të ndërmarrjes. Për këtë qëllim kryhet **analiza ekonomike financiare** që është tërësia e veprimeve të përpunimit dhe interpretimit dhe të të dhënave të bilancit dhe pasqyrave që e shoqërojnë atë.

Analiza ekonomike financiare ka si qëllim:

- Analizimin e të dhënave të periudhës dhe periudhave të kaluara për të vlerësuar veprimtarinë e ndërmarrjes;
- Parashikimin, planifikimin dhe marrjen e vendimeve për veprimtari që do të zhvillohen në të ardhmen.

Në bilancin përfundimtar elementët e aktivitetit të bilancit si dhe ato të pasivitetit paraqiten të grupuar sipas karakteristikave të tyre të përbashkëta. Ky grupim i shërben qartësisë së bilancit dhe bën të mundur që bilanci të tregojë, jo vetëm se sa është gjendja e elementëve të veçantë me 31 dhjetor, por edhe analizën e veprimtarisë së ndërmarrjes që përcakton faktorët e ndryshëm që kanë ndikuar në ecurinë e ndërmarrjes gjatë periudhës ushtrimore.

Tema 32. Rregulla të etikës profesionale dhe të komunikimit në fermat bujqësore

Etika është studimi dhe vlerësimi i sjelljes njerëzore bazuar në parimet morale. Parimet morale mund të shikohen si standardi i sjelljes që njerëzit kanë ndërtuar për veten e tyre ose si lënda e shtërngimeve dhe detyrimeve që një shoqëri e caktuar kërkon nga pjesëtarët e saj. Ajo merret me çështjet se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe, si mundemi ne të bëjmë dallimet mes tyre, a është e mira dhe e keqja e njëjtë për të gjithë; si mundemi të bëjmë vendime të forta që mund të ndihmojnë apo pezmatojnë të tjerët. Emërtimi përdoret edhe për çdo sistem ose teori të vlerave morale ose parimore. Tradicionalisht etika ndahet në etikë normative, metaetikë, dhe etikë e zbatuar. Etika ka të bëjë me tërësinë e parimeve të pranuar të sjelljes, të cilat duhet të rregullojnë bashkëjetesën midis njerëzve në një komunitet. Parimet e një etike profesionale janë:

- **Integriteti** – i drejtë dhe i sinqertë.
- **Objektiviteti** – mënjanimi i anësisë, konfliktit të interesit dhe ndikimit të paligjshëm.
- **Kompetenca profesionale dhe kujdesi** – kompetencë, mbajtja e nivelit, ngritja e kompetencës profesionale dhe përditësimi i saj.
- **Besueshmëria/Konfidencialiteti** – nuk duhet të shpalosen të dhëna përveç nëse kërkohen nga e drejta dhe detyra profesionale.
- **Sjellja profesionale** – pajtueshmëria me ligjet dhe shmangia e çdo veprimi që e diskrediton profesionin.

Shumica e organizatave bëjnë përpjekje për të siguruar sjelljet etike dhe për rrejdhojë komunikimin e moralshëm nëpërmjet përpunimit dhe shpalljes së detyrueshme të rregullave të punës. Megjithatë, kyçi për zhvillimin e komunikimit etik në organizatë mbeten sjelljet individuale të menaxherëve dhe mbikëqyrësve. Në radhë të parë një menaxher duhet të diskutojë vazhdimisht lidhur me komunikimin etik në biznes ose në organizatën e tij. Kjo do të thotë se mënyra e përcaktuar e komunikimit duhet që të rishikohet herë pas here, për t’u sjellë në pajtim me stadin e zhvillimit moral dhe të nevojave aktuale të shoqërisë. Rishikimi i mënyrave të komunikimit, si një teknikë e përdorur këto vitet e

fundit, është një metodë efikase për të kontrolluar politikat e komunikimit, procedurat, rrjetin dhe tërë aktivitetet e tij.

Për ta përmirësuar komunikimin do të ishin efektive disa nga rregullat udhëzuese:

Për komunikimin me shkrim: Përdorimi i fjalëve të shkurta e të njohura, si dhe fjalive dhe frazave të thjeshta. Mënjanimi i fjalëve të tepërta dhe të pakuptueshme zgjedhja e një stili të shkruari ku i përshtatet situatës dhe efektit që dëshiron të arrijë dërguesi i mesazhit. Mënyra verbale/gojarisht e komunikimit mund të përmirësohet nëse respektohen rregullat që vijojnë informacioni duhet të dërgohet në një gjuhë që është e thjeshtë për tu kuptuar duke përdorur shembuj konkretë ose ngjarje të ndryshme ku përforcojnë shkallën e të kuptuarit të mesazhit dhe të tregohet qartë rëndësia që ka informacioni për arritjen e objektivave konkrete, përdorimi edhe i anës emocionale, kur dëgjohet informacioni, me qëllim që të përforcohet kuptimi dhe rëndësia e tij etj. Pra, rëndësia e një komunikimi efektiv lidhet ngushtë me përpunimin e gjykimeve etike dhe me vendimarrjen, e cila duhet të jetë moralisht e drejtë.

Disa nga karakteristikat më të rëndësishme të komunikimit efektiv janë:

- **Jep informacion praktik**, pavarësisht nëse ka të bëjë me kuptimin e politikave të ndërmarrjes apo me nxitjen për kryerjen e një veprimi të caktuar. Jep më tepër fakte dhe më pak përshtypje, duke përdorur shprehje konkrete, detaje specifike dhe informacion të qartë, bindës, të saktë dhe etik.
- **Qartëso dhe përqëndro informacionin**, duke theksuar informacionet më të rëndësishme. Mesazhet që e selekcionojnë dhe përmbledhin informacionin janë mjaft efektive.
- **Identifiko saktë përgjegjësitë**, duke i shkruar mesazhet në mënyrë të atillë që të kërkojnë përgjigje nga një audiencë specifike. Shprehu qartë se çfarë pret prej dëgjuesve dhe çfarë mund të bësh për ta.
- **Bind të tjerët dhe jep rekomandime**, duke iu shpjeguar dëgjuesve se çfarë përfitimesh do të kenë nga përgjigjja ndaj mesazhit tuaj në mënyrën e dëshiruar.

Mënyrat/llojet e komunikimit

Procesi komunikimi është mirëkuptimi i ndërsjellë midis palëve në komunikim. Llojet kryesore të komunikimit janë sa më poshtë:

- **Komunikim i folur ose verbal**, përfshin realizimin e komunikimit ballë për ballë, me telefon, radio ose televizion dhe media të tjera.
- **Komunikim jo verbal**, përfshin komunikimin përmes gjuhës së trupit, gjestet, mënyrën se si vishemi ose veprojmë, ku qëndrojmë, dhe madje edhe aromat që përdorim. Ka shumë mënyra delikate për të komunikuar (ndoshta edhe pa dashje) me të tjerët. Për shembull, toni i zërit mund të japë të dhëna për disponimin ose gjendjen emocionale, ndërsa sinjalet e duarve ose gjestet mund të shtojnë një mesazh jo të folur.
- **Komunikim me shkrim:** përfshin komunikimin përmes letrave, postës elektronike, mediave sociale, librave, revistave, internetit dhe mediave të tjera. Më parë konsideroheshin shumë të fuqishëm kur ishte fjala për komunikimin e fjalës së shkruar vetëm shkrimtarët apo botuesit e ndryshëm. Sot, të gjithë ne mund të shkruajmë dhe publikojmë idetë tona në internet, gjë që ka çuar në një shpërthim të informacionit dhe mundësive të komunikimit.
- **Komunikimi përmes vizualizimeve**, është pjesë e komunikimit të shkruar, por përmes grafikëve, hartave, logove dhe vizualizimeve të cilat gjithashtu mbartin dhe transmetojnë mesazhe.